

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Çështje të sigurisë - 12

ÇËSHTJE TË SIGURISË *Security Issues*

Revistë e përtremuajshme mbi sigurinë

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Bordi botues:

Kryetar

Sotiraq Hroni – Drejtor i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Anëtarë

Dr. Arshi Çela

Dr. Arjan Starova

Arjan Dymishi

Ambasador Pëllumb Qazimi (Gjen. R)

Konsulentë

Geron Kamberi – M.A. në Studime Europiane

Artan Karini – M.A. në Administrim Publik

Redaktor përgjegjës

Mariola Qesaraku – M.A. në Studime Bashkëkohore Europiane

Ndihmoi në përgatitje

Ermela Hoxha

Elira Hroni

Jerina Xhaferri

Alban Lauka

Orhan Ceka

Ky numër reviste botohet me mbështetjen financiare të **Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s** në Bruksel dhe **Fondacionit Friedrich Ebert**, Tiranë

PËRMBAJTJA

Paul Hockenos

Rishikimi i marrëdhënieve SHBA-Europë

A është për Obamën BE më e mirë sesa NATO? 7

Jan Techau & Alexander Skiba

Marrëdhëniet transatlantike 2009. Pritshmëritë europiane të
epokës post-Bush 22

Sandra Diaz Fernandez

Koha për të rivlerësuar arkitekturën e sigurisë europiane?

Trekëndëshi i sigurisë midis Nato-BE-Rusi 63

Backgrounder

Siguria Njerëzore në Shqipëri 86

Besnik Baka

Policimi në komunitet: Filozofia dhe sfida e zbatimit

praktik 132

English summery 142

PAUL HOCKENOS

RISHIKIMI I MARRËDHËNIEVE SHBA-EUROPË
A ËSHTË PËR OBAMËN BE MË E MIRË SESA
NATO?

Barack Obama ka për të rimenduar partneritetin transatlantik në aspektin e ndryshimit të marrëdhënieve të supremacisë dhe të rreziqeve të reja globale të sigurisë. Institucioni Atlantik i preferuar i Washington-it, NATO është tashmë e mbingarkuar. BE, nga ana tjetër, ka një histori performance më të pasur se ç'mund të mendohet dhe mund të jetë më i përshtatshëm për këtë detyrë.

DPA

Një furrë buke në qytetin Baden-Baden të Gjermanisë është duke shitur një “Obama torte” në hovin e përgatitjes të samitit të NATO në prill. A duhet NATO të jetë adresa kryesore për bashkëpunimin transatlantik?

Komuniteti më i mirë dhe më i mprehtë i politikës së jashtme të SHBA-së vendosi Organizatën e Atlantikut Verior (NATO) si institucionin për bashkëpunimin transatlantik. Këta studiues, diplomatë dhe politikanë - nga të dyja partitë - janë të ashtuquajturit Atlanticistët e Amerikës. Ndryshe nga neokonservatorët, ata mendojnë në mënyrë multilaterale, vlerësojnë europianët si aleatë jetëgjatë dhe besojnë në të drejtën ndërkombëtare. Barack Obama nuk është pa dyshim një përjashtim. Sidoqoftë Atlanticistët gabojnë duke u kapur kaq me këmbëngulje pas NATO-s për qëllime kaq të ndryshme. Kaq shumë sa është munduar të rindërtojë veten që prej konfliktit Lindje-Perëndim, NATO mbetet një aleancë ushtarake e dominuar nga SHBA me një qëndrim si në Luftën e Ftohtë. NATO është jo vetëm e papajisur për t'u përballur me pluralitetin e sfidave të reja në rendin

botëror të post-Luftës së Ftohtë (dhe tani post-Amerikane), por edhe është bërë gjithashtu antiproduktiv në ushtrimin e detyrës për të cilën ishte krijuar fillimisht - domethënë për të garantuar sigurinë në Europë.

Për administratën e re amerikane, do të ishte e dobishme të rimendonte marrëdhënien e SHBA-së ndaj Europës, e cila duhet të drejtohet drejt një partneriteti strategjik të barazisë me Bashkimin Europian dhe të presë mundësinë për një nismë të re që të adresojë rreziqet globale të sigurisë. Parë nga një perspektivë afatgjatë, një marrëdhënie pune e ngushtë dhe respektuese me Bashkimin Europian do të rriste sigurinë e vet Amerikës dhe do ta mundësonte atë për t'u angazhuar më efektivisht në një botë multipolare.

Preferenca e gjatë dhe e qëndrueshme e Amerikës për NATO-n si institucion transatlantik ka shpjegime të ndryshme. Për disa, të paktën deri para Afganistanit - kishte një rekord suksesi. Ajo ndihmoi Perëndimin të fitonte Luftën e Ftohtë pa bërë as edhe një gjuajtje. Detyra e NATO-s ishte, ashtu si deklaroi dhe sekretari i përgjithshëm britanik Lord Ismay në 1967, "të mbante rusët jashtë, amerikanët brenda dhe gjermanët poshtë". Por ndryshe nga një institucion i mbyllur me "mision të përfunduar" në vitet e para të 1990-s, aleanca e krijuar më 1949 kërkonte një qëllim të ri. NATO drejtoi ndërhyrjet humanitare në Bosnjë më 1995 dhe ekspeditën ushtarake kundër Serbisë së Milosheviç-it më 1999, sepse europianët nuk kishin pajisje ushtarake për të zhvilluar luftën kundër nacionalistëve serbë. Po atë vit, Republika Çeke, Hungaria dhe Polonia u bënë shtetet e para të ish-Traktatit të Varshavës që hynë në NATO, pavarësisht kundërshtimeve të sërta të Rusisë. Në vitet në vazhdim, Shtetet Balltike, Sllovenia, Sllovakia, Bullgaria dhe Rumania u bënë gjithashtu anëtare. Megjithëse Shtetet e Bashkuara dhe Britania e Madhe shmangën NATO-n nga pjesëmarrja në rrëzimin e qeverisë Talibane nga fundi i vitit 2001, dy vite më vonë NATO ndërmori operacionet e veta jashtë Europës për herë të parë në formën e Forcës Asistuese për Sigurinë Ndërkombëtare në Afganistan. Sot Forca e drejtuar nga NATO përfshin 50000 trupa nga 40 vende, duke përfshirë 27 vende nga Aleatët e NATO-s.

Duke marrë parasysh rrugën Lindje-Perëndim, gjatë dekadave të pasluftës për aleatët e NATO-s ka qenë e mundur të punojnë së bashku në emër të mbrojtjes kolektive, pavarësisht qëndrimeve të ndryshme brenda paktit. Duke lënë mënjanë çështjen mbi natyrën e kërcënimit sovjetik (në fakt arkivat në Moskë nuk përmbajnë ndonjë plan për pushtim), Shtetet e Bashkuara dhe Europa Perëndimore ndajnë bindjen se Bashkimi Sovjetik ishte armiku. Megjithëse Shtetet e Bashkuara vendosën agjendën ku europianët ishin efektivisht partnerë të vegjël, principi i vendimmarrjes së përbashkët u respektua formalisht.

Për më tepër, si rrjedhojë e Luftës së Ftohtë nuk kishte një alternativë të qartë për të mbajtur Shtetet e Bashkuara dhe Europën afër për sa kohë që trupat amerikane u tërhoqën dhe mbrojtja nukleare u bë e parëndësishme. Të krijoje diçka të re ishte përtej imagjinatës së politikëbërësve të atëhershëm të Washington-it. Së fundmi, sepse ka qenë dhe do të mbetet kryesisht një organizatë ushtarake, NATO ishte një institucion që Shtetet e Bashkuara, me arsenalin e saj nuklear dhe superioritetin ushtarak, ishte e sigurt që do të vazhdonin ta dominonin.

Sidoqoftë, duke transformuar aleancën në një agjenci që adreson krizat ndërkombëtare të çdo lloji, mbështetësit e NATO-s kanë tërhequr vëmendjen mbi papërshtatshmërinë e tij në shekullin XXI. “Qasja gjithëpërfshirëse” e NATO-s për sigurinë e pajis atë me “mandate të plota” që ndryshojnë ndërsa lindin rreziqe dhe misione të reja dhe përfshin përgjegjësi që shkojnë përtej ushtrimit të forcës ushtarake. Por, ndërsa mandati ka ndryshuar, mjetet dhe mënyra e të menduarit kanë mbetur mbrapa. Nuk ka shembull më të mirë se produkti i NATO në Afganistan, ku aleanca u përball me detyra civile, policore dhe humanitare, të cilat nuk mund t'i kryente. Shumica e shteteve europiane anëtare të NATO-s në Afganistan argumentojnë se stabiliteti mund të arrihet vetëm nëpërmjet edukimit, programeve të shtetit të së drejtës, ndihmës ekonomike dhe projekteve infrastrukturore. Ata nënvizojnë se qëllimi i misionit ndërkombëtar është të lehtësojë përgjegjësinë e afganëve dhe të krijojë kushte për

rikonstrukcion të mëtejshëm. Gjermania dhe Spanja theksojnë, për shembull, se prodhimi afgan i drogës nuk mund të kontrollohen nga fushata bombarduese dhe se sulmet ajrore mbi fermerët e varfër afganë mund të rezultojë në kundërpërgjigje me zjarr, duke rritur kostot e operacionit. Por “anti-narkotika” është një tjetër kategori që i është shtuar listës së veprimit të NATO-s. Ka një konsensus në rritje që misioni në Afganistan është ose sukses ose dështim për NATO-n dhe se, për momentin, kjo e fundit nuk mund të përjashtohet.

Lufta në Afganistan është vetëm shembulli më i jashtëzakonshëm i dilemës së NATO-s. Qoftë për luftën kibernetike, paqeruajtjen, terrorizmin ndërkombëtar, ose sigurinë energjike, NATO thirret nga Atlanticistët si institucioni kryesor, duke e mbingarkuar atë me përgjegjësi të reja. Nga fund i janarit, sekretari i përgjithshëm i NATO-s madje propozoi prezencën e aleancës në Arktik sepse ngrohja globale shkriu kupën veriore të akullit dhe fuqitë e mëdha filluan të hartojnë pretendimet mbi burimet e energjisë. Të tjerë e shikojnë NATO-n që patrullon në kufijtë e GAZA-s si rrjedhim i marrëveshjes së re të paqes midis Izraelit dhe Palestinës.

Ashtu si argumenton dhe studiuesi politik holandez, Peter van Ham, instrumentet e NATO-s janë bërë të vjetër dhe jashtë mode për shkak të sfidave të sigurisë dhe teknikave jo-tradicionale. Megjithatë, ai vë re se në kundërshtim me pritshmëritë, buxheti i tij vetëm është zgjeruar: “Jo para shumë kohësh, çështja kryesore ishte se si Bashkimi Europian mund të përdorte forcat ushtarake të NATO-s, ndërsa debati është tashmë se si NATO mund të tërheqë burimet e Bashkimit Europian, Kombeve të Bashkuara, Bankës Botërore, si dhe organizatave joqeveritare”. Sidoqoftë, kjo nuk i ka bërë politikëbërësit e jashtëm të SHBA-së për të konsideruar një epokë ose mekanizma të rinj për t’u përballur me rreziqet e reja. As europianët nuk kanë qenë sipërmarrës ose të hapur me ide të reja. Për ta kjo është rruga e rezistencës së pakët. Duke i vënë këto sfida komplekse në duart e NATO-s, ata duken se i kanë adresuar problemet pa bërë në të vërtetë këtë gjë.

Është e diskutueshme nëse kjo NATO e re është ende një institucion transatlantik që e meriton këtë etiketim. Pavarësisht strukturës së saj multilaterale, NATO është bërë një “clearing house” për “koalicionin e vullnetit të mirë” e drejtuar nga SHBA në të cilën anëtarët e Aleancës - si dhe jo anëtarët - mund të futen rast pas rasti. Këta anëtarë, pra një numër vendesh demokratike mund të thirren nga Uashingtoni pasi ky i fundit t’u ketë drejtuar gishtin për të përmbushur çdo qëllim apo synim. Europeanët nuk marrin në konsideratë asnjë nga rolet dhe përgjegjësitë, as si në rolin e partnerëve më të vegjël si bënin në të kaluarën, por përkundrazi shërbejnë si ndihmës rastësor, si ishte dhe rasti i pushtimit dhe vendosjes së paqes në Afganistan. Sa më shumë kombe të jenë në aleancë, aq më shumë i mundshëm është konstelacioni për këto koalicione të mbledhura. Kjo është një nga arsyet që amerikanët këmbëngulin për një zgjerim të NATO-s. Dhe nisur nga fakti që mandati i kësaj organizate mbrojtëse nuk është më i kufizuar brenda Europës ose për sigurinë e përbashkët, nuk është surprizuese fjala për hapjen e anëtarësimit për Izraelin, Australinë dhe Japoninë. Ata që nuk janë të gatshëm për të qenë pjesë në një mision të caktuar thjesht lihen mënjanë.

Si argumenton van Ham: “NATO i ofron Shteteve të Bashkuara vulën e dobishme të legjitimitetit multilateral pa i vendosur shumë limite politikës së jashtme të Amerikës”. Edhe në rastin kur marrin pjesë shumica e shteteve europiane në një mision të NATO-s, ky lloj i ri koalicioni, nuk ka atë unitet dhe koherencë që kishte NATO i vjetër. Me të vërtetë, në Afganistan diferencat brenda koalicionit ishin aq të mëdha sa SHBA, Gjermania dhe Holanda kishin strategji të ndryshme në sektorët e tyre respektivë. Kjo gjë përbën një mal të largët për mitin “*të gjithë-për një dhe një-për të gjithë*” që bashkonte Aleancën fillimisht.

Fuqia e Butë e Bashkimit European

Ekziston një pikëpyetje nëse NATO është e saktë në detyrën e ruajtjes së paqes në zonën e Atlantikut Verior, gjë e cila është

arsyeja origjinale e ekzistencës (raison d'être). Sot, rreziqet ndaj Europës janë thellësisht të ndryshme nga ato që ekzistonin në vitet e Luftës së Ftohtë. Ato përfshijnë konflikte etnike në kufijtë europianë, migrimin në masë dhe dyndjet e refugjateve, krizat energjetike, proliferimin nuklear dhe terrorizmin ndërkombëtar. Veçanërisht në Europë, shumë ekspertë i shikojnë sfidat ndaj sigurisë në ngrohjen globale, trafikimin ndërkombëtar mungesën e burimeve dhe dështimin e shteteve. Një studim i vonshëm i BE-së doli në përfundimin se tensionet e shtuara mbi pakësimin e furnizimit me ujë në Lindjen e Mesme do të afektojë sigurinë energjetike dhe interesat ekonomike të kontinentit. Për më tepër, ngrohja globale, do të shtojë varfërinë dhe emigrimin në masë nga Afrika. As struktura e NATO-s as instrumentet e saj nuk janë të përshtatshme për këto lloj problemesh. Nën administrimin e Bushit kjo nuk kishte rëndësi - roli i NATO-s shikohej ekskluzivisht si pjesë e luftës kundër terrorizmit. Konflikti në Gjeorgji në gusht të 2008-ës, vuri në dukje se ka akoma rreziqe për sigurinë e Europës brenda dhe në kufijtë e saj, që fuqitë e kontinentit duhet t'i përgjigjen me më shumë instrumente sesa me forcë.

Nuk është sekret që Rusia ndihet thellësisht e kërcënuar nga ekspansioni i Aleancës drejt Lindjes, gjë të cilën e ka kontestuar në mënyrë të vazhdueshme. Moska e percepton si armiqësor avancimin e forcave të huaja ushtarake drejt kufijve të vet, forca të cilat ishin dizenuar për t'i rezistuar Bashkimit Sovjetik dhe që akoma vazhdojnë ta shohin Rusinë si konkurrente. Megjithëse jo vetëm përgjegjës për veprimin autoritar rus, zgjerimi i NATO-s drejt Europës Qendrore dhe Lindore - në kundërshtim me premtimet e SHBA-së dhe Gjermanisë ndaj Gorbachev-it në 1989 - shtyu përpara nacionalizmin dhe kategorizimin agresiv të Rusisë në kohën e Putin. Gjithashtu shkaktoi një nxitje të garës për armatime dhe përkeqësoi rrezikun për sigurinë në Europë gjë që ka implikime afatgjata për europianët. Gjithashtu, zgjerimi i mëtejshëm lindor i NATO-s për të përfshirë Ukrainën dhe Gjeorgjinë, të cilën Obama e përkrahu në fjalimin e tij në korrik 2008 në Berlin, nuk do të shkaktojë më shumë siguri - as për Europën Perëndimore as për Gjeorgjinë dhe Ukrainën.

Pranimi i Gjeorgjisë mund ta çojë NATO-n drejt një konfrontimi direkt me Rusinë. A do të riskonte vërtet Aleanca luftën me Rusinë për shkak të largimit të enklavave pro ruse në Gjeorgji? E Pamundur. Gjeorgjianët nuk duhet të kenë iluzione, ata kanë paguar tashmë një çmim të lartë për ndjenjën e rreme të sigurisë që këshilluesit amerikanë i dhanë atyre para konfliktit të fundit.

Bashkimi European në Botë

Aq i madh sa ka qenë hendeku përgjatë Atlantikut kohët e fundit, sa Shtetet e Bashkuara kanë akoma më shumë të përbashkëta me europianët sesa me fuqitë e reja si Kina dhe Rusia. Europa mund dhe duhet të jetë partneri më i afërt i Amerikës në çështjet botërore. Por, kjo marrëdhënie duhet të jetë tërësisht e ndryshme nga ajo e tanishme. Duhet të jetë një partneritet prej të barabartësh përgjatë Atlantikut dhe kjo kërkon compromise reale nga Shtetet e Bashkuara si dhe nga europianët.

Për ta bërë këtë të mundur, administrata e Obamës duhet të fillojë të mendojë ndryshe për Bashkimin European. Për dikë, Bashkimi European nuk lëkundet për çështjen e disintegritimit pavarësisht se si disa komentatorë amerikanë interpretojnë mungesën e unitetit nisur nga shumë çështje dhe dështimet e fundit për të miratuar kushtetutën. Megjithëse reforma institucionale është absolutisht e nevojshme, edhe në kushtet aktuale Bashkimi European është i shëndetshëm, i admiruar nga shumica dërrmuese e europianëve dhe do të vazhdojë të performojë si ka bërë në vitet e vonshme, por jo më mirë se kaq derisa një kushtetutë ose traktat reformues do të aprovohet.

Bashkimi European është tashmë një forcë e madhe dhe e aftë në çështjet botërore. Ai ka interesa globale dhe një sens përgjegjësie që shkon përtej interesave vetjake të ngushta. Madhësia e tij dhe ekonomia ndërkombëtare vetëm e bëjnë të rëndësishëm globalisht, veçanërisht duke qenë se shumica e fuqisë së Bashkimit vjen nga politikat tregtare të kushtëzuara. Tregu vetëm përfshin 450 milion njerëz dhe renditet si eksportuesi më i madh botëror i mallrave dhe importuesi i

dytë më i madh në botë pas Shteteve të Bashkuara. Kur kriza e tanishme financiare arriti kulmin këtë vjeshtë, thirrjen e parë për ndihmë Presidenti Bush ia bëri Bashkimit Europian. Europeanët kontribuojnë gjithashtu me mbi gjysmën e ndihmës së huaj botërore për vendet në zhvillim, duke përfshirë edhe • 300 milion në vit për autoritetin palestinez, që përbën trefishin e burimeve që japin Shtetet e Bashkuara.

Në mënyrë diplomatike, Bashkimi Europian ka drejtuar negociata me Iranin mbi programin nuklear që prej 2003. Në 2004 diplomacia europiane ndihmoi për të arritur një rezolute paqësore për Revolucionin Portokalli të Ukrainës dhe, kohët e fundit, negociatorët europianë ishin ideatorët e paqes në Gjeorgji që çuan trupa paqeruajtëse dhe monitoruese në Kaukaz. Suksesi më i madh i tij deri më tani ka qenë stabilizimi i Ballkanit Perëndimor në periudhën pas përfundimit të luftërave të viteve 1990. Pra, megjithëse politikat e jashtme të Bashkimit Europian janë në fillesat e tyre, ato përbëjnë tashmë një kontribut të rëndësishëm në sigurinë globale.

Ndonëse Bashkimi Europian gjatë shumë rrethanave ka qenë përfshirë në çështje jashtë kufijve të vet, kjo mori një formë të re në 1992 me Politikën e Jashtme të Sigurisë së Përbashkët. Që atëherë aftësia e saj për t'u angazhuar në botën e gjerë shpërtheu në mënyrë sinjifikative, së pari me Politikën Europiane të Sigurisë dhe të Mbrojtjes (ESDP) në 1999 dhe pastaj me adoptimin e Strategjisë Europiane të Sigurisë. ESDP e pajisi Bashkimin Europian me kapacitete ushtarake, duke e mundësuar atë të lançojë misionin e parë në Maqedoni në 2003. Për herë të parë në historinë e Bashkimit, Strategjia Europiane e Sigurisë përcaktoi një orientim strategjik për Bashkimin Europian për t'u angazhuar në pikat më problematike botërore duke kombinuar ndihmën, diplomacinë, tregtinë dhe forcën. Disa nga programet dhe misionet që kanë dalë nga Strategjia Europiane e Sigurisë përmbajnë trajnimin e forcave policore në territoret palestineze dhe në Afganistan, misionin e shtetit të së drejtës në Kosovë, trajnimin e gjyqtarëve të Irakut, dhe reformën në sektorin e sigurisë në Kongo.

Ka një lloj keqperceptimi të përbashkët ndër amerikanët që Europa është pacifiste dhe më së shumti një shkrues çeqesh

apo një rindërtues i pasluftës për operacionet luftarake të drejtuara nga SHBA. Megjithëse aspak pacifiste, Europa në fakt mendon për forcat ushtarake ndryshe nga Shtetet e Bashkuara. Fakti i ndërhyrjes në raste krizash është për të vendosur siguri dhe pastaj për të rindërtuar shoqëritë e shkatërruara nga konfliktet, duke i siguruar atyre një ekonomi të qëndrueshme dhe qeverisje të përshtatshme. Kjo qasje ka si qëllim të parandalojë vendet e prirura për kriza nga dështimi dhe, ndër produktet e tjera të padëshiruara të paqëndrueshmërisë dhe varfërisë, për të mos u bërë terren për terrorizmin.

Që prej 1990, Bashkimi Europian ka pasur njësi ushtarake të kufizuara në dispozicion, përgjithësisht nën komandat kombëtare, që kanë qenë të pozicionuara aq larg si Çadi, Republika Demokratike e Kongo-s, Sudani, kufiri Gaza-Egjypt dhe Indonezi. Gjithashtu të disponueshëm, edhe pse deri tani të papërdorur, janë kontingjentet e luftës të organizuara në “grupe luftimi” fleksibile dhe të lëvizshme prej 1.500 trupash. Sidoqoftë për pjesën më të madhe, Strategjia Europiane e Sigurisë parashikon punësimin e forcave ushtarake në misione paqeruajtjeje ose post-konfliktuale së bashku me komponent civil. Shpërndarjet e trupave, për shembull, kanë siguruar siguri për zgjedhje dhe projekte mbi ndërtimin e shtetit. Forcat nën komandën europiane kanë drejtuar çarmatimin në Maqedoni, kanë mbështetur zgjedhjet e drejtuara nga ndërkombëtares në Kongo dhe monitoruar armëpushimin. Paqeruajtësit e Bashkimit Europian që zëvendësuan forcat e NATO-s në Bosnjë në 2004 kanë vazhduar me monitorimin dhe ushtrimet trajnuese.

Fuqia e Butë: Ndryshimi i regjimit nga përbrenda

Edhe pse tani ka një arritje globale - dhe një sërë suksesesh në pikat e largëta problematike - Bashkimi Europian është akoma më efektiv në zonat e fqinjësisë dhe periferisë. Këtu ai e ushtron më mirë fuqinë e butë legjendare të tij. Me mjetin e nxitjeve dhe shpërblimit, Bashkimi Europian ka ngritur

demokraci në ish-diktaturat e djathta në Mesdhe dhe regjimet komuniste në Europën Qendrore dhe Lindore. Kjo fuqi transformuese është aktualisht forca shtytëse e reformave në Ballkanin Perëndimor si dhe në Turqi. Gjatë procesit për të përshtatur politikat e tyre me kriteret europiane, të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor duke përfshirë dhe Serbinë kanë bërë hapa të mëdha që prej luftërave të 1990. Pavarësisht opozitës së brendshme të fuqishme, Turqia kaloi një mori paketash të reformave konstitucionale të dizenuara për të sjellë politikat e saj me standardet europiane: buxheti ushtarak i Ankarasë, është tani nën kontrollin civil, dënimi kapital nuk është më në fuqi dhe torturat nëpër burgje janë ndaluar. Parlamentari i BE-së Daniel Cohn-Bendit bën thirrje për drejtimin nga BE të procesit të liberalizimit të Turqisë si “mrekullia në Bosfor”.

Fuqia e butë e Bashkimit European arrin gjithashtu në një periferi të gjerë që shtrihet nga Maroku dhe Egjipti përmes Jordanisë deri në Armeni, nga Moldova në Ukrainë. Këto shtete munden që të mos futen kurrë në Bashkim European, por gjithsesi dëshirojnë të bëjnë kompromise dhe të arrijnë normat bazë të Bashkimit European për të përfituar nga ndihma dhe tregtia preferenciale, si dhe nga përfitimet për trajnime të oficerëve të drejtësisë, projektet mjedisore dhe rrugët e reja dhe infrastruktura. Këto projekte që janë pjesë e Politikës Europiane të Fqinjësisë nuk janë filantropi, përkundrazi janë politika të sërta të sigurisë. Me një kosto prej \$ 12 bilion dollarësh që prej 2004 (dhe \$ 18 bilion për gjashtë vitet e ardhshëm), logjika është që duke i sjellë këto shtete në orbitën e vet dhe duke i transformuar ato në aleate të mirëqeverisur, Bashkimi European ndihmon për t’u krijuar kushte që t’i mbajnë terroristet - si dhe emigrantet - në gjë. Ai njëkohësisht siguron që korridoret energjetike në Europën Lindore, Kaukazi Jugor dhe Mesdheu të ngelen të hapura dhe të qeverisen nga shtete paqësore. Duzina e shteteve të Politikës Europiane të Fqinjësisë përfshin shtete problematike që janë përgjithësisht lart në listën e përkujdesjes perëndimore si Libani, Algjeria dhe mund të përfshijnë në të ardhmen Sirinë, Libinë dhe Bjellorusinë.

Uniteti së pari

Para se Bashkimi European të bëhet një fuqi botërore në përputhje me fuqinë e saj ekonomike, shtetet anëtare kanë për të ndërmarrë reforma institucionale dhe vendime të rëndësishme. Pikë së pari, politika e jashtme europiane është penguar nga kërkesa për unanimitet në vendimmarrje. Si një bashkim prej 27 shtetesh (dhe kantonesh) duhet të gjej një mënyrë për të krijuar një vendimmarrje me maxhorancë të kualifikuar në shumë fusha. Kushtetuta e propozuar ose pasardhësi Traktati reformues i Lisbonës, do të kishin bërë ekzaktësisht këtë gjë, si dhe të krijonin një ministër të Jashtëm (ose “përfaqësues të lartë”) me fuqi të veçanta si dhe me një shërbim diplomatik të tijin. Bashkëpunim i strukturuar në fushën e mbrojtjes do të përmirësonte kapacitetin ushtarak të BE-së. Por, në 2005 dhe 2008 votuesit në Holandë, Francë dhe Irlandë i hodhën poshtë këto traktate për arsye që kishin pak të bënin me dispozitat e politikës së jashtme të tyre. Rruga përpara tashmë nuk është ende shumë e qartë.

Në aspektin e politikës së sigurisë dhe mbrojtjes, “boshllëku në kapacitet” i ndeshur në Bashkimin European - hendeku midis pajisjeve të rënda ushtarake që shtetet kanë dhe që i nevojiten çdo politike europiane për sigurinë - e lë atë thellësisht të varur nga NATO dhe Shtetet e Bashkuara. Pavarësisht nga koncepti komprehensiv i Strategjisë Europiane të Sigurisë, forcat ushtarake të kontinentit janë të kufizuara, ndërsa ato të ndërtuara gjatë Luftës së Ftohtë, pajisnin më mirë për një luftë kontinentale sesa paqeruajtjen në Afrikë. Shumica e fuqive në njerëz dhe pajisjeve të rënda ushtarake nuk mund të shpërndahen jashtë Europës, diçka që gjermanët, për shembull, mund të jenë ndier ngushtë në Hindu Kush.

Për vite Uashingtoni kishte kundërshtuar dhe aktivisht bllokuar përpjekjet europiane për të forcuar komponentët e vet ushtarakë të mbrojtjes me idenë se minonte NATO-n. Por kjo sjellje duket se është zbutur në dekadat e fundit. Në samitin e NATO-s në Bukuresht vitin e shkuar NATO dhe zyrtarët e SHBA-së inkurajuan publikisht europianët të marrin në dorë planin e mbrojtjes, një kërkesë kjo që nënkuptonte që

Shtetet e Bashkuara nuk dëshirojnë më të ruajnë sigurinë për europianët në një rend botëror me kaq shumë prioritete të tjera. Gjithashtu mund të ketë nënkuptuar që Uashingtoni është i gatshëm që europianët të luajnë një rol më të madh në mbajtjen e sigurisë ndërkombëtare, që përbën një hap të parë për një partneritet të ri. Presidenca franceze e BE-së përkrahu ngritjen e kapaciteteve ushtarake europiane si një prej prioriteteve, në të njëjtën kohë duke integruar formalisht Francën në NATO. Ekspertet europianë të mbrojtjes thonë se Strategjia Europiane e Sigurisë në mënyrë të saktë e vë në dukje rrugën përpara. Europianët thjesht kanë për ta vazhduar së bashku, diçka që një administratë e re amerikane duhet ta inkurajojë edhe më dukshëm.

Një aleancë transatlantike e re

Ka një sërë fushash të lidhura me sigurinë që europianët kanë për t'i ofruar Shteteve të Bashkuara në një aleancë transatlantike të re. E para është politika mbi klimën, të cilën europianët e vendosin dukshëm në kategorinë e gjeosigurisë. Bashkimi Europian ka marrë aktivisht drejtimin e botës në përpjekjet për të frenuar ngrohjen globale dhe administrata e Obamës duhet të arrijë dhe të bashkohet me europianët në pranimin e shkurtimeve drastike dhe të detyrueshme në emetimin. Objektivat e BE-së përfshijnë një reduktim prej 20% emetimet europiane të gazit të serrave deri në 2020, e krahasuar kjo me nivelet e 1990, ose një 30% reduktim nëse kombe të tjera (si Shtetet e Bashkuara) bien dakord të ndërmarrin veprime të tilla. Objektivat europiane përfshijnë gjithashtu rritjen e përdorimit të energjisë së ripërtëritshme me 20% të gjithë energjisë së konsumueshme. Nëse Shtetet e Bashkuara hedhin në short me europianët, partnerët do të kishin më shumë mjete për të bindur ndotësit e tjerë të mëdhenj në botë, “duzinën e pistë” e cila numëron 80% të nxjerrjes së karbonit në botë, për të bërë të njëjtën gjë. Shtetet e Bashkuara mund të punojnë dorë me dorë me Bashkimin Europian për të dizenuar një traktat pasardhës të atij të Kyotos, që skadon më 2012.

Siguria energjetike është një tjetër fushë ku Shtetet e Bashkuara mund të bëheshin partnerë me Europën. Shtetet e Bashkuara dhe Europa së bashku numërojnë 40% të konsumit të energjisë në të gjithë botën dhe kanë premtuar një koordinim më të mirë për të menaxhuar burimet energjetike. Europa ka vendosur një qëllim ambicioz për të reduktuar përdorimin e përgjithshëm të energjisë me 20% deri më 2020. Presidenti i Komisionit European të BE-së, José Manuel Barroso ka bërë thirrje për një Dialog Strategjik për Energjinë midis Europës dhe Amerikës. Ai ka nënvizuar potencialin për një bashkëpunim të zgjeruar për energjinë midis SHBA-BE përgjatë globit, duke përfshirë zhvillimin e burimeve të hidrokarbonit në rajonet e Kaspikut dhe Azisë Qendrore dhe bashkëpunim për të përmirësuar efektivitetin energjetik.

Një fushë e tretë ku administrata e Obamës mund të kërkojë bashkëpunim transatlantik është për kontrollin e armëve dhe çarmatimin nuklear. Qëllimi i eliminimit të të gjitha armatimeve nukleare është i parashikuar në Traktati Nuklear Joproliferuas (NPT) dhe është nxitur kohët e fundit nga një ish-grup zyrtarësh të mbrojtjes dhe departamentit shtetëror të SHBA-së duke përfshirë Henry Kissinger, George Shultz, William Perry dhe Sam Nunn. Ata kanë nxitur Shtetet e Bashkuara për të drejtuar botën drejt çarmatimit nuklear duke ratifikuar dhe Traktatin për Ndalimin e Provave (CTBT), i cili do të ndalojë të gjithë testimin e armëve nukleare dhe do t'i bëjë forcat nukleare më pak të gatshme për t'u lançuar me një lajmërim të shpejtë, duke përfshirë dhe bombat e SHBA-së të vendosura në Europë. Bashkimi European do të ishte ndërmjetësi perfekt për të angazhuar Rusinë në këtë proces, një shtet për të cilin kjo ide do të ishte veçanërisht e vështirë të shitej. Progresi në copëzimin e armëve nukleare - ose të paktën në bërjen e pakësimin e dukshëm në stoqet globale - do t'i jepte negociatave vazhduese BE-SHBA me Iranin mjete shtese për të bindur Teheranin për të ndaluar programin nuklear. Një hap i parë do të ishte ripërtëritja e NPT-së, një nga mekanizmat e kontrollit të armëve i gjymtuar nga administrata e Bush-it. Kjo, së bashku me ratifikimin e CTBT, mund të inkurajojë Indinë dhe Pakistanin të ndërmarrin një hap

mbrapa në garën e armëve nukleare. Duhet të bëhet një marrëveshje e re për të shtyrë ose zëvendësuar START I (Traktatin Strategjik të Reduktimit të Armëve) që përfundon në dhjetor të 2009-ës. Shumë nga prerjet e detyrueshme të armëve nukleare sipas paktit midis Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë janë tashmë të vjetruara dhe të tepërta dhe një akord i ri mund të institucionalizojë kërkesa strikte verifikimi dhe të imponojë limite të tjera për armatimet.

Gjithashtu, nëse europianet ecin përpara me një projekt të ri substancial mbi sigurinë, ai duhet të përfshijë njëkohësisht Rusinë dhe Shtetet e Bashkuara. Një propozim i një Qendre për Studime të Politikës Europiane me bazë në Bruksel është për të përfshirë Bashkimin Europian më aktivisht në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) dhe në fund t'i japë institucionit pasardhës të Procesit të Helsinkit një rol qendror për sigurinë nga Atlantiku në Urale. Ndoshta është duke u investuar në të me një Këshill permanent Europian të Sigurisë i përbërë nga anëtarë të spikatur duke përfshirë Bashkimin Europian, Rusinë, Shtetet e Bashkuara, Turqinë dhe Ukrainën, si dhe anëtarë jo të përherëshëm si shtetet e Azisë Qendrore. Çfarëdo forme që mund të marrë arkitektura e sigurisë europiane, do të jetë antiproduktive nëse Rusia nuk është anëtare e saj. Kjo përfshin edhe mbrojtjen raketore. Rusët kanë hedhur në qarkullim idenë për një Traktat Europian mbi Sigurinë që do të adresojë kontrollin e armëve, trafikimin e drogës, krimin e organizuar, terrorizmin dhe emigrimin e paligjshëm. Sarkozy ishte i lideri i parë europian që e mbështeti atë publikisht. Në vitet e pas Luftës së Ftohtë, fituesit perëndimorë i diktuan planet e tyre Rusisë, pa marrë parasysh dobësitë e saj. Strategjia dështoi tërësisht. Aq problematike është Rusia, sa aleatët e Atlantikut duhen ta marrin atë seriozisht dhe ta përfshijnë atë në planet e sigurisë.

E vërteta është që NATO është një nga institucionet e pas Luftës së Dytë Botërore që nuk pajtohet me nevojat e botës së sotme. Dekada e fundit ka dëshmuar një zhvendosje të madhe të fuqive, larg nga Shtetet e Bashkuara, por larg edhe nga Perëndimi në tërësi, Gjendja aktuale e sistemit financiar të drejtuar nga perëndimorët vetëm e ka shtyrë përpara këtë

ndryshim. Tani që fuqitë e reja botërore filluan të shpallnin veten e tyre në arenën ndërkombëtare, Shtetet e Bashkuara dhe Europa do të kuptojnë se kanë shumë më shumë gjëra të përbashkëta. Ata duhen të mendojnë, pra, në mënyrë krijuese për çështje të tilla si siguria, në një mënyrë që ata nuk e bënë menjëherë pas Luftës së Ftohtë. Nëse marrëdhënia Euro-Atlantike do të vazhdojë të jetë e veçantë, atëherë duhet të ndërtohet mbi bazën e një partneriteti të barabartë, me Shtetet e Bashkuara që i bëjnë koncesione të rëndësishme europianëve dhe europianët duke bërë përpara për t'u kujdesur për kërkesat e tyre të sigurisë. Një gjë është e sigurt: duke marrë parasysh sfidat e mëdha të shekullit XXI, Shtetet e Bashkuara dhe Europa do të kenë nevojë për njëra-tjetrën si kurrë më përpara.

Paul Hockenos është redaktor në Internacionale Politik-Global Edition. Libri i tij më i ri është "Joschka Fischer dhe Bërja e Republikës së Berlinit: një Histori Alternative e Gjermanisë së Pas Luftës".

*Një version i kësaj eseje u shfaq në edicionin e dimrit të 2008-2009-ës të *Gazetës e Politikës Botërore*.

JAN TECHAU & ALEXANDER SKIBA

MARRËDHËNIET TRANSATLANTIKE 2009
PRITSHMËRITË EUROPIANE
TË EPOKËS POST-BUSH

A do të sjellë viti 2009 një fillim të ri në marrëdhëniet transatlantike? Nga eksperiencia me administratën tetëvjeçare të Bushit, Bashkimi European dhe vendet e tij anëtare janë të etur për t'i parë me një sy tjetër partnerët e tyre përtej Atlantikut. Çfarë mundësisht do të gjejnë ata për një fillim të ri në marrëdhëniet Europë-Amerikë? Çilat çështje do të zënë vendin kryesor kur, pas fushatës së gjatë zgjedhore në SHBA, politikëbërësit do të ulen për t'u marrë me çështje esenciale?

Pas një periudhe hezitimi të madh në të kaluarën, të dy kampet në Amerikë pranojnë tashmë se interesat kombëtare të SHBA-së shërbejnë më mirë nga një Europë e fortë. Në të njëjtën mënyrë, Europa ka mbërritur në konkluzionin e përgjithshëm se partneriteti me Uashingtonin është i dëshirueshëm edhe kur ndërmjet vendeve të BE-së ka mosmarrëveshje për atë se çfarë duhet të përfshijë konkretisht ky partneritet.

Kështu, administrata e ardhshme e SHBA-së jo vetëm do të mirëpresë një BE të fortë, por do ta përllogarisë dhe do ta kërkojë si të tillë. Uashingtoni me siguri që do të kërkojë kontribut me të madh dhe më të qenësishëm nga aleatët e tij europianë për çështje kyçe ndërkombëtare: nga Afganistani dhe "lufta kundër terrorit" te të menaxhuarit e rritjes së Kinës, nga kundërveprimi ndaj Iranit te një NATO më fleksibël për të ndërmarrë veprime globale. Si edhe është karakteristike për debatet transatlantike, kërkesat europiane ngelen çështje të larta parimore, por të përgjithshme, ndërsa Uashingtoni do të ulet në tryezë më propozime dhe pritshmëri konkrete.

Administrimi i mençur i pritshmërive reciproke është, pra, një element kyç: rigjenerimi i marrëdhënies nuk do të arrihet lehtë dhe shpejtë.

Ky botim, i cili përmbledh studime të bëra në 15 vende dhe një studim i BE-së, të kryera nga institute anëtare të European Policy Institutes Network (EPIN), synon të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit të pritshmërive. Studimi ofron një panoramë tërësore - vende të vogla dhe të mëdha, vende anëtare të vjetra dhe të reja të BE-së - të asaj që vendet europiane kërkojnë nga SHBA për vitin 2009 dhe më tej.

Lexuesit, të cilëve u drejtohet ky studim, jetojnë në të dy anët e Atlantikut; për politikëbërësit europianë, ky studim shërben si një provë e dallimeve dhe ngjashmërive në atë që vendet anëtare të BE-së përpiqen të arrijnë me SHBA dhe se ku i shohin ata vështirësitë. Për komunitetin amerikan të politikëbërësve, studimi ofron një vështrim mbi shumëllojshmërinë e perceptimeve europiane mbi SHBA dhe shpresat e rajonit për përmirësimin e marrëdhënies transatlantike.

Belgjika

Sofie Rafrafi, Instituti EGMONT, Bruksel

Belgjika dhe SHBA nuk kanë pasur gjithmonë të njëjtën përqasje për sa i përket zbatimit të politikës së jashtme, veçanërisht gjatë administratës së parë të Bushit, kur përdorimi i fuqisë ushtarake dukej se kishte marrë përparësi ndaj përdorimit të mjeteve diplomatike dhe shumëpalëshe. Ky qëndrim ndryshoi gjatë mandatit të dytë kur administrata e SHBA-së u bë më e hapur ndaj rolit të rëndësishëm të aleatëve dhe kur i mëshoi më shumë multilateralizmit në mënyrë që të arrinte rezultate më të mira në politikën e jashtme.

Sulmet terroriste të 11 shtatorit ishin një gur themeli për politikën e jashtme të administratës së parë të SHBA-së nën Bushin dhe për sa i përket kësaj Belgjika tregoi solidaritet në luftën kundër terrorizmit. Belgjika e mbështeti fillimin e sulmit të SHBA-së ndaj talebanëve në Afganistan dhe më vonë

kontribuoi në misionin ISAF/NATO (duke u përfshirë në ruajtje aeroportesh, përfshirje në juglindje të Afganistanit dhe rritjen e fuqisë ajrore të SHBA-së). Belgjika përmirësoi sistemin e saj të vizave dhe pasaportave, kontrollin e trafikut ajror dhe aeroportual (përfshi dhe shkëmbimin e të dhënave mbi pasagjerët), sistemin e informimit bankar dhe kontrollin e portual të portit të Antverpit si një shenjë e mëtejshme mbështetje ndaj SHBA-së.

Në një fushë tjetër që lidhet me sigurinë, Belgjika, ashtu si edhe SHBA, beson se siguria afatgjatë ndërkombëtare mbështetet në ndalimin e krijimit të fuqive të reja bërthamore. Në lidhje me këtë, Belgjika mbështet plotësisht politikën e SHBA-së mbi traktatin për mospërhapjen e Armëve të Shkatërrimit në Masë (ASM) dhe mbështet SHBA-në për sa i përket ambicieve nukleare të Iranit.

Së fundi, të dy aktorët ndajnë të njëjtat objektiva për sa i përket Afrikës Qendrore dhe politikës së Kombeve të Bashkuara në Sudan, veçanërisht në Darfur. Belgjika, ashtu si edhe SHBA, mbështet dhe pranon nevojën e vendosjes së stabilitetit në Afrikën Qendrore, veçanërisht në Republikën Demokratike të Kongos. Kjo politikë detyron përdorim të mekanizmave më të fortë kontrolli për të parë se si dhe ku përdoren ndihmat për zhvillimin dhe se si zbatohen politikat e rindërtimit.

Megjithatë, për çështje të ndryshme, Belgjika ka pikëpamje të ndryshme për sa i përket mjeteve dhe instrumenteve që SHBA përdor për të arritur synimet e saj, veçanërisht në luftën kundër terrorizmit, dhe sidomos në lidhje me praktikën hetimore të përdorura në Guantanamo dhe burgun e Abu Graib (shkelje të të drejtave themelore). Belgjika nuk e mbështeti ndërhyrjen e SHBA-së në Irak për arsye të mosmarrëveshjeve në lidhje me objektivat dhe arsyet për këtë ndërhyrje dhe mungesën e një konsensusi ndërkombëtar. Për më tepër, Belgjika beson se është e rëndësishme për SHBA që të njohë Gjykatën Kriminale Ndërkombëtare në mënyrë që të evitohet perceptimi i shmangies së mosndëshkimit në vendet e përfshira nga krizat. Gjithashtu, Belgjika beson se SHBA duhet të ratifikojë Traktatin e Otavës për Minat, ku Belgjika

ishite vendi i parë nënshkrues, dhe se SHBA duhet të rishqyrtojë qëndrimin e saj në lidhje me Protokollin e Kiotos.

Prioritete e Belgjikës për agjendën transatlantike përfshijnë, pikësëpari dhe mbi të gjitha, situatën në Irak dhe Afganistan. Në lidhje me këto konflikte, Belgjika mbështet një politikë sigurie që baraspeshon preokupimet e sigurisë dhe diplomacisë dhe që i mëshon në mënyrë të veçantë rindërtimit. Ajo mbështet reformat demokratike, të cilat marrin në konsideratë rrethanat kombëtare dhe rajonale (p.sh. në Ukrainë dhe Gjeorgji). Ndërsa për konfliktin izraelito-palestinez, Belgjika do të preferonte të zbuste qasjen paksa të pabaraspeshuar të Izraelit dhe SHBA-së dhe krijonte një qasje me të ekuilibruar me ndihmën e Katërshes për Lindjen e Mesme (SHBA, Rusi, BE dhe Kombet e Bashkuara. Shënim i revistës). Gjithashtu, një interes kyç i Belgjikës qëndron në bashkëpunimin e vazhdueshëm në lidhje me Ballkanin dhe një bashkëpunim më të mirë transatlantik për sa i përket politikave mjedisore dhe ndryshimit të klimës. Po kështu është e rëndësishme arritja e një marrëveshje për tregtinë botërore pas dështimit nga OBT të raundeve negociuese të Dohas dhe për krijimin e një qasje më koherente në fushën e politikave ekonomike dhe monetare.

Kuptohet pa u thënë se Belgjika operon dhe ndjek politikën e saj të jashtme në të njëjtën linjë dhe brenda kuadrit të BE-së, që përkrah qasjen globale dhe diplomatike të BE-së. Nëpërmjet anëtarësisë jo të përhershme në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara gjatë 2007-2008, Belgjika ka nxitur përdorimin e qasjeve dhe metodave shumëpalëshe për të zgjidhur çështje të politikave të rëndësishme. Ajo do të përpiqet që të çojë këtë gjë përpara brenda BE-së (edhe gjatë presidencës së BE-së në vitin 2010) dhe në forume të tjera si NAO dhe OSBE.

Qipro
Profesor Andreas Theophanous,
Qendra qipriote për çështje europiane dhe
ndërkombëtare, Nicozi

Në mënyrë të pashmangshme, zgjedhja e një presidenti të ri dhe perspektiva e një administrate të re në SHBA kanë ndikim global. Duke pasur parasysh ngjarjet e fundit në mjedisin ndërkombëtar (si p.sh. 11 Shtatori, Iraku, marrëdhëniet e tendosura SHBA-Iran, konfliktet etnike dhe në veçanti zhvillimet e fundit në Kaukazi, sfidat socio-ekonomike), bota i ka kushtuar vëmendje gjithnjë e më të madhe këtyre zgjedhjeve presidenciale si asnjëherë tjetër më parë. BE i shikon këto zgjedhje si një moment historik në marrëdhëniet e ardhshme me SHBA dhe për një vizion të ri global.

Përtej marrëdhënieve BE-SHBA, marrëdhëniet dypalëshe të Qipros me SHBA janë të kënaqshme, me bashkëpunim në fushën e terrorizmit, zbatimit të ligjit në tërësi dhe tregtisë në rritje. SHBA e ka njohur rolin e Qipros në ndihmën humanitare gjatë krizës në Liban në verën e vitit 2006. Por aspekti përcaktues i marrëdhënies është qëndrimi i SHBA-së mbi problemin qipriot, një qëndrim që në Nikozi shihet si i krijuar jo nga pranimi nga SHBA i parimeve dhe vlerave që ajo përqafton, por nga marrëdhënia e saj strategjike me Turqinë.

Përtej kësaj, Qiproja ndan qëndrimet në tërësi të BE-së. Në botën tonë të globalizuar, sfidat si mjedisi, terrorizmi, paqëndrueshmëria socio-ekonomike dhe konfliktet etnike kërkojnë qasje shumëpalëshe dhe kolektive. Administrata e re e SHBA-së duhet të fillojë me një qasje të re duke lënë pas krahëve unilateralizmin. Deri tani kjo mund të jetë sfida më e madhe.

Në kohë të ndryshme, marrëdhëniet ndërmjet SHBA-së dhe BE-së nuk kanë qenë të lehta. Në këtë kuadër, deklarata e Donald Rumsfeld dhe dallimi midis Europës së re dhe të vjetër ishte domethënëse. Një qasje e re ndaj marrëdhënieve

euroatlantike mund të fillonte me konsultime më të shpeshta midis dy palëve përpara se të merren vendime të rëndësishme. Por që ky proces të funksionojë, megjithatë, është gjithashtu e nevojshme që BE të flasë me një zë.

Për pjesën e vet, SHBA duhet të rivlerësojë qasjen e saj ndaj Lindjes së Mesme, duke pasur parasysh potencialin e lartë të rajonit për paqëndrueshmëri në rritje. Politika e SHBA-së në këtë rajon shihet si jo e paanshme. Në fund të fundit, ndjenjat e vazhdueshme antiamerikane kanë prirje të kthehen në ndjenja antiperëndimore. Pasoja është se Europa duket se po ndan kostot e një perceptimi të tillë. Duhet të ketë një rishqyrtim të strategjisë së SHBA-së më gjerë në rajon dhe një bashkëpunim më konstruktiv dhe më qartë të përcaktuar ndërmjet SHBA-së dhe BE-së.

Një çështje tjetër me rëndësi të madhe janë qëndrimet kontradiktore të marra nga fuqi të mëdha si SHBA në lidhje me konflikte të ndryshme etnike. P.sh., SHBA kërkon respektim të integritetit territorial të Gjeorgjisë, ndërsa në rastin e Kosovës politika e saj ka qenë pikërisht e kundërt. Politikat e Rusisë në lidhje me Kosovën dhe dy provincave në Gjeorgji, Osetia e Jugut dhe Abkhazia, janë gjithashtu kontradiktore. Po kështu nuk ka përputhshmëri në raport me politikën e Turqisë ndaj Qipros dhe minoritetit Kurd të Turqisë, as edhe në lidhje me Kurdët në pjesën e veriut të Irakut.

Dukshëm, fuqi të ndryshme ndërmarrin politika për të ndjekur interesat e tyre dhe kjo në mënyrë të pashmangshme prodhon tensione. Meqenëse këto fuqi, përfshirë dhe SHBA-në si superfuqia e vetme, nuk janë konseguente kur shfaqin pozicionet e tyre, ato humbasin besueshmërinë edhe në raste kur mund të kenë të drejtë për çështje të veçanta.

Kështu, është e nevojshme një qasje e re ndaj këtyre çështjeve. Sfidat që bota po përballon kërkojnë një Organizatë të Kombeve të Bashkuara më të besueshme dhe më efikase. OKB mund më të vërtetë kërkojë ristrukturim dhe ripërcaktim të rolit të saj. SHBA duhet të marrë një iniciativë në këtë drejtim.

Së fundi, por jo nga rëndësia, SHBA duhet të shohë se si parimet e saj mund të përfshihen në politikën e jashtme

Amerikane. Në artikullin “The New American Realism” botuar në revistën “Foreign Affairs” të korrik/gusht 2008, Condoleezza Rice deklaronte se politika e jashtme amerikane synon të shkrijë interesin kombëtar me parimet, duke pranuar kështu më së pakti nevojën për ta bërë këtë. Presidenti i ardhshëm do të ketë një mundësi të rrallë për të farkëtuar një fillim të ri për SHBA në një botë që është e paduruar për lidhshmëri parimor dhe zgjidhje kolektive.

Republika Çeke Vít Štálecký, Instituti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Pragë

Agjenda e marrëdhënieve Çeko-Amerikane ka qenë se fundi e dominuar nga një çështje e vetme, e cila ka çuar në daljen e një sërë çështjeve të tjera të rëndësishme. P.sh., gjatë negociatave mbi përfshirjen e Çekisë në sistemin e Mbrojtjes Kombëtare Raketore (që u përqendruan rreth vendosjes në territorin çek të një baze radarësh amerikanë) problemi i politikës së vizave të SHBA-së ndaj Çekisë, një nga çështjet më të rëndësishme në marrëdhëniet reciproke, u trajtua dhe u çua përpara me mjaft zell. Kjo çështje veçanërisht ishte një barrë në marrëdhëniet politike pasi ishte një çështje e ndjeshme për publikun çek. Edhe më e rëndësishme, Marrëveshja Ushtarake Çeki-SHBA mund të stimulojë rritje në fushën kërkimore-shkencore dhe të zhvillimit, e cila për pasojë të lidhet direkt me zhvillimin e këtij projekti konkret ushtarak.

Zhvillimet aktuale kanë konfirmuar përsëri se pikëpamja e thjeshtuar e “Europës së Re”, e zhvilluar dhe nxitur nga disa analistë dhe komentues amerikanë, është dhe ka qenë gjithmonë e pabazë. Vendet reja të BE-së ose, edhe më tepër, vendet e Vishegradit, përbëjnë një grup heterogjen që ndryshojnë gjerësisht në qëndrimet e tyre ndaj politikës së SHBA-së. Procesi i negociatave mbi vendosjen e elementëve të Mbrojtjes Kombëtare Raketore në Republikën Çeke dhe Poloni e ilustron më së miri këtë argument. Në mënyrë të veçantë, ndryshe nga disa vende të tjera të “Europës së Re”,

gjatë luftës në Irak, Republika Çeke ofroi vetëm një spital ushtarak dhe në njësi mbrojtjeje kimike, të dyja me kushtin që ato të mos merrnin pjesë në operacione ushtarake. Njëpërmjet manovrave të lodhshme, diplomacia çeke gjithashtu arriti të shmangë drejtpërsëdrejti nëse vendi bënte apo jo pjesë në të ashtuquajturin koalicioni i vullnetit.

Arritja më e rëndësishme e diplomacisë çeke gjatë negociatave për Mbrojtjen Kombëtare Raketore ishte nxitja e “NATO-izimit” i vendndodhjes së tretë, e cila u përfshi në deklaratën e Samitit të NATO-s në Bukuresht në prill 2008. Kjo krijoi mundësinë për të thelluar debatin strategjik mbi ndërlidhjen ndërmjet sistemit amerikan të vendndodhjes së tretë dhe planit të NATO-s për të krijuar sistemin Active Layered Theatre Ballistic Missile Defense (ALTMDB). Bashkëfeksionimi i të dy sistemeve duhet që në mënyrë funksionale të rrisë kapacitetet mbrojtëse të Europës praktikisht kundër të gjitha llojet e raketave balistike, të cilat vazhdimisht janë konsideruar si kërcënime të mundshme në dokumente të ndryshme strategjike. Qeveria çeke arriti në vendimin për ta kthyer çështjen në “shumëpalëshe” dhe tejkalojë formatin dypalësh dhe, institucionalizimin me strukturat e NATO-s ka qenë prioritet.

Me gjithë faktin se Republika Çeke është shtet i vogël për të influencuar strategjikisht (megjithëse, është interesante që brenda BE-së mund të quhet vend me fuqi të mesme), roli dhe influenca e diplomacisë çeke në raport me administratën e SHBA-së mund të rritet realisht në të ardhmen. Megjithëse ka qenë një nga tiparet dalluese të politikës së jashtme çeke që nga fillimi i viteve 1990, theksimi me forcë ndaj të drejtave të njeriut duket se ka humbur pak, por jo të gjithë rëndësinë e vet, ndërkohë që prioritetet e tjera ngelen konstante. Reagimi i qeverisë Çeke ndaj krizës në Gjeorgji në gusht 2008 lë të kuptojë se prezenca Amerikane në sistemin evropian të sigurisë është akoma e mirëpritur. Ajo shërben si një kundërpeshë ndaj influencës në rritje të Ruisë dhe lehtëson pozitat e disa fuqive evropiane, të cilat shpesh shihen si tepër pragmatike në marrëdhëniet me Rusinë.

Të gjitha dokumentet strategjike të Çekisë përmendin rëndësinë e lidhjes transatlantike. Përforcimi i saj do të jetë

një nga prioritet kryesore të presidencës çeke të BE-së gjatë 2009. Kështu, Republika Çeke nuk do ta zëvendësojë partneritetin strategjik transatlantik. Pozicionet e saj të politikës së jashtme, në të njëjtën kohë, nuk do të bazohen në ndenjen e “veçantësisë” çeke, e cila lehtësisht përkthehet në preferencë për zgjidhje bilaterale.

Franca

Susanne Nies, IFRI, Bruksel dhe Laurent Hamida, gazetar i pavarur, Paris

Në OKB, fjala e Kryeministrit Francez Dominique de Villepin më 14 shkurt 2003 hyri në histori: Franca e hodhi poshtë luftën në Irak dhe kundërshtoi politikën e jashtme të Presidentit Bush. Por Franca nuk u mjaftua vetëm me kundërshtimin e sprovës ndaj Irakut, ajo pati gjithashtu sukses në krijimin e një fronti të bashkuar për ta penguar atë. Ky qëndrim krijoi një ndjenjë të konsiderueshme hidhërimi ndërmjet dy vendeve. Kjo prirje ishte shfaqur që më herët në vitin 2002, duke u përplasur rëndë me angazhimin e Francës në Afganistan (ISAF), por edhe me hapjen e hapësirës së saj ajrore për forcat amerikane gjatë luftës në Irak.

Një model kryesisht negativ ndaj Uashingtonit karakterizoi vitet e mëvonshme të presidencës së Shirakut megjithëse dy vendet vazhduan të bashkëpunojnë për çështje të rëndësishme dhe negociojnë së bashku. Kriza në Haiti, ku Franca dhe SHBA bashkëpunuan për të hequr nga pushteti presidentin Haitian Aristide, ishte përpjekja e parë “për të rindërtuar urën”. Viti i fundit i qeverisjes së Shirakut tregoi një përmirësim të vërtetë në marrëdhëniet Franko-Amerikane. Qëndrimi negativ i Shirak-Villepin u kritikua nga brenda prej anëtareve me peshë të UMP (Partisë për një Lëvizje Popullore), veçanërisht nga ministri i Brendshëm Nikola Sarkozy dhe ambasadori David Levite. Levite u përpoq të rikrijonte një atmosferë në të cilën diplomacia të rimerrte veten - dhe sot ai është një nga këshilltarët politikë me peshë të Presidentit Sarkozy.

Trazirat në marrëdhëniet franko-amerikane u dukën qartë në sondazhet, të cilat arritën kulmin në 2004 dhe ranë në vitin 2007. Në SHBA sloganet anti-franceze u bënë gjithnjë edhe më të shumta dhe rezultuan në një reagim të ngjashëm anti-amerikan në Francë. Kështu një sondazh i CSA/La Croix në shtator 2004 tregonte se 33% e francezëve ishin të preokupuar nga politika e Bushit, krahasuar me 12% katër vite më parë. Por në vitin 2007 situata ndryshoi përsëri, me 48% të popullsisë franceze që e konsideronte SHBA-në si një aleat të rëndësishëm.

Në fillim të vitit 2009, rendi ndërkombëtar financiar dhe ekonomik do të dominojë agjendën transatlantike: kriza bankare dhe goditja e kredive që filloi në SHBA, por që goditi dhe sistemin bankar europian dhe bizneset, kërkon një qasje të përbashkët. Disa mendojnë për një “Breton Woods” të ri, shtrëngimin e sistemit ndërkombëtar financiar, shtim të rregullimit të fondeve të investimeve, por edhe zgjerimin e forumeve ndërkombëtare si G8.

Për sa i përket agjendës së politikës së jashtme, kontrolli mbi krizën në Afganistan, kthimit të Francës në strukturat e integruara ushtarake të NATO-s në këtë kontekst, por edhe Lindja e Mesme dhe Irani natyrshëm do të jenë në agjendë. Sa për Iranin, Presidenti Sarkozy tashmë e ka vendosur Francën gjithnjë e më tepër me SHBA sesa Shiraku. Megjithatë, lojtarë të shumë ekonomike dhe politike franceze kërkojnë që agjenda e Iranit të zgjerohet përtej çështjes bërthamore, (ashtu si edhe disa analistë dhe politikanë në SHBA) duke shpresuar se Akti për Sanksionet Iran-Libi (ISLA) mund të hidhet poshtë nga presidenti i ri i SHBA-së.

Aktorë të rëndësishëm në të dy vendet mendojnë se integrimi i Iranit në komunitetin botëror do të ndihmonte gjithashtu në stabilizimin e Afganistanit dhe Lindjes së Mesme. Në vitin 2001 Irani bashkëpunoi ngushtë me SHBA-në për të hequr pushtetin e regjimit taliban nga Kabuli. Nuk ka zgjidhje të Afganistanit pa Iranin. Në Afganistan, interesat e Iranit konvergojnë me ato të NATO-s dhe SHBA-së. Irani nuk mund ta pranojë një rivendosje të një regjimi taleban me marrëdhënie të afërta me Pakistanin. Irani gati sa nuk hyri në luftë me Afganistanin në vitin 1997 dhe aktualisht po humbet

qindra ushtarë çdo vit duke u përpjekur që ndalojë trafikimin e drogës në Iran nga Afganistani.

Në Francë ka nga ata që presin për një ndryshim të politikës së SHBA-së ndaj Pakistanit. Vendimi nga Presidenti Sarkozy për të dërguar përforcime në Afganistan mund të perceptohet si një përpjekje për të influencuar strategjinë e Amerikane në rajon dhe jo si një rënie dakord me Presidentin Bush. Shumë në Francë besojnë se nuk ka zgjidhje në Afganistan pa zgjidhur problemin e mbështetjes së talebanëve nga Pakistani. Po kështu besohet se i vetmi vend që mund të ushtrojë ndonjë lloj influence ndaj Pakistanit është SHBA.

Për sa i përket Ruisë, më parë duhet të zgjidhen divergjencat në interesat midis SHBA-së dhe vendeve perëndimore anëtare të BE-së.

Sa për krizën financiare, Presidenti Sarkozy po përpiqet të krijojë një kuadër të ri, i cili është nëngrupi i përbërë nga katër vende të G8, në mënyrë që të mos fragmentojë pozicionet europiane dhe të arrihet në një konsensus. Në të njëjtën kohë ai synon zgjerimin e G8, duke integruar vende të tjera me rëndësi dhe vendimmarrëse si Brazili, India, Kina, Meksika dhe Afrika e Jugut.

Lidhur me çështje të tjera të politikës së jashtme, riintegrimi i plotë i Francës në NATO, por dhe përforcimi i Politikës së Jashtme të Përbashkët dhe Sigurisë (CFSP) janë çështje të rëndësishme për administratën e Sarkozisë. Në vend që t'i shohë NATO-n dhe CFSP si të ndara, Franca i percepton të dyja si plotësuese, me NATO-n që shërben si forum kryesor për debatin transatlantik. Franca dëshiron që t'i japë BE-së një vrull të ri nëpërmjet përforcimit të CFSP. Kjo përkon me pozicionin e saj mbi ratifikimin e Traktatit të Lisbonës. Franca e Sarkozisë mbështet fuqishëm BE si aktor politik. Ajo beson se samiti i jashtëzakonshëm për krizën e vendeve të G4 europiane në fillim të tetorit 2008 ishte më shumë një shenjë uniteti të BE-së ashtu si ishte edhe hedhja poshtë e në mënyrë demonstrative e bilateralizmit në raport me Moskën gjatë krizës së Gjeorgjisë në gusht dhe shtator 2008. BE kështu do të jetë një instrument i rëndësishëm i politikës së jashtme të Sarkozisë, që ndryshon dukshëm nga

ajo e pararendësit të tij dhe për pasojë e vendos Francën në binarët e diplomacisë postmoderne. Por marrëdhënia e mundimshme franko-gjermane hedh hije mbi këtë pozicion dhe kërkon përmirësim urgjent.

Pritshmëria më e rëndësishme në raport me administratën e re të SHBA-së është rikthimi te multilateralizmi. Angazhimi aktiv i Francës dhe BE-së në “harkun e krizës” nga Lindja e Mesme në Afganistan dhe në Kaukaz gjithashtu, si dhe ripërcaktimi i sistemit financiar ndërkombëtar - të gjitha këto çështje do të jenë në krye të agjendës transatlantike të Parisit.

Gjermania

Alexander Skiba and Jan Techau, Këshilli Gjerman për Marrëdhëniet me Jashtë, Berlin

Marrëdhëniet gjermano-amerikane u dëmtuan rëndë nga mosmarrëveshjet mbi pushtimin e Irakut gjatë administratës së Bushit: vendimi i Uashingtonit për të filluar luftën - për pikëpamjen gjermane - pa një mandat të OKB-së dhe një kauzë të drejtë, e përzierë më nuancat antiamerikane gjatë fushatës për t'u rizgjedhur e Kancelarit Shreder në vitin 2002, të gjitha së bashku rezultuan në një pilulë helmuese për marrëdhënien. Iraki, megjithatë, ishte vetëm maja e ajsbergut për sa i përket mosmarrëveshjeve transatlantike: politikat e burgimit të SHBA-së si u demonstruan nga Guantanamo, mbrojtja raketore në territorin evropian, një politikë e qartë në favor të biznesit në lidhje me ngrohjen globale dhe ajo çka u pa si sabotim i protokollit të Kiotos, nuk ishin ogur i mirë për marrëdhënie të përzemërta. Me ardhjen e qeverisë së Merkel dhe me rizbulimin e përfitimit nga multilateralizmi në Uashington, toni dhe përmbajtja e punëve u përmirësuan dukshëm. Projekti më i prekshëm në këtë drejtim ishte politika tregtare transatlantike.

Për vitin 2009, Gjermania synon qartazi një largim nga ditët e vështira të administratës së Bushit. Ndërsa një shumicë e dukshme politikanësh duket se favorizojnë fitoren e Obamës, një grup i konsiderueshëm brenda parive konservatore do të

kishte preferuar McCain. Pavarësisht nga kjo, prioritete kryesore për përmirësimin e marrëdhënieve janë: sigurimi i një zgjidhje paqësore për krizën nukleare me Iranin, duke synuar një Angazhim ndaj procesit të post-Kiotos (përfshirë dhe një rol udhëheqës për dhe një angazhim nga SHBA) dhe integrimin e mëtejshëm ekonomik transatlantik.

Irani është një çështje relativisht delikate për Gjermaninë pasi Teherani është partneri i dytë më i madh tregtar i BE-së. Nxitja e Uashingtonit për sanksione më të ashpra bie në konflikt me interesat e Berlinit për t'u armiqësuar në mënyrë të panevojshme me komunitetin e biznesit gjerman. Megjithatë nga pikëpamja e gjermane nuk ka alternativa për qasjen e dyfishtë karotë-dhe-shkop. Ndërsa Berlini pret përfshirje më të drejtpërdrejtë dhe më të madhe të SHBA-së në përpjekjet për negociim me Iranin, të gjitha fraksionet politike ngelen në kundërshtim të fortë ndaj “zgjidhjeve” ushtarake.

Ndryshimi i klimës është një çështje me peshë në Gjermani: Berlini pret që SHBA të bëjë hapa konkretë dhe t'i qëndrojë angazhimeve të saj të marra në Heiligendamm për të ulur emetimet e dioksidit të karbonit si pjesë e procesit të OKB-së.

Një projekt tjetër i dashur për Gjermaninë është Këshilli Transatlantik Ekonomik, i krijuar në prill 2007 na samitin SHBA-BE në Uashington. Berlini ka ndër mend të çojë përpara punën e këshillit në 2009. Pritshmëritë janë që këshilli të bëhet më pak i politizuar dhe nxitjet proteksioniste të administratës së re dhe Kongresit të SHBA-së të mos i dëmtojnë këto përpjekje.

Kriza e Gjeorgjisë e gushtit 2008 ka nxjerrë çështjen se si të menaxhohet Rusia si çështje në krye të agjendës transatlantike: Gjermania preferon një qasje më përfshirëse ndaj Moskës dhe pret që Uashingtoni të veprojë në harmoni me BE në lidhje me Rusinë. Masat e ashpra si përjashtimi i Rusisë nga G8 ose bllokimi i hyrjes së saj në OBT shihen si kundërproduktive dhe do të çonin në grindje serioze transatlantike nëse do të ndiqeshin nga SHBA. Berlini ka lajmëruar megjithatë se do të rishikojë marrëdhëniet tradicionalisht miqësore me Rusinë mbas veprimeve të saj në Gjeorgji.

Gjatë vitit 2009, vetë Gjermania do të hyjë në fushatën e zgjedhjeve elektorale federale. Megjithëse rrallë politika e jashtme del në krye të shqetësimeve të elektoratit, fushata mund të shfaqë dhe ndarje në çështje si angazhimi ushtarak i Gjermanisë në Afganistan apo mjetet “e duhura” në trajtimin e Iranit dhe Ruisë. Administrata e ardhshme e SHBA-së ka shumë mundësi që të kërkojë kontribut më të madh dhe shkurtrim më të vogël të trupave në Afganistan nga aleatët e saj në Europë. Kjo është një pritshmëri amerikane që elita politike e Gjermanisë është jo mirë e pajisur për t’u marrë: pasi pasioni pacifist kundër misionëve luftarake janë dominues për publikun gjerman dhe shfrytëzohen politikisht nga të tri partitë që anojnë nga e majta, “koalicioni i madh” do të ketë pak marzh manovre për të përballur kërkesat e NATO-s dhe SHBA. Kur të vijë puna për çështje “të forta” politike, Gjermania do të ngelet në një gjendje paralize në 2009.

Hungaria

**Gergely Romsics, Instituti Hungarez Për Çështjet
Ndërkombëtare, Budapest**

Gjatë dy mandateve të administratës së Bushit, Hungaria ka kaluar nga një partner i pabesueshëm në një aleat të respektueshëm dhe përsëri prapa atje ku ishte. Së pari, qeveria konservatore dështoi në angazhimin e mjaftueshëm me kauzën e pas 11 shtatorit, një dështim simbolik që u përkeqësua nga një vendim gati jo-diplomatik, vendim i minutës së fundit për të pajisur forcat ajrore Hungareze me avionë suedezë kundrejt atyre amerikane. Hungaria bëri përmirësime, nën qeverisjen socialiste, duke u bërë pjesë e “Europës së Re” dhe mbështetur luftën në Irak dhe Afganistan. Kjo periudhë më e ngrohtë në marrëdhëniet SHBA-Hungari zgjati derisa grindja energjetike midis Perëndimit dhe Ruisë u bë dominuese e agjendës. Hungaria, e varur në mënyrë të konsiderueshme nga gazi natyror Rus, ishte ndër të parat që mbështeti iniciativën e Ruisë për gazsjellësin, i parë gjerësisht si sfidë ndaj projektit të BE-së Nabuko, me pasoja serioze me gjithë insistimin

hungarez se Budapesti nuk po a braktiste as iniciativën e BE-së. Ndërsa ky episod duket se po përfundon, Hungaria ende po lëkundet prej eksperiencës për të arritur një baraspeshë midis varësisë energjetike dhe dedikimit ndaj vlerave europiane dhe bashkëpunimit.

Kjo eksperiencë e shkuar në mënyrë të pagabueshme përcakton pritshmërinë e vetme më të rëndësishme ndaj administratës së re në Uashington. Bazuar në ngjarje të fundit, është pak e mundur që BE-ja vetëm të formojë një politikë të moderuar dhe të bashkuar për t'u marrë me Rusinë më intensivisht. Dhe për aq kohë sa kjo nuk ka për të ndodhur, Hungaria do të jenë e rrezikuar, duke pritur që ngjarjet e 2006-2007 të ripërsëriten. Hungaria mund t'i shpëtojë aktit shkatërrues të gjetjes së ekuilibrit si në vitet e kaluara, nëse një administratë amerikane pa paragjykime ndërmerr detyrën e madhe të ndërtimit të një marrëdhënie bashkëpunimi afatgjatë me Europën në tërësi, jo aq shumë sa për të ndjekur në mënyrë strikte preferencat e SHBA-së, por për t'u angazhuar në një proces të pakufizuar dhe vetëm me një orientim të përgjithshëm të qartë: kycje e Ruisë në regjime te ndryshme bashkëpunimi, duke përdorur stimuj pozitivë dhe negativë bazuar në situatën aktuale në çdo moment tjetër të dhënë. Nëse një strategji e tillë do të ketë sukses, SHBA, së bashku me partnerë të fortë europianë, duhet të përkujdeset për të zvogëluar rreziqet për vende të cenueshme si Hungaria - përndryshe asgjë nuk do ta ndalojë Moskën që të përdorë strategjitë e saj përça-e-sundo, të njohura nga të gjithë nga e kaluara e afërt dhe jo dhe aq e afërt.

Nëse vende si Hungaria do të ripërfshihen në koalicione të gjera për t'u marrë me Rusinë, këto vende të vogla kontribuojnë në përpjekjet më të gjera me cilësinë e tyre të të pushuarit së qeni atë çka shumë në Moskë e besojnë se do të ngelen përgjithmonë: gurë shahu të një loje në të cilën pranimi i politikave të drejtuara nga vlerat dhe/ose afatgjata pengohet fakti i të qenit të cenueshëm.

Në të kaluarën, vende të vogla të Europës Qendrore janë "luajtur" nga diplomacia e SHBA-së gjithashtu. Prestigji i takimeve bilaterale, premtimi i privilegjeve ka rezultuar tepër

tundues, si u duk dhe nga rasti i negociatave për regjimin e vizave. Vende të vogla dhe të reja duhet të mësojnë, për pasojë, se ato duhet të merren jo vetëm me Rusinë, por edhe me aleatin e tyre të afërt SHBA, nëpërmjet institucioneve të fuqishme, të bazuara mbi bashkimin e preferencave, që BE përfaqëson. Nëse të gjitha këto mësimë mësohen, dhe nëse administrata e re e SHBA-së ka vullnetin për t'u marrë me çështjen ruse së bashku me BE-në në mënyrë konstruktive, perioda më e dhimbshme në politikën e jashtme hungareze për disa kohë mund të bëhet ajo që në fakt duhet të jetë: një kujtim i së kaluarës.

Letonia

**Ilze Sedlina, Qendra Për Politika Publike
PROVIDUS, Riga**

Marrëdhëniet letono-amerikane gjatë administratës së Bushit kanë qenë shumë pozitive dhe intensive, të kaluara me dy vizitat e Presidentit Bush në Riga (njëra me rastin e samitit të NATO-s në Riga në vitin 2006). Intensiteti i marrëdhënieve letono-amerikane gjatë epokës së Bushit mund të shpjegohen pjesërisht nga objektivat kryesore të politikës së jashtme Letone - integrimi në BE dhe NATO - ku bashkëpunimi me SHBA luajti një rol të rëndësishëm. Megjithatë pritet që këto marrëdhënie të bëhen më pak intensive në vitet që vijnë për dy arsye. Së pari, anëtarësimi në NATO dhe BE i Letonisë kanë gjasa që të çojnë në një fazë normalizimi të marrëdhënieve letono-amerikane dhe së dyti, mund të këtë një dobësim të intensitetit për arsye të ndryshimit të presidentëve letonë. Ish-presidenti Vaira Vīcie-Freiberga ishte i orientuar nga politika e jashtme dhe i fokusuar qartazi në forcimin e lidhjeve me SHBA. Por presidenti aktual Valdis Zatlers është më i interesuar për politikën e brendshme. Kjo megjithatë nuk do të ndryshojë themelet e politikës së jashtme letone, e cila e shikon SHBA-në si partnerin kryesor strategjik të saj. Për këtë arsye dhe për shkak të anëtarësimit jo të hershëm të Letonisë në BE (që në vitin 2004), bashkëpunimi ndërmjet Letonisë dhe SHBA-

së deri tani ka qenë i bazuar më shumë në bilateralizëm sesa në kuadrin e marrëdhënieve BE-SHBA.

Dy çështjet e vetme në të cilat Letonia mori një qëndrim të kundërt nga ai i SHBA-së ishte në lidhje me Gjykatën Ndërkombëtare Kriminale (ndaj të cilës SHBA ka qenë armiqësor) dhe me Protokollin e Kiotos, ku Letonia u vu në krah të BE-së. Kjo prirje ka gjasa që të vazhdojë, me Letoninë që do të përdorë marrëdhëniet dypalëshe dhe kuadrin bashkëpunues BE-SHBA për të punuar mbi çështjet transatlantike.

Çështje kyçe në agjendën transatlantike për Letoninë do të vazhdojnë të jenë: (1) siguria dhe bashkëpunimi me fqinjët lindorë të Europës (prioritet për Letoninë janë Gjeorgjia, Moldavia dhe Ukraina), (2) energjia dhe (3) bashkëpunimi ekonomik.

Siguria dhe bashkëpunimi. Është e vështirë që të imagjinohet një çështje sigurie ku Letonia nuk do të mbështeste SHBA-në, përfshi politikën e SHBA-së në Irak dhe Afganistan. Letonia nuk e vë në dyshim mbështetjen nga SHBA pasi Uashingtoni konsiderohet si garancia e vetme e sigurisë së vendit. Në terma praktikë, siguria ka qenë gjithashtu fusha ku bashkëpunimi i Letonisë dhe SHBA ka qenë dhe më i afërt. Meqë kjo lidhet me anëtarësimin në NATO, nuk ka gjasa që të ndryshojë në të ardhmen. Pritet që SHBA të kërkojë për - dhe Letonia ka gjasa që të pranojë - kontribut më të madh nga aleatët për misionin e NATO-s në Afganistan.

Interesi i Letonisë në forcimin e politikës së SHBA-së ndaj fqinjëve lindorë të Europës është bërë një çështje e ditës me ndërhyrjen ushtarake të Rusisë në Gjeorgji. Letonia e dënon me forcë agresionin e Rusisë dhe beson se SHBA, NATO si dhe BE - aktorët kryesorë në stabilitetin transatlantik - duhet të luajnë një rol drejtues në mbrojtjen e lirisë dhe sigurisë së vendeve fqinje të BE-së. Letonia gjithashtu i mëshon nevojës për t'i ofruar një Plan Veprimi për Anëtarësim (MAP) Gjeorgjisë dhe Ukrainës si një përgatitje për anëtarësim në NATO. Letonia beson se forcimi i lidhjeve midis NATO-s dhe vendeve të Kaukazit do të garantojë sovranitetin dhe integritetin territorial të vendeve sovrane, më shumë stabilitet

në rajon dhe do të pengonte përshkallëzimin e konflikteve të reja ndërmjet Ruisë dhe vendeve fqinje.

Së dyti, varësia nga burimet energjetike ruse është një nga shqetësimet kryesore në Letoni. Letonia do që të ulë këtë varësi dhe shikon SHBA si një partner serioz në kërkim të mundësive për të shpërndarë furnizimin me energji dhe zhvilluar burime energjetike alternative.

Së fundi, Letonia do të vazhdojë të punojë për intensifikimin e marrëdhënieve ekonomike me SHBA-në, e cila synon të tërheqë investime dhe rrisë konkurrencën e tregut të saj (për shkak të pozicionit të favorshëm gjeografik) në mënyrë që të ruajë zhvillimin ekonomik.

Lituania

Julijus Grubliauskas, IIRPS, Vilnius University

Balanca e pushtetit në marrëdhëniet ndërkombëtare është karakterizuar substancialisht gjatë erës së Presidentit George W. Bush, nga Shtetet e Bashkuara që po humbitnin pozicionin e tyre hegjemonik dhe nga rendi i botës një polare në rënie. Amerika sidoqoftë, do të mbetet një fuqi e madhe në të ardhmen e afërt, por statusi i saj si superfuqi gjendet nën shpatën e Damokleut. Madhështia e ekonomisë kineze që rritet në mënyrë konstante, rigjallërimi i ambicieve perandorake të Ruisë dhe rritja e paqëndrueshmërisë ndërkombëtare (si rrjedhim i konflikteve të “pashkrira” në Europën Lindore dhe në Kaukaz, i manipulimit të ligjit ndërkombëtar dhe tensioneve të mprehta në Lindjen e Mesme) janë vetëm nder rreziqet më shpesh të përmendura për “rendin botëror amerikan”.

Çelësi i fuqisë hegjemonike globale të Shteteve të Bashkuara ka qenë gjithmonë aftësia për të ndërtuar aleanca të besueshme me vendet mike dhe për të luajtur letrat e duhura kundër atyre armike. Tashmë, çelësi është pothuajse i thyer, aleancat nuk janë më kaq të besueshme prej imazhit jashtëzakonisht të ulët të SHBA-së midis aleatëve. Letrat e duhura po mbarojnë ashtu si po perëndon edhe madhështia ekonomike amerikane.

Një shembull i mirë i dobësimit të rendit botëror amerikan është konflikti i fundit në Gjeorgji. Ky konflikt tregoi se Shtetet e Bashkuara janë aktualisht të paaftha të mbrojnë interesat e tyre gjeopolitike në rajonin e Kaukazit. Pavarësisht nga disa deklarata të forta drejtuar Ruisë, Shtetet e Bashkuara nuk arritën të siguronin një zgjidhjeje paqësore të konfliktit ose mbrojtjen e integritetit territorial të aleatit të tyre më të madh në rajonin e Kaukazit. Linjat e transportit të energjisë përmes Gjeorgjisë, të cilat janë strategjikisht të rëndësishme për Shtetet e Bashkuara (po aq sa për BE-në), janë bërë të pabesueshme.

Dobësimi i fuqisë amerikane në marrëdhëniet ndërkombëtare është një sfidë për Europën dhe BE duhet të gjejë strategjinë e duhur për të reaguar ndaj kësaj. Periudha e pas-Bushit shoqërohet me një parregullsi të re globale, e cila është një disavantazh si për SHBA-në ashtu edhe për BE-në. Ekziston akoma një pikëpamje popullore në Europë se dobësimi i fuqisë globale amerikane do të ishte një avantazh për BE-në; duke hapur mundësitë e Europës për të përdorur vakumet e fuqisë që po shfaqen në botën e post-unipolare në mënyrë që të bëhet një nga fuqitë (në mos jo e vetmja) në sistemin ndërkombëtar. Një interpretim i tillë do të ishte një gabim i rëndë për Europën. Për shkak të përçarjes së madhe politike (për shembull në lidhje me politikën energjetike) BE-ja nuk do të ishte e aftë të përballëj me Rusinë apo Kinën në rritje ose me sfida të tjera globale.

Atëherë, BE-ja ka nevojë për një SHBA të fuqishme dhe pritshmëria kryesore e administratës së re të Shteteve të Bashkuara është ajo e të gjeturit të ideve të reja në mënyrë që Amerika të përballë sfidat e ardhshme.

Ishin dy ide shumë të rëndësishme dhe të fuqishme që vinin nga dy kandidatët kryesorë në zyrën e presidentit të ri të Shteteve të Bashkuara: ideja e parë (e B. Obama) ishte të propozohej një ndryshim madhor në ekonominë amerikane, duke shpresuar në forcimin e Shteteve të Bashkuara si një superfuqi ekonomike. Ideja tjetër (e J. McCain) propozonte një përjasje të re të Shteteve të Bashkuara në marrëdhëniet ndërkombëtare, duke reaguar në mënyrë aktive ndaj ambicieve perandorake të Ruisë dhe formacionit multipolar të botës, në vend të pranimit të tyre.

Europa nuk duhet të zgjedhë se cila nga këto ide i duket më e favorshme, BE-ja ka nevojë për të dyja. Atëherë, duhet të

jenë dy pritshmëri kryesore përkundrejt presidentit të ardhshëm: e para, rigjallërimi i ekonomisë së Shteteve të Bashkuara, e dyta, forcimi i fuqisë globale të Shteteve të Bashkuara si dhe rifitimi i imazhit “moral” të një vendi me qëllime të mira. BE-ja aktualisht e percepton SHBA-në më shumë si një konkurrent sesa si një aleat. Në “parregullsinë e re globale” nuk ka vend për një kompeticion të tillë.

Pritshmëritë e Lituanisë nga administrata e re e Shteteve të Bashkuara nuk ndryshojnë nga ato europiane të lartpërmendura. Sidoqoftë, për shkak të një situatë gjeopolitike të veçantë, Lituania ka disa shpresa e dëshira shumë individuale dhe konkrete.

Së pari, Lituania duhet të konfrontohet me disa probleme të vështira të sigurisë ekonomike për shkak të mbylljes së mundshme të centralit bërthamor të Ignalina-s dhe të presionit ekonomik gjithnjë e më shumë agresiv të Rusisë ndaj vendeve baltike. Prandaj, shpresat e Lituanisë janë drejtuar ndaj përpjekjeve të administratës së ardhshme të Shteteve të Bashkuara për të garantuar sigurinë energjetike për vendet baltike. Këto përpjekje do të përfshinin mbështetjen për ndërtimin e planifikuar të terminalit të gazit natyror të lëngëzuar dhe të centralit bërthamor në Lituani.

Së dyti, Lituania po përballet me rrezikun e të qenit një prej objektivave të ambicieve perandorake në rritje të Rusisë. Ndërhyrja ushtarake ruse në Gjeorgji ishte një shembull i qartë i një rreziku të tillë. Lituania shpreson që administrata e re e Shteteve të Bashkuara do të mbajë një qëndrim realist ndaj Rusisë dhe do të ketë synime të qarta për të operuar kurdo që të shfaqet rreziku i qartë i agresionit të huaj ndaj një prej anëtarëve të NATO-s.

Së treti, në kaosin e ri global, ndarja midis anëtarëve “të vjetër” e “të rinj” të BE-së është përgjithësisht një rrjedhim i qëndrimeve të ndryshme përkundrejt rolit të Shteteve të Bashkuara në Europë dhe politikës së jashtme të Shteteve të Bashkuara në përgjithësi, e cila është jashtëzakonisht e disfavorshme si për Lituani dhe për BE-në. Si pasojë, Lituania po shpreson shumë në administratën e re të Shteteve të Bashkuara, që ajo të rivendosë imazhin e Shteteve të Bashkuara në vendet europiane, veçanërisht në ato Perëndimore dhe të fuqizojë aleancën transatlantike.

Polonia

Jacek Kucharczyk, Instituti i Çështjeve Publike,
Varshavë

Evenimenti që karakterizon marrëdhëniet transatlantike polake gjatë epokës së Bushit, ishte lufta në Irak dhe mbështetja e pakushtëzuar, politike dhe ushtarake, që i është dhënë kësaj lufte nga qeveria e majtë e Leszek Miller. Edhe pse prezenca polake në Irak kishte mbështetje të gjerë si nga e majtas ashtu dhe nga e djathta, ajo ka qenë thellësisht e papëlqyer nga publiku i gjerë. Gjatë fushatës elektorale në vjeshtën e vitit 2007, lideri i partisë fituese të Platformës Qytetare, Donald Tusk, premtoi se do të përmbushte tërheqjen graduale të trupave polake nga Iraku.

Çështja e dytë më e rëndësishme në marrëdhëniet polako-amerikane ishte vendimi rreth vendosjes së mburojës antiraketë të Shteteve të Bashkuara në Poloni. Negociatat, filluar nga qeveria e Kaczynski-t në 2006, u përfunduan në gusht 2008 nga qeveria Tusk. Si shkëmbim për mbajtjen e mburojës, administrata e Bushit premtoi të forconte sistemin e mbrojtjes ajrore të vjetruar të Polonisë si dhe t'i jepte Polonisë garanci të mëtejshme për sigurinë.

Që prej firmosjes së marrëveshjes, në kohën e ndërhyrjes ruse në Gjeorgji, opinioni publik në Poloni, i cili kishte qenë armiqësor ndaj projektit, bëri një kthesë 180 gradëshe dhe rezultati i negociatave u mbështet nga një shumicë e cilësuar polake.

Pas zgjedhjeve të 2007-s, Polonia ka pasur një qeveri konservativ - liberale të drejtuar nga Donald Tusk duke bashkëqeverisur me një president konservativ - nacionalist, Lech Kaczynski. Në sistemin kushtetues polak, fuqia është më tepër në duart e Kryeministrit, por kjo nuk do të thotë se Presidenti nuk ka privilegje të veçanta në fushën e politikës së jashtme. Politika e jashtme të Polonisë është karakterizuar nga një rivalitet midis qendrave të forcës, i cili e bën të vështirë përcaktimin e një agjende të qartë të politikës së jashtme për vitet e ardhshme.

Invazioni rus i Gjeorgjisë dhe copëzimi që pasoi këtë vend, i vendosën çështjet e sigurisë përsëri në prioritetet e agjendës

transatlantike të Polonisë. Polonisë do t'i pëlqente t'i shihte dhe BE-në dhe Shtetet e Bashkuara të merrnin hapa për mbrojtjen e sovranitetit të Gjeorgjisë dhe integritetin territorial të saj. Ata gjithashtu duhet të shtyjnë Rusinë për të rënë dakord mbi zëvendësimin e trupave "paqeruajtëse" nga një forcë ndërkombëtare më neutrale.

Bashkëpunimi transatlantik do të nevojitet për të zgjidhur të tjera "konflikte të ngrira", të cilat i lejojnë Rusisë të ndërhyjë në çështjet e vendeve fqinje dhe të republikave ish-Sovjetike: Moldavia (Transnistria) dhe Azerbajxhani (Nagorno-Karabakh), si dhe konflikte të mundshme si Krimea në Ukrainë.

Si presidenti dhe qeveria duket se ndajnë një pikëpamje kritike ndaj politikës së jashtme të Rusisë dhe nevojës për ta përmbajtur atë. Ndryshimet kanë të bëjnë me mjetet që mund të përdoren për këtë qëllim dhe veçanërisht gjuha e debatit mbi Rusinë, me qeverinë që duhet të jetë më e butë në mënyrën e të shprehurit dhe e orientuar drejt bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë fushë. Pavarësisht nga ky pozicion, Polonia do të presë që administrata e re e Shteteve të Bashkuara të jetë e "ashpër me Rusinë" dhe të lërë mënjanë qëndrimin e "partneritetit strategjik" që karakterizonte pjesë të presidencës së Bushit.

Polonia do të presë që administrata e re e Shteteve të Bashkuara të ushtrojë presion në çështjen e përfshirjes së Gjeorgjisë dhe Ukrainës në përgatitjet e anëtarësisë në NATO duke u ofruar atyre PAA (Plane Aksioni për Anëtarësi). Polonisë do t'i pëlqente të shihte Shtetet e Bashkuara të merrnin hapa drejt rigjallërimit të NATO-s si një instrument multilateral të politikës së jashtme, duke theksuar funksionet e saj tradicionale si një furnitor sigurie për anëtarët e saj. Në të njëjtën kohë, Polonia do të vazhdojë të kontribuojë në misionet e NATO-s në Afganistan.

Rezultati i negociatave për mburojën antiraketë shihet gjerësisht si një sukses (me kryeministrin e presidentin në rivalitet për të marrë meritat për të). Atëherë pritet që administrata e re do të ndjekë dispozitat e marrëveshjes me përpikëri. Kjo i përket jo vetëm vendosjes së një sërë raketash

patriotike (si përcaktohet në marrëveshje), por edhe shitjen pasuese të raketave shtesë dhe pajisjeve të tjera të teknologjisë së lartë Polonisë.

Polonia do të mirëpresë përpjekjet e administratës së re për të kthyer imazhin e Shteteve të Bashkuara jashtë dhe për t'u angazhuar në aktivitete rigjeneruese dhe promovuese të demokracisë, veçanërisht në zonën post-Sovjetike. Ajo është pothuajse gati të nënshkruajë idenë e "Komunitetit të Demokracive" si u propozua nga kandidatët kryesorë presidencialë. Polonia ka shpresa se ky projekt do të ngrihet mbi Këshillin e Komunitetit të Demokracive, i cili u themelua në zgjimin e deklaratës së Varshavës në qershor 2000.

Kërkesa e vazhdueshme e qytetarëve polakë për të marrë viza para se të udhëtojnë në Shtetet e Bashkuara, akoma shkakton fyerje masive drejt administratës së Shteteve të Bashkuara. Çfarëdo progresi në këtë fushë do të ndihmojë në përmirësimin e perceptimeve publike të marrëdhënieve Polako-Amerikane.

Perceptimi i Polonisë për agjendën transatlantike është krijuar gjerësisht nga ngjarjet e fundit në Gjeorgji. Progresi në Lindjen e Mesme (Iran, Irak dhe Palestinë) shihet si domethënës deri më tani meqenëse ky progres mund të lejojë Shtetet e Bashkuara dhe BE-në t'i përkushtojnë më shumë vëmendje Rusisë së rigjallëruar. Çështje të tjera si ndryshimi klimaterik, të cilat janë prioritet për partnerët e Polonisë në BE, shihen si më pak urgjente. Kjo nuk do të thotë se Polonia do t'i kundërvihet agjendës transatlantike të BE-së në këto dhe në fusha të tjera të politikave. Përkundrazi, Polonia ka mundësi të mbështesë politika të tilla për aq sa nuk bien në kundërshtim me objektivat e politikave të jashtme polake.

Rumania

**Gilda Truica, Instituti European i Rumanisë,
Bukuresht**

Gjatë presidencës së Bushit, dy terma kanë koïnciduar me përmbushjen e synimeve të rëndësishme në agjendën

euroatlantike të Rumanisë, po aq mirë sa partneriteti strategjik i Rumanisë me Shtetet e Bashkuara. Rumania ka mbështetur koalicionin e drejtuar nga amerikanët kundër terrorizmit global, duke kontribuar me trupa në operacionet ushtarake në Irak dhe Afganistan. Kjo çoi në mbështetjen e Shteteve të Bashkuara ndaj Rumanisë në hyrjen në NATO në 2004 dhe më vonë, në caktimin e Bukureshtit si vendi mbajtës i Samitit të NATO-s në prill 2008. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe, u arrit një marrëveshje në lidhje me stacionimin e trupave amerikane në tokën rumune, “Marrëveshja e Hyrjes”, në fuqi që prej 2006.

Kundër sfondit të një orientimi të përgjithshëm pro amerikan të politikës së jashtme të Rumanisë, ka pasur një episod të vetëm në të cilin Bukureshti nuk e radhiti veten në pozicionin e Shteteve të Bashkuara (dhe të një numri të madh shtetesh anëtare të BE-së), përkatësisht vetëshpallja e pavarësisë së Kosovës, të cilën Rumania refuzoi ta njohte, duke cituar mos-observimin e principeve bazë të ligjit ndërkombëtar si arsye. Kjo, aksidentalisht, i lejoi Bukureshtit të kritikojë publikisht njohjen e fundit nga Rusa të dy rajoneve të Gjeorgjisë që dolën jashtë kontrollit pa pasur rrezikun e aplikimit të standardeve të dyfishta.

Duke qenë se arkitektura e sigurisë së Rumanisë mbështetet në një trekëndësh të përbërë, nga njëra anë nga një raport dominues me SHBA, dhe nga ana tjetër nga marrëdhënia me NATO dhe BE, Rumania inkurajon një vazhdimësi të përfshirjes dhe të angazhimeve amerikane tek fqinjët e afërt të saj.

Rumania do të pëlqente të shihte konsolidimin e sigurisë dhe stabilitetit në rajonin e Detit të Zi në një nivel të lartë në listën e çështjeve transatlantike. Shkallëzimi i fundit i konfliktit midis Rusisë dhe Gjeorgjisë duket se i akordon peshë të mëtejshme këtij prioriteti. Edhe para dhe pas hyrjes së Rumanisë në BE, zyrtarët e Bukureshtit sinjalizuan nevojën e aleatëve të Euroatlantikut për të njohur rëndësinë strategjike të kësaj fushe për sigurinë euroatlantike. Si përfundim, Rumania mbështeti lancimin e iniciativës “Partnershipi i Detit të Zi për Forum dhe Dialog” si një kuadër për dialog aktiv dhe

të hapur midis institucioneve të shoqërisë civile brenda rajonit të Detit të Zi, si dhe me partnerët europianë dhe euroatlantikë.

Për sa i përket dimensioneve të aleancës transatlantike të NATO-s, Rumania vazhdon të tregojë interes për reformën dhe zgjerimin e organizatës. Për më tepër, Rumania ka konfirmuar se do të vazhdojë të respektojë angazhimet e bëra në lidhje me Irakun, Afganistanin dhe Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë komponentin e rindërtimit të paskonfliktit.

Një objektiv i veçantë i Rumanisë është të sigurojë eliminimin e kërkesës për vizë për udhëtimin e shtetasve të saj në Shtetet e Bashkuara, nëpërmjet përfshirjes së saj, së bashku me vendet e tjera të Europës Lindore, në programin e heqjes së vizave. Pengesa kryesore formale në këtë sens është masa shumë e madhe e refuzimit të aplikimeve për vizë të bëra nga qytetarët rumunë: 37%, më e larta e të gjithave vendeve anëtare të BE-së që janë akoma subjekt i kërkesës së vizës. Ky aspekt është i rëndësishëm kryesisht për shkak të impaktit negativ në opinionin publik, sepse shtyn në irritim dhe mund të perceptohet si veprim jo reciprok i mbështetjes së vazhdueshme të treguar nga Rumania drejt iniciativave amerikane, veçanërisht në terma ushtarake.

Para hyrjes në BE, Rumania orvatej të konsolidonte kuadrin bilateral të negociatave në mënyrë që të shtynte përpara interesat e saj në lidhje me Shtetet e Bashkuara, dhe disa herë u kritikua nga disa vende të BE-së për atë çka dukej si një nderim i tepruar për interesat amerikane (veçanërisht, në lidhje me marrëveshjen bilaterale të 2002-shtit ku u jepej imunitet shtetasve të Shteteve të Bashkuara në tokën rumune nga mandatet e arrestit të lëshuara nga ICC - Gjykata Ndërkombëtare e Krimeve). Së fundmi, sidoqoftë, Rumania duket të favorizojë përfshirjen e interesave të saj specifike në lidhje me Shtetet e Bashkuara në agjendën bilaterale BE-SHB, mundësisht duke u mbështetur mbi një rritje të përgjegjësisë. Kështu, në lidhje me çështjet e vizave, Rumania më në fund ka zgjedhur drejtimin e fundit të negociatave. Gjithashtu, nuk ka ndodhur ndonjë episod i ri ku Rumania mund të shihej si “thyesja” e solidaritetit europian vis-à-vis Shteteve të Bashkuara, si u dëshmuua nga fakti se marrëveshja e imunitetit

e lartpërmendur nuk është ratifikuar, pikërisht për shkak të papërputhshmërisë së saj me pozicionin e BE-së për këtë çështje.

Slovakia

Ivo Samson, Qendra për Kërkime e Shoqatës
Sllloake për Politikën e Jashtme, Bratisllava

Vendet e Europës Qendrore (në këtë kontekst, pra katër vendet e Visegradit) nuk përfaqësojnë më ndonjë pikëpamje të unifikuar të një “Europë të Re” mbi administratën e Shteteve të Bashkuara dhe kjo me sa duket qëndron e vërtetë dhe për zgjedhjet presidenciale të Shteteve të Bashkuara. Është pothuajse e pamundur të vendosësh sigurinë dhe politikën e jashtme të katër vendeve në një model të qëndrueshëm teorik të përcaktuar nga terma si “atlanticizmi” ose “autonomizmi europian”. Mbase i vetmi emërues i përbashkët i politikave të këtyre vendeve është interesi dërrmues në agjendën e politikës së jashtme dhe të sigurisë së administratës së ardhshme në Uashington, ndërsa dimensionin e politikës së brendshme të Shteteve të Bashkuara ka qenë tradicionalisht i lënë pas dore, ashtu si ka qenë në Europë.

Mjaft interesant është fakti se dikush mund të observojë një konsensus të gjerë në Sllovakia midis pozicionit zyrtar të qeverisë dhe opinionit publik ekzistues vis-à-vis SHBA-së. Për më shumë se dy vjet tashmë, të dyja kanë qenë jashtëzakonisht kritikuese për politikën e jashtme të Shteteve të Bashkuara dhe SHBA-së si një e tërë. Në opinionin Poll-et e drejtuar nga Fondi Gjerman Mareshal i Shteteve të Bashkuara, vetëm 16% e popullatës e konsideronte rolin e SHBA-së në botë si pozitive.

Përgjithësisht, trendi europian për të interpretuar anti-amerikanizmin si “anti Bushizëm” dhe për të justifikuar ndjenjat kundër SHBA-së duke piketuar politikën agresive të administratës Bush, është bërë një çështje konsensusi shoqëror. Ekziston evidencë e dukshme për mbështetjen politike të

përhapur gjerësisht (për shembull në publik, qeveria dhe madje edhe disa pjesë të opozitës së djathtë) për Partinë Demokratike (shembull Senatori Barack Obama) në zgjedhjet presidenciale të 2008-ës.

Që prej themelimit të Republikës Sllovaqe në 1993, politikat e jashtme të vendit janë luhatur midis ekstremiteteve në vend që të ndiqnin një strategji të qëndrueshme afatgjatë. Kjo qëndron në kontrast të dukshëm krahasuar me vendet fqinje të Sllovakisë: Çekia, Polonia dhe Hungaria. Pas problemeve fillestare dhe serioze me administratën e Klintonit, Sllovakia ndaloi së qeni aleat de facto i politikave të sigurisë së Rusisë dhe u kthye në kombin më të artikuluar pro - SHBA "atlanticist" pas 1998-ës. Në përpjekjet e saj për të hyrë në NATO, Sllovakia mbështeti ndërhyrjen e Shteteve të Bashkuara në Irak. Siguria transatlantike ishte një term i cituar shpesh edhe në deklaratat zyrtare dhe në median masive. Dokumentet vendimtare të sigurisë dhe politikës së jashtme të Republikës së Sllovakisë (si Strategjia e Sigurisë e 2005-ës) i klasifikojnë Shtetet e Bashkuara si aleatin më të rëndësishëm të sigurisë dhe politikës së jashtme të vendit. Pas ndryshimit të qeverisë në 2006-ën, sidoqoftë, retorika e qeverisë Social-Demokrate u bë përsëri shumë kritike ndaj politikës së jashtme të SHBA-së: Sllovakia tërhoqi kontingjentin e saj ushtarak nga Iraku, mori një pozicion pro-Serb kundrejt Kosovës (dhe ndërkohë që ky artikull po printohet, Sllovakia mbetet një nga shtatë vendet e BE-së që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës). Në luftën e Osetisë së Jugut në gusht 2008, qeveria sllovaqe, e përfaqësuar nga Kryeministri, fajësoi qeverinë gjeorgjiane për provokimin e konfliktit dhe mbrojti versionin zyrtar rus të ngjarjeve.

Pavarësisht nga konsensusi qeveri-popullsi në lidhje me administratën Bush, qeveria sllovaqe nuk flet me një zë të vetëm: disa herë ka divergjenca të forta midis pozicioneve të ministrit të Punëve të Jashtme dhe të Shtabit të Qeverisë (Zyra e Kryeministrit), ku zyra e kryeministrit ngjat të përfaqësojë pozicionin zyrtar sllovak me vendosmëri.

Duke pasur detyrim ndaj riorientimit të politikës së jashtme sllovaqe nga "atlanticizmi" në një orientim pak a shumë të

shprehur qartë ndaj interesave ruse, rezultati i zgjedhjeve presidenciale të SHBA-së në 2008-n do të ketë domosdoshmërisht një impakt vendimtar në pozicionin ndërkombëtar (dhe brenda BE-së) të Sllovakisë.

Fitorja e kandidatit demokrat (duke qenë kundër angazhimeve të SHBA-së në Irak dhe duke premtuar “përmirësim” të marrëdhënieve me aleatët europianë) përfaqëson një prioritet të qartë të elitave të sotme zyrtare të Sllovakisë.

Sllovenia

Sabina Kajnc dhe Milan Brglez, Qendra për Relatat Ndërkombëtare, Lubjana

Në vjeshtë të 2004-ës, një qeveri e qendrës së djathtë mori pushtetin nga koalicioni i kaluar i qendrës (së majtë), i cili kishte qeverisur Slloveninë pothuajse pa ndërprerje që prej pavarësisë në 1991. Qeveria Janša, drejtuar nga Partia Demokratike e Sllovenisë, ishte ideologjikisht më afër me administratën Bush se qeveritë e kaluara. Kjo u vërtetua nga mbështetja sllovene e nënkuptuar që vazhdon dhe tani për politikën amerikane në Irak (Sllovenia kontribuoi me dy instruktorë të policisë në misionet civile të drejtuara nga NATO që lëvizën nga Jordania në Irak në fillimin e 2005-ës, Kryeministri Janša vizitoi gjithashtu Irakun në 2006-ën), si dhe nga administrimi i përgjithshëm i Sllovenisë në 2005-ën për Kryesinë e OSCE-së dhe nga Presidenca e saj së BE-së.

Kjo e fundit demonstron nga një informacion nga Ambasada Sllovene në Uashington në të cilën “urimet e administratës së SHBA-ës” rreth disa politikave të caktuara, sidomos mbi Kosovën, ishin shprehur qartësisht. Vështirësitë në marrëdhëniet bilaterale ndoqën rrjedhjen e kësaj komunikate në shtypin slloven (dhe serb), çka rezultoi në një procedurë të zgjatur të përcaktimit të Ambasadorit të ri të SHBA-ës në Slloveni, i cili arriti vetëm pak para samitit BE-SHB të mbajtur në Slloveni në qershor 2008.

Dy evenimentet madhore, Kryesia e OSCE-së dhe Presidenca e BE-së në 2008-ën, sidoqoftë, e vendosën Slloveninë midis pozicioneve divergjente të Ruisë dhe SHBA-ës. Kjo u bë evidente kryesisht nëpërmjet rolit të OSCE-së dhe reformës së saj, dhe përgjithësisht në lidhje me çështjet e sovranitetit dhe vetëvendosjes, veçanërisht në zonën post-sovjetike dhe në çështjen e pavarësisë së Kosovës.

Me Presidencën e BE-së në 2008-ën të Sllovenisë dhe zgjedhjet e përgjithshme të 21 shtatorit 2008 (që solli në fuqi një qeveri të re qendër-majtë), politika e jashtme, përtej çështjeve këmbëngulëse të fqinjësisë të Sllovenisë, veçanërisht me Kroacinë, mbeti në sfond. Qeveria që largohej ishte më se e kënaqur me presidencën e suksesshme të BE-së. Përgjithësisht, partitë politike sllovene nuk kanë nxjerrë qëndrime të dallueshme politikash të jashtme, të gjitha ato deklarojnë rëndësinë e relatave të mira me SHBA-në. Duket se nuk ka çështje urgjente. Çështje principesh, sidoqoftë, si kampi i të burgosurve në Guantanamo, i janë adresuar (vetëm) nga Presidenti slloven, Danilo Türk, në rastin e samitit BE-SHB të mbajtur në Slloveni në qershor 2008. Kjo tregon se në takimin bilateral që shoqëroi samitin BE-SHB, promovioni i marrëdhënieve ekonomike mbizotëroi. E ardhmja e Ballkanit Perëndimor, kryesisht pikëpamjet sllovene mbi Serbinë dhe Maqedoninë, gjithashtu u paraqitën dukshëm në agjendë. Sllovenia ka punuar fort në vitet e kaluara për të ngritur çështjen e Ballkanit Perëndimor brenda BE-së dhe mbështet fort një rol më të madh të BE-së në këtë zonë. Pas dështimit të komunikatës së lartpërmendur, nuk është i habitshëm fakti se çështja e Kosovës nuk u zgjodh specifikisht në bisedimet bilaterale.

Në princip, Sllovenia mbështet multilateralizmin dhe relata të forta dhe miqësore midis BE-së dhe SHBA-së. Kjo e vë vendin në një pozicion që tregon mbështetje për politikën që do të rrisin bashkëpunimin dhe që janë në linjë me politikën globale/të SHBA. Sllovenia do të tregojë më shumë kujdes për të ardhmen e Ballkanit Perëndimor dhe do të përpiqet të luajë rolin e ndërmjetësit në rajon. Mundësisht do të mbështesë marrëdhënie të ngushta midis Turqisë dhe BE-së.

Kur zgjedh midis një qasje bilaterale dhe një qasje të BE-së ndaj SHBA-së, Sllovenia merr një linjë pragmatike. Promovimi i marrëdhënieve ekonomike direkte dhe disa çështjeve bilaterale të caktuara (për shembull çështje të veçanta si e drejta e pronësisë së hebrenjve që daton para Luftës së Dytë Botërore) menaxhohen në nivel bilateral. Çështjet globale si energjia, klima dhe ekonomia botërore, duke përfshirë marrëdhëniet e tregtisë dhe ekonomisë midis BE-SHBA preferohen të shqyrtohen në nivel BE. Për sa i përket sigurisë globale dhe çështjeve politiko-sigurie, ekziston një preferencë e qartë për t'i diskutuar këto brenda kuadrit të NATO-s, edhe pse Sllovenia ka qenë mbështetëse e vazhdueshëm e një Sigurie dhe Politike të Mbrojtjes Europiane të fuqishme (me kusht që kjo nuk duplikon strukturat e NATO-s dhe bazohet mbi barazinë e të gjithë anëtarëve).

Spanja

Alicia Sorroza dhe David García Cantalapiedra,
Instituti Real Elcano, Madrid

Marrëdhënia midis Spanjës dhe SHBA-së gjatë viteve të presidencës së Bush-it është transformuar që prej 2001 deri në ditët e sotme. Midis 2001 dhe 2004, marrëdhëniet ishin tepër të mira, falë mbështetjes së pakushtëzuar të qeverisë së Aznar për luftën e SHBA-së kundër terrorizmit. Megjithatë, mbështetja e qeverisë spanjolle për pushtimin e Irakut ishte një çështje e diskutueshme gjatë zgjedhjeve të përgjithshme spanjolle të 2004-ës. Tërheqja e trupave spanjolle nga Iraku ishte një prioritet në programin elektoral të Partisë Socialiste spanjolle dhe me fitoren e zgjedhjeve nga kjo parti tërheqja e menjëhershme e trupave dhe deklarata e Kryeministrit Zapatero kundër politikës së SHBA-së në rajon çoi në ngrirjen e marrëdhënieve të niveleve më të larta qeverisëse. Sidoqoftë, Spanja dhe SHBA kanë ruajtur marrëdhënie të mira për sa i përket mbrojtjes, kundërterrorizmit, për bashkëpunim policor dhe gjyqësor dhe brenda NATO-s. Në fushën ekonomike gjendja është shume fluide. Spanja kapi pikun e investimeve

të huaja direkte në SHBA (8 milion euro), dhe kompanitë spanjolle kërkuar të mira nga SHBA me një vlerë prej 22 bilion euro (duke e bërë Spanjën investitorin e katërt më të madh pas Kanadasë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Holandës). Në të njëjtën kohë Spanja mori 8 bilion euro vitin e kaluar, 2% të investimeve të huaja direkte të SHBA-së. Veç kësaj, duhet theksuar se SHBA me shpejtësi po bëhet vendi me komunitetin spanjisht folës më të madh. Në lidhje me çështje të tjera si ndryshimet e klimës, ligji i ri ndërkombëtar dhe roli i organizatave ndërkombëtare, edhe pse ka një bashkëpunim në vazhdimësi, ka pasur dhe ndryshime midis Spanjës, BE-së dhe SHBA-së. Spanja i interpretoi mesazhet e të dy kandidatëve për president të SHBA-së si një tregues i një ripërtëritje të qasjeve shumëpalëshe të qëndrimit të SHBA-së në sfidat ndërkombëtare.

Gjatë fjalimit të tij të parë mbi objektivat e politikës së jashtme spanjolle për mandatin e dytë, Kryeministri Zapatero nënvizoi pritshmëritë e tij drejt një qasje të re të SHBA-së për një multilateralizëm efikas, sidomos në lidhje me luftën kundër ndryshimit klimaterik, si dhe në lidhje me ligjin e ri ndërkombëtar. Zapatero shpjegoi gjithashtu se qeveria spanjolle do të punojë për krijimin e një komisioni ndërkombëtar i krijuar për heqjen e dënimit me vdekje në të gjithë botën. Kjo do të arrihet nëpërmjet masave të veçanta: një moratorium universal për ekzekutimin e dënimit me vdekje deri më 2015, dhe një marrëveshje përfundimtare që asnjë vend të mos aplikojë dënimin me vdekje për minorenet ose për njerëzit me paafësi mendore. Spanja sheh përpara për të dhënë një kontribut aktiv në këto përpjekje të SHBA-së. Gjithashtu, ndërtimi i paqes ka nevojë për mjete të reja në mënyrë që të përballtet me konfliktet e reja dhe shkaqet e tyre. Në këtë kontekst, Spanja beson se “Aleanca e Civilizimeve” e propozuar nga Kryeministri Zapatero OKB-së në 2005 mund të jetë një instrument i rëndësishëm për të mposhtur dhunën.

Qeveria spanjolle aktualisht po përpiqet për të rinovuar dhe përmirësuar marrëdhëniet me SHBA-në. Duke pasur parasysh që Spanja do të mbajë Presidencën e BE-së gjatë semestrit të parë të 2010, marrëdhëniet transatlantike janë

përcaktuar nga Kryeministri Zapatero si një “detyrë parësore” për presidencën spanjolle të BE-së. Në këtë frymë, qeveria tani po përcakton një agjendë mbi marrëdhëniet me administratën e re të SHBA-së. Marrëdhënia SHBA-Spanjë është asimetrike. Qeveria spanjolle ka si qëllim të krijojë një balancë të re marrëdhëniesh sepse beson që përfitimet e prodhuara në nivel politiko-ushtarak janë të pamjaftueshme. Qeveria spanjolle preferon një qasje multilaterale, sidomos nëpërmjet BE-së. Megjithatë, në nivel bilateral Spanja ka qëllime të qarta për katër vitet e ardhshme: së pari, të konsolidojë investimet e huaja direkte në Spanjë; të rishikojë marrëveshjen për Mbrojtjen SHBA-Spanjë në lidhje me përdorimin e bazave spanjolle nga forcat amerikane dhe rolin e shërbimeve inteligjente në tokën spanjolle; të forcohet bashkëpunimi në fushën e arsimit, kërkimit dhe zhvillimit, dhe të përforcohet koordinimi në Amerikën Latine.

Qeveria Spanjolle preferon të përdorë kuadrin e BE-së për të përballur sfidat ndërkombëtare si programin nuklear Iranian, konfliktin Izraelo-Palestinez, gjendjen në Liban, dhe kriza në Kaukaz. Për sa i përket fuqive rajonale si BRIC, BE dhe SHBA, ato duhet të bashkëpunojnë për të lehtësuar integrimin e tyre në sistemin ndërkombëtar dhe impenjimin e këtyre organizatave ndërkombëtare dhe ligjit. Çështje të tjera të rëndësishme si reforma e OKB-së, Kyoto plus-i, lufta kundër varfërisë etj. do të jenë pjesë e agjendës SHBA-BE.

Suedi

Anna Södersten, Instituti Suedez për Studime të Politikave Europiane, Stokholm

Marrëdhëniet suedezo-amerikane gjatë periudhës së BUSH-it ishin përgjithësisht të mira dhe ka pasur një konsensus të gjerë për shumë çështje. Megjithatë, lufta në Irak i tendosi pak këto marrëdhënie. Pozicioni Suedez ka qenë që pushtimi përbënte një thyerje të qartë të së drejtës ndërkombëtare. Opinioni publik në Suedi ka qenë gjithashtu kundër luftës. Fusha të tjera mosmarrëveshjeje ishin politikat

e burgimit në gjirin e Guantamos, refuzimi i SHBA-së të nënshkruajë Protokollin e Kyoto-s dhe dënimi me vdekje.

Gjatë administratës së dytë Bush, qasjeve multilaterale iu kushtua më shumë vëmendje. Në Suedi, u pa si një ndryshim i shumë mirëpritur. Pas zgjedhjeve suedeze të 2006-ës, përpjekje u bënë për të forcuar dialogun transatlantik. Vizitat e shpeshta të anëtarëve të qeverisë suedeze në Uashington ashtu si dhe ndërtimi i ndërtesës së re të ambasadës suedeze në kryeqytetin e SHBA-së mund të shihet si një hap drejt një marrëdhënie të re.

Bashkëpunimi mbi çështjet e klimës dhe energjisë zë një vend gjithmonë e më në rritje në politikat suedeze. Gjatë presidencës suedeze në 2009, lufta kundër ndryshimeve klimaterike do të jetë një nga çështjet më madhore. Si rrjedhojë, angazhimi i SHBA-së për këto çështje do të jetë i një rëndësie të veçantë për të ardhmen e marrëdhënieve transatlantike. Ka pritshmëri që SHBA-ja do të ketë një pozicion më konstruktiv në Kuadrin e Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi ndryshimin klimaterik (UNFCCC), në Kopenhagën në dhjetor 2009.

Bashkëpunimi ekonomik dhe tregtar transatlantik u forcua gjatë presidencës Gjermane të BE-së në 2007. Kjo i detyrohet gjerësisht themelimit të Këshillit Ekonomik Transatlantik që është i një rëndësie të veçantë për Suedinë. Edhe pse shkëmbimet tregtare midis Suedisë dhe SHBA-së kanë rënë dy vitet e fundit, SHBA është akoma një partner i rëndësishëm për Suedinë. Kriza në Gjeorgji shtroi pyetjen si t'i përgjigjemi politikës së jashtme ruse. Kritika suedeze ndaj Ruisë ishte shumë e qartë dhe ministri i Jashtëm suedez Carl Bildt nënvizoi se rruga e ndërmarrë nga Rusia çon në konfrontim me komunitetin ndërkombëtar në përgjithësi. Sipas pozicionit suedez, është e rëndësishme të vazhdojë dialogu me Rusinë, edhe pse përmbajtja e dialogut mund të ndryshojë në të ardhmen. SHBA pritet të veprojë në bashkëpunim me BE-në në lidhje me këtë çështje.

Zhvillimi i procesit të paqes në konfliktin izraelo-palestinez mund të jetë një çështje tjetër e rëndësishme në 2009. Suedia po inkurajon një zgjidhje dypalëshe me një shtet palestinez të pavarur, demokratik dhe të suksesshëm, që jeton krah për krah në paqe dhe siguri me Izraelin dhe fqinjët e tij. Kjo supozon

që liria e lëvizjes dhe aksesit të jetë përmirësuar në mënyrë të ndjeshme në West Bank dhe Gaza. Një marrëveshje paqeje kërkon përpjekje të konsiderueshme nga SHBA dhe BE. Suedia mund të ketë një rol të rëndësishëm në procesin e ndërtimit të shtetit palestinez në të ardhmen dhe është tanimë një prej donatorëve bilateral më të mëdhenj të Gazës dhe West Bank-ut. Gjithashtu, Suedia pret administratën e SHBA-së të përpiqet më tepër për të inkurajuar procesin e rindërtimit dhe pajtimit në Irak. Priten më shumë përpjekje në mbrojtje të më shumë se 4 milion refugjatëve irakianë. Për t'i parë gjerat më qartë, qyteti i vogël suedez Sodertalje ka pritur më shumë refugjatë irakianë sesa SHBA dhe Kanada së bashku. Prandaj Suedia është në pritje dhe po inkurajon SHBA-në të marrë më shumë përgjegjësi për refugjatët irakianë.

Së fundmi, politika e jashtme ka luajtur deri tani një rol më pak të rëndësishëm në zgjedhjet amerikane dhe prandaj është e vështirë të përcaktohet çfarë kursi do të marrë administrata tjetër amerikane në shumë çështje. Pritshmëritë që administrata e re do të mbështesë një qasje multilaterale janë të larta, por nuk duhen ekzagjeruar.

Mbretëria e Bashkuar **Tomas Valasek, Qendra për Reforma Europiane,** **Londër**

Agjenda SHBA-Mbretëri e Bashkuar nën presidencën Bush është dominuar nga lufta në Irak, diskutimet mbi ndryshimet klimaterike, dhe - së fundmi - kriza financiare globale. Uashingtoni dhe Londra bashkëpunuan në Irak, edhe pse patën mosmarrëveshje mbi udhëheqjen e operacioneve. Qeveria britanike pagoi një çmim të lartë politik të brendshëm për mbështetjen aktive të SHBA-së në Irak. Ndryshimi klimaterik ka qenë një çështje që i ka ndarë. Përpjekjet e Londrës për të marrë mbështetjen e SHBA-së për të kontrolluar emisionet globale dështoi, dhe nuk është e sigurt që SHBA-ja do të firmosë një kuadër post-Kyoto. Për sa i përket krizës financiare globale, Gordon Brown hodhi fajin për problemet e bankave

Britanike mbi ngjarjet Amerikane - një pozicion kurioz ky nëse shihen niveli i lartë stimulues në ekonominë Britanike.

Në pritje të 2009-ës, çështja kryesore në agjendën SHBA-Mbretëri e Bashkuar do të jetë sipas kësaj renditje rëndësie:

- të ndalet kriza financiare, të hartohet një kuadër më i mirë rregullator i mbas krizës dhe të mbrojtë rritjen ekonomike;
- të gjendet një strategji më efektive për operacionet në Afganistan;

- të sigurojë shkurtime detyruese mbi emisionet e karbonit;
- të përfundojë përfshirja ushtarake britanike në Irak.

Mbretëria e Bashkuar do të kërkojë të minimizojë përkeqësimin e krizës në ekonominë dhe kompanitë britanike. Kjo mund të jetë një çështje e diskutueshme në sektorin financiar, ku administrata duhet të ndajnë të mirat e institucioneve të falimentuara tanimë. Edhe pse të dyja si SHBA dhe Mbretëria e Bashkuar mund të përballen përsëri me reagime të ashpra të brendshme kundër sektorëve të tyre financiare, ata janë akoma në gjendje të argumentojnë kundër një shtrëngimi të tepërt në atë që pritet të jetë një debat i diskutueshëm në kuadrin rregullator post- konfliktual. Mbretëria e Bashkuar mund të pritet të mbështesë lëvizje të tjera për liberalizimin e tregut transatlantik.

Afganistani do të ketë një vend të gjerë në agjendën SHBA-Mbretëri të Bashkuar - kostoja e këtyre operacioneve po vë themelet e mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar nën stres, dhe misioni duket të jetë në telashe të mëdha. Të dyja kryeqytetet mund të shtyjnë për një rritje të numrit të trupave (të ngjashëm me “operacionin” në Irak). Por duke qenë afër një shpërndarje të plotë të trupave të tyre, Londra dhe Uashingtoni me shumë gjasa do të bashkojnë trupat me Ottawa dhe Hagën (kontribuues të tjerë të konsiderueshëm në operacionet në Irak) duke shtyrë aleatë të tjerë europianë të përdorin më shumë trupa për operacione të rrezikshme.

Edhe pse ka rënë kriza financiare, për momentin çështjet ambientale, nevoja për të siguruar pjesëmarrjen e SHBA-së në një marrëveshje globale për kontrollin e emisioneve do të mbetet e lartë në agjendën e Mbretërisë së Bashkuar. Ndjenja e përgjithshme në Londër është që konferenca e Kopenhagenit

do të vijë shumë shpejt për administratën e re Amerikane për të rënë dakord për shkurtime të detyruara - por Londra do të dojë të kërkojë një zgjidhje për të shpëtuar fytyrën për Uashingtonin, i cili nuk mund të izolojë SHBA-në nëse nuk është gati për të nënshkruar në Kopenhagen, por që do të mbajë akoma të hapur perspektivën e një administrate të re që do të bjerë dakord më vonë për shkurtime.

Iraku është një çështje gjithmonë e në rënie për sa i përket rëndësisë në marrëdhëniet anglo-amerikane. Kontingjenti anglez është ulur në 3000 trupa që nga piku i kohës së luftës i 20000 trupave dhe administrata e Mbretërisë së Bashkuar dëshiron të largohet sa më shpejt. Në vazhdim të afatit të fundit të vendosur nga qeveria irakene për tërheqjen e trupave amerikane më 2001-ën, Uashingtoni po shikon të tërheqë trupat e tij në dy vitet në vazhdim. Të dy kryeqytetet do të punojnë së bashku për të minimizuar impaktin e tërheqjes mbi gjendjen e sigurisë në Irak, dhe të lënë pas pajisje, njohuri si dhe mekanizma trajnues për ushtrinë irakiane. Në përgjithësi Londra preferon të zgjidhë çështjet në mënyrë bilaterale me Uashingtonin sesa nëpërmjet BE-së, por strategjia ndryshon nga çështja në çështje. Është e qartë se Iraku është një çështje bilaterale në të cilën BE-ja nuk luan asnjë rol. Në mënyrë të ngjashme, Afganistani është në radhë të parë një çështje e NATO-s edhe pavarësisht nga ndihma financiare e BE-së dhe një kontingjenti të vogël policor.

Kriza financiare dhe pasojat e saj do të kërkojnë një përfshirje më të madhe të BE-së, por këtu vendet anëtare ka shumë gjasa që të ndahen me Londrën në mbrojtje të një qasje rregullatore të lehtë, ndërkohë që Franca dhe Gjermania dhe të tjerë do të shtyjnë për një kontroll më të afërt për institucionet financiare. BE-ja do ta ketë të vështirë të flasë me një zë dhe prandaj ka një pozicion të unifikuar me SHBA-në. Ndryshimi i klimës është një çështje ku Mbretëria e Bashkuar do të përdorë, me shumë gjasa, do të përdorë zyrat e BE-së për të dialoguar me Uashingtonin. BE-ja kolektivisht mbështet prerjen e emisioneve detyruese dhe si e tillë ofron një platformë efektive për të mëshuar te SHBA-ja të bëjë të njëjtën gjë.

Bashkimi European

Piotr Maciej Kaczyński and Sebastian Kurpas,
Qendra për Studime të Politikave Europiane, Bruksel

Gjatë presidencës së Bushit (2001-2009), marrëdhëniet BE-SHBA përshkruan faza të ndryshme. Periudha e parë u shënjua duke theksuar bashkimin e evropianeve dhe amerikanëve pas sulmeve të 9 shtatorit. Ky bashkim përfundoi me një fazë të dytë e shënuar nga ndërhyrja në Irak, kur administrata Bush përdori në mënyrë të qëllimshme ndarjet midis qeverive evropiane (duke përdorur dhe nocionin e famshëm “Europa e vjetër” drejt “Europës së re”) për të ndërtuar “koalicione të vullnetshme”. Për shkak të ndarjeve të thella midis vendeve anëtare, BE-ja si e tillë nuk luajti një rol të rëndësishëm në këtë çështje edhe pse opinioni publik në pothuaj të gjitha vendet anëtare (BE-15) ishte shumë kritike ndaj administratës Bush.

Kriza në Irak koncidoi me zgjerimin bing band të BE-së në 2004 dhe negociatat për traktatin e reformave të BE-së. Asnjëra nuk u ndikua nga ndarjet mbi luftën në Irak. Interesant është fakti që ndarjet mbi Irakun nuk e pengoi BE-në për të rënë dakord për Strategjinë e saj të Sigurisë (“Një Europë e sigurt në një botë më të mirë”), e cila ishte në kontrast shumë të madh me fokusin e fuqishëm ushtarak të qasjes së administratës Bush mbi sigurinë. Dokumenti - i prezantuar në dhjetor 2003 nga Javier Solana dhe e aprovuar nga Këshilli European - theksoi nocionin e një “multilateralizmi efektiv” dhe theksoi një qasje gjithëpërfshirëse përkundrejt sulmeve terroriste duke u ndërtuar mbi “një përzierje të shërbimeve informative, policisë, gjyqësorit, ushtrisë dhe mjeteve të tjera”. Ndryshe nga administrata amerikane ajo promovoi “përfshirje parandaluese” sesa një “zëvendësim” ushtarak. Dokumenti gjithsesi bëri thirrje për një “kulturë strategjike që forcon shpejt, herët dhe kur është e nevojshme një ndërhyrje të fuqishme” dhe insistoi shumë mbi rëndësinë e bashkëpunimit BE-SHBA, duke e quajtur marrëdhënien transatlantike “të pazëvendësueshme”. Megjithatë, kjo marrëdhënie duhet bazuar në mënyrë ideale në një raport të barabartë të të dy

partnerëve (një marrëdhënie efektive dhe e balancuar me SHBA-në), sepse duke vepruar së bashku të dy mund të jenë “një forcë e fuqishme për të bërë mirë në botë”.

Periodha e luftës në Irak u shënjua edhe nga mosmarrëveshje të tjera të rëndësishme midis BE-SHBA në nivel multilateral vs. një qasje unilaterale, mbi njohjen e Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve dhe Protokollin e Kiotos. Faza e tretë e marrëdhënieve BE-SHBA nën presidencën Bush mund të përshkruhet si një periudhë e rivendosjes së marrëdhënieve teknike/burokratike të të dy partnerëve, sidomos mbi çështjet ekonomike dhe të tregtisë. Në kuadrin e Organizatës Botërore të Tregtisë si negociatat e Doha-s, europianët dhe amerikanët shpesh paraqitën pozicione të ngjashme si ato të vendeve në zhvillim. Gjithashtu kishte disa marrëveshje bilaterale mbi liberalizimin e lëvizjeve ajrore dhe për lehtësimin e tregtisë BE-SHBA, duke përfshirë edhe një “Marrëveshje Kuadër”, mbi integrimin ekonomik transatlantik. Kjo marrëveshje krijoi Këshillin Ekonomik Transatlantik si një organ politik për të kontrolluar dhe përshpejtuar bashkëpunimin qeveri-qeveri me qëllim për të avancuar integrimin ekonomik midis BE-së dhe SHBA-së.

Çështja më e rëndësishme dhe urgjente që aktorët evropianë duan të përballen janë:

1. Ndryshimi i debatit mbi klimën dhe negociatat Bali-Poznan-Kopenhagën
2. Siguria energjetike (mbi të cilën në SHBA diskutohet nën termin “pavarësi energjetike”, sidomos me keqësimin e marrëdhënieve SHBA-Rusi)
3. Stabilitet në zonën post-Sovjetike, që do të përfshijë një qasje trilaterale (BE, SHBA dhe Rusi) për zgjidhjen e konflikteve të ngrira (Transnistria, Nagorno-Karabah), dhe çështja Gjeorgjiane (statusi final i Abakazisë, Osetisë së Jugut) dhe probleme të tjera potenciale (si është Krimea)
4. Gjendja në Lindjen e Mesme më gjerë, duke përfshirë dhe konfliktin izraelo-palestinez, gjendja në Irak dhe Afganistan dhe përhapja e nuklearit, sidomos në rastin e Iranit
5. Kriza e fundit financiare që përbën një sfidë e madhe e marrëdhënieve ekonomike globale

Vendet anëtare të BE-së presin fillimisht që SHBA të mos jetë përçarëse ndaj vendeve anëtare të BE-së dhe të marrë seriozisht BE-në si një partner dhe aleat. Shpresohet që administrata e re do të jetë më pozitive rreth multilateralizmit në përgjithësi dhe bashkëpunimit me BE në veçanti. Një sjellje ndryshe nga Uashingtoni do të ndihmonte për të kapërcyer ndryshimet ekzistente mbi zgjidhje në Irak dhe Afganistan ose qasjen ndaj ligjit ndërkombëtar dhe Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve. Ka mosmarrëveshje dhe ndaj çështjeve mbi tregtinë, që kanë nevojë për diskutim të mëtejshëm. Ka shpresa midis vendim-marrësve evropianë që - pavarësisht vështirësive ekonomike në SHBA - administrata e re do të vazhdojë të impenjohet në tregtinë e lirë.

Marrëdhëniet transatlantike pësojnë një shtysë nga Samitet bilaterale BE-SHBA dhe kontaktet e përditshme dhe negociatat në fusha të ndryshme. Gjatë samitit të 30 prillit 2007 SHBA-BE, Presidenti i Komisionit Barroso, Kancelarja Gjermane Merkel dhe Presidenti amerikan Bush nënshkruan “Strukturën për të avancuar Integrimin Ekonomik Transatlantik midis SHBA dhe BE”. Elementë kyç të kësaj strukture ishin adoptimi i një programi pune mbi bashkëpunimin dhe themelimin e Këshillit Ekonomik Transatlantik për të kontrolluar udhëhequr dhe përshpejtuar implementimin e këtij programi pune. Ky instrument i ri duhet të përdoret në përputhje me rrethanat.

Konkluzione dhe interpretim i të dhënave

Ky raport ofron një sondazh të shkurtër të pritshmërive që kanë europianët ndaj administratës së re të SHBA-së. Ai bazohet në vlerësime nga analistë think-tank-esh të 15 vendeve anëtare të BE-së dhe një vlerësim nga analistë nga Brukseli, kryeqyteti i BE-së. Edhe pse disa ndryshime të dukshme ekzistojnë midis evropianëve, baza i këtij sondazhi është një dëshirë e fortë europiane për një rol të ri lidhës të besueshëm të SHBA-së në çështjet ndërkombëtare. Dy shqetësime mbeten në zemër të kësaj dëshire: së pari, imazhi

i SHBA-ve jashtë vendit është dëmtuar shumë në tetë vitet e fundit, dhe pavarësisht ndryshimeve të politikave, evropianët besojnë se ky ka qenë një zhvillim shumë i keq. Së dyti, pothuajse të gjitha kontributet në këtë artikull kërkojnë një qasje multilaterale të SHBA-së në politikën ndërkombëtare. Nëse evropianët nuk ishin të interesuar në lidhshimin amerikan, ata nuk do të kërkonin një SHBA më bashkëpunuese. Për Presidentin e ri Amerikan, ky fakt paraqet një mundësi shumë të madhe, pavarësisht rreziqeve që ekzistojnë për shkak të pritshmërive të rritura. Evropianët nuk kërkojnë marrëveshje në të gjitha çështjet (që edhe vet e kanë të vështirë të gjejnë konsensus midis tyre), por ata besojnë shumë se do të jenë më keq nëse SHBA-ja dështon në konvertimin e fuqisë së saj në një lidhshim të besueshëm. Kjo është në përputhje me gjetjet e fundit të një poll-i vjetor mbi Tendencat Transatlantike, të udhëhequr nga German Marshall Fund.

Nuk është aspak e çuditshme që të gjitha çështjet, në kontributet e vendeve të ndryshme, kanë të bëjnë me ndryshimin e klimës, energjinë, ligjin ndërkombëtar, (sidomos Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve) dhe tregtinë botërore. Të paktën për sa i përket ndryshimit klimatik evropianët do të zhgënjehen nëse as presidenti i ri, as Kongresi Amerikan nuk kanë më oreks për të nënshkruar çdo lloj marrëveshje që i lë jashtë ekuacionit. Gjithashtu, pjesëmarrja në Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve me siguri do të realizohet në mos me ngurrim njësoj ose më të fuqishëm.

Sidoqoftë çështja me e rëndësishme është Rusia. Politika e sigurisë është me siguri në agjendën evropiane. Këtu një çarje midis vendeve evropiane bëhet gjithmonë e më e dukshme. Shumë vende të Europës Lindore, sidomos që prej krizës së Gjeorgjisë në verën 2008 e perceptojnë Rusinë si një kërcënim real dhe i pashmangshëm për sigurinë e tyre. Kjo gjë nuk ndahet nga të gjithë vendet anëtare perëndimore të BE-së. Për të rritur sigurinë e tyre, evropianët lindorë mbështeten sidomos mbi SHBA-në drejtpërsëdrejti, me BE-në (dhe NATO-n) që luan një rol sekondar (në mos edhe më të pakët). Në pjesën më të madhe të vendeve lindore anëtare të BE-së

kjo çon në besueshmëri të prishura kur qeveritë e tyre e gjejnë veten në një situatë ku ata janë të detyruar të zgjedhin midis besnikërisë pan-europiane dhe lidhjeve të ngushta me SHBA-në. Ky vullnet i ndarë për të ardhmen e parashikueshme mbetet një pikë paracaktuese në punët e brendshme të BE-së, në linja me ndërtesën e shpesh përmendur dhe cituar, por dhe urryer “Europa e vjetër drejt Europës së re”.

Megjithatë, për arsye afati, pjesa më e madhe e kontributeve nuk ishin në gjendje të përfshinin trazirat e fundit në tregjet financiare ndërkombëtare dhe frika e vazhdueshme për recesionin global, shqetësimet “socio-ekonomike” ngrihen shpesh në këto faqe. Nuk ka asnjë iluzion në Europë mbi një shpërbërje të ekonomive evropiane dhe amerikane. Meqë pritshmëritë për një lidhshmëri të fortë amerikan ishin të larta edhe para krizës financiare, kjo fushë politikash ndoshta ofron mundësinë më të mirë e të menjëhershme për Europën dhe SHBA-në për të punuar bashkë. Me ekonomitë e tyre të kombinuara, në terma globalë, duke u bërë relativisht më të dobët, bashkëpunimi duket të jetë një imperativ në çdo ngjarje, nëse Perëndimi do të mbajë stilin e jetës dhe influencën e mëparshme.

Për të përmbledhur, pritshmëritë evropiane ndaj Presidentit të ri Amerikan dhe administratës së re amerikane janë të larta. Kjo është një gjetje e rëndësishme, sepse pritshmëritë psikologjike përbëjnë bazat për një marrëdhënie konstruktive. E justifikuar apo jo, në vitet e fundit, pritshmëritë e marrëdhënieve transatlantike kanë qenë të ulëta. Kjo ka ndryshuar, me pasoja të paevitueshme mbi politikën që rrjedhin prej saj. Edhe duke konsideruar rreziqet e zhgënjimeve të pashmangshme kjo atmosferë e ndryshuar përbën një mundësi thelbësore që mund - dhe duhet- të rishihet nga liderët evropianë dhe amerikanë të politikës dhe ekonomisë.

SANDRA DIAZ FERNANDEZ

KOHA PËR TË RIVLERËSUAR
ARKITEKTURËN E SIGURISË EUROPIANE?
TREKËNDËSHI I SIGURISË MIDIS
NATO-BE-RUSI

Abstrakt

NATO do të celebrojë 60-vjetorin e krijimit të tij në prill gjatë një Samiti shumë simbolik të mbajtur nga Franca dhe Gjermania. Ndryshe nga samitet e tjera në 1999 dhe 2004, në ditët e sotme aleatët duhet të përballen me një Rusi të transformuar dhe kundërshtarë, përveçse me një mjedis sigurie me zhvillim të shpejtë. Pak muaj më parë Presidenti Rus Dimitri Medvedev hodhi një propozim për një traktat të ri sigurie. Propozimi i ka shtuar një element të ri katalogut të zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve duke shkaktuar përkeqësimin e marrëdhënieve me Uashingtonin, midis të cilit mbrojtja raketore vazhdon të jetë një nga ndarëset kryesore.

Ky studim analizon presionin Rus në çështjet e sigurisë dhe mënyrën se si BE dhe NATO i kanë trajtuar. Është argumentuar që tensionet mbi mbrojtjen raketore janë të lidhura ngushtë me zgjerimin e NATO-s me Ukrainën dhe Gjeorgjinë dhe me kontrollin e armëve (Traktati Strategjik për Reduktimin e Armëve dhe Traktati mbi Forcat e Armatosura Konvencionale në Europë), dhe që në këto çështje ndërhyhet pak në nivelin shumëpalësh. Përveç lëvizjeve pozitive të ndërmarra për Rusinë nga administrata Obama, është e vështirë për të parë çdo përjasje duke patur parasysh mospërputhjen ekzistuese mbi pikëpamjet në legjitimitetin e NATO-s. Në këtë kontekst, roli i BE-së në përmirësimin e dialogut të sigurisë me Rusinë është thelbësor.

Hyrje

“Europa, Amerika e Veriut dhe ne në Rusi kemi nevojë për një traktat të ri sigurie. Ky është propozimi ynë” (Lavrov, 2009). Këto fjalë nga Sergei Lavrov, ministri i Jashtëm Rus, janë një sinjal i dëshirës së rinovuar ruse për të rivendosur marrëdhëniet e sigurisë dhe institucionet në Europë. Kjo ide u dha nga Presidenti Dimitri Medvedev Qershorin e kaluar dhe është përsëritëse në konfliktin serioz dhe polarizues të lidhur me sigurinë mbi projektin amerikan për të zgjeruar skemën e mbrojtjes raketore në Europë. Për më tepër, lufta Ruso-Gjeorgjiane ka krijuar një mjedis më të vështirë në marrëdhëniet me Kremlinin. Meqenëse marrëdhëniet midis Bashkimit Europian (BE) dhe Rusisë janë vendosur në mbikëqyrje, ndryshime të rëndësishme kanë ndodhur. Mbas një “periudhe refleksioni” nga Shtatori në tetor 2008, agjenda për bashkëpunim është fokusuar në interesa thelbësore (tregtia dhe energjia). Paralelisht, një agjendë e re mbi sigurinë po merr formë. Përveç një dialogu bashkëpunues, që prodhoi rezultate konkrete në çështjet ekonomike dhe tregti, rezultatet politike nuk kanë qenë të kënaqshme për të dyja palët. Kjo është veçanërisht e dukshme në “hapësirën e përbashkët të sigurimit të jashtëm”¹, ose më gjerë në vështirësitë e arritjes së një partneriteti të rinovuar.

BE dhe Moska shprehin pikëpamje të ndryshme në çështjet e sigurisë, duke filluar nga e ashtuquajtura: fqinjësia e përbashkët” deri në zgjerimin e NATO-s. Ekziston nevoja për të vlerësuar gjendjen aktuale në dialogun europian për siguri dhe mundësitë për të kthyer dialogun në një mjet zgjidhës të problemit duke marrë parasysh rolin influencues të trekëndëshit kryesor që thekson marrëdhëniet BE-Rusi, SHBA-

¹ Partneriteti dhe marrëveshja e bashkëpunimit e 1997-ës është baza ligjore për marrëdhëniet BE-Rusi. Një kornizë e re bashkëpunimi u vendos në Samitin e Shën Peterburgut në 2003. Që nga ajo kohë, Brukseli dhe Moska kanë bashkëpunuar në katër zona (të ashtuquajturat “hapësira të përbashkëta”): një hapësirë ekonomike të përbashkët; një hapësirë të përbashkët për liri, siguri dhe drejtësi; një hapësirë të përbashkët për bashkëpunim në fushën e sigurisë së jashtme; dhe një hapësirë e përbashkët mbi kërkimin, edukimin dhe kulturën.

Rusi, dhe NATO-Rusi. Por duke patur parasysh distancën politike të rinovuar, për më tepër të rënduar nga kriza gjeorgjiane, cilat janë perspektivat për të arritur këtë lloj partneriteti?

Konteksti politik është jetësor për të kuptuar vështirësitë aktuale dhe lidhjet midis problemeve të përbashkëta të sigurisë në Europë. Midis çështjeve më të dukshme janë iniciativa unilaterale nga SHBA-ja për të instaluar një sistem mbrojtës raketor në Republikën Çeke dhe Poloni, pavarësia e Kosovës dhe aspiratat e Ukrainës dhe Gjeorgjisë për të hyrë në BE. Dhjetë vjet më parë, përveç kundërshtimit Rus, NATO ishte në gjendje të zgjerohej në vendet e ish-zonës Sovjetike. Samiti i 60-të i përvjetorit të aleancës do të zhvillohet në një mjedis sigurie të transformuar dhe do t'i japë nisjen refleksionit të doktrinës së NATO-s. Konferenca e hershme e Mynihut e mbajtur në Shkurt 2009 lançoi pozicionin e ri të administratës së SHBA-së mbi Rusinë dhe sigurinë. Disa muaj më parë, politika e jashtme e Medvedevit po merrte jetë. Rrethanat e pranishme janë rezultat i risive dhe ndryshimit, dhe rrjedhimisht është e nevojshme t'u adresohen presionet e reja ruse mbi sigurinë europiane nën dritën e debatit anti-raketor dhe lidhjeve kryesore me shqetësime të tjera të sigurisë që tregojnë marrëdhëniet e vështira me Kremlinin.

Mbrojtja raketore: Maja e ajsbergut

Çështja anti-raketore është më shumë një çështje bilaterale sesa një çështje multilaterale për shkak të mangësive në arkitekturën ekzistuese të sigurisë. Samiti i Bukureshtit në prill 2008 tregoi mbështetjen e shteteve anëtare të BE-së për një mbrojtje anti-raketore². Ekziston një shqetësim midis aleatëve mbi krijimin e një sistemi të tillë pasi mund të

² Shiko deklaratën e Samitit të Bukureshtit nga kryetarët e shtetit dhe qeverisë që morën pjesë në Këshillin e Atlantikut të Veriut (Bukuresht, 3 prill 2008), Deklaratë për shtyp (2008) 049, NATO, Bruksel, 3 prill 2008 (marrë nga <http://www.nato.int/docu/pr/2008/p08-049e.html>).

perceptohet si një drejtim kundër Ruisë³. Diskutimi mbi implementimin e një mbrojtjeje në Europë ka provokuar një debat transatlantik të thelluar kryesisht që nga 2007-a, edhe pse është një çështje e vjetër në një kontekst të ri. Është pjesë e bisedimeve që filluan gjatë Luftës së Ftohtë për kontrollin dhe reduktimin e armëve. Më vonë, Uashingtoni shprehu qëllimin e tij për t'u tërhequr nga Traktati i Raketës Anti-Balistike (ABM) i 1972-it, por hasi në kundërshtimin e Ruisë. Argument kryesor i SHBA-së për mbrojtjen anti-raketore bazohet mbi perceptimin e kërcënimeve në nivel global dhe mbi nevojën për të zhvilluar sisteme mbrojtëse efikase. Pas 11 shtatorit, marrëdhënia bilaterale Ruso-Amerikane u përmirësua dhe në dhjetor 2002, SHBA-ja unilateralisht u tërhoq nga Traktati i Raketës Anti-Balistike. Në projektin amerikan për mbrojtjet raketore, vendet europiane, do të bëhen vendi i tretë në sistemin e raketave amerikane, duke komplementuar dy të tjerat në Alaskë dhe Kaliforni. Për aq kohë sa BE është e përfshirë, Brukseli nuk është një forum i përshtatshëm për të diskutuar çështjen meqenëse BE-ja ka mungesë kompetence në çështje. Për më tepër, çështjet që janë nën përgjegjësinë e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët (CFSP) dhe Politikës Europiane të Sigurisë dhe mbrojtjes (ESDP) aprovohen me votë unanime, e cila lejon çdo shtet anëtar të imponojë pikëpamjet e veta kombëtare dhe të bllokojë vendime.

Ideja që Rusia duhet të marrë pjesë në sistemin e mbrojtjes raketore dhe të kontribuojë në një strukturë pan-Europiane përdoret shpesh nga mbrojtësit e sistemit të propozimit

³ Marrë nga një burim në selinë qendrore të NATO-s, Bruksel, shkurt 2009. Fjalori i Joe Biden në Shkurt në Mynih përmendi nevojën për të shtypur një buton "ri-ndezjeje" për të rivendosur marrëdhëniet me Ruisë (shiko Blitz, 2009). Sipas *Le Monde*, 7 shkurt 2009 ("A Munich, Joe Biden Donne le ton de la nouvelle diplomatie américaine."), Biden ka marrë pozicionin e kujdesshëm tashmë të zhvilluar nga Obama, në gazetën që citon Biden si vazhdon: "Nous allons continuer a developper nos defenses antimissiles (...), a condition que la technologie fonctionne et que le cout en vaille la peine. (...) Nous le ferons en concertation avec nos allies de l'OTAN et avec la Russie."

amerikan. Shpesh është shoqëruar me idenë që Rusia duhet të anëtarësohet në NATO, kjo prezantohet si një kurë për të gjitha problemet e sigurisë në Europë. Në plan të historisë së marrëdhënieve midis Ruisë dhe anëtarëve të NATO-s, është mjaft e vështirë që aleanca së bashku me adoptimet e 1990-ës mund të shihet si më tërheqëse për Rusinë se më para, duke konsideruar rimëkëmbjen globale të Ruisë. Nga ana tjetër, Moska po vendos në pikëpyetje trashëgiminë e 1990-ës dhe është duke kërkuar një rol të përshtatshëm në arkitekturën e sigurimit europian. Ka dy diskutime kundërshtuese dhe kontradiktore. Nga njëra anë Rusia kërkon të marrë pjesë në një diskutim thelbësor mbi rëndësinë e NATO-s, në mbështetje të besimit sipas të cilit aleanca po krijon një mur Berliri të ri (Putin, 2008). Nga ana tjetër, Perëndimi e shikon NATO-n si një organizatë plotësisht të re, e cila i është përshatur situatës së re gjeopolitike dhe nuk është më një kërcënim për Rusinë. Debati mbi mbrojtjen raketore errëson një diskutim tjetër (të shmangur) mbi faktin që NATO mund të përfaqësojë një bllok kundër vendeve të tjera. Si përfundim, dy pozicionet tregojnë që Moskës nuk i është dhënë një rol i kënaqshëm në organizatë, i cili perceptohet si një kërcënim ose të paktën një avantazh që mund të përdoret kundër interesave të organizatës.

Pyetjet kryesore të ngritura në debat për nevojshmërinë e një sistemi raketor mbrojtës në Europë ndahen në dy kategori. Argumentet politike dhe teknike përdoren për të mbrojtur ose sulmuar projektin⁴. Nga një pikëpamje teknike, mundësia dhe efektiviteti i një mjeti të tillë vihet në dyshim, ashtu si vihet në dyshim vërtetimi i ekzistencës së një kërcënimi të krijuar nga një bombë bërthamore të mundshme iraniane. Nga një pikëpamje politike, rreziku i proliferimit dhe i një gare armësh janë diskutuar, sikur të ishin qëllimi kryesor për zgjerimin e sistemit të mbrojtjes Amerikane “Ground-based Midcourse Defense” (GMD) në Europë. Ka ose jo Europa nevojë për një sistem të tillë, kundër kujt mund të drejtohet dhe pasojat e

⁴ Shiko për shembull Slocombe et al. (2007), Webb (2008), Muller (2008) and Krause (2007).

proliferimit të armëve janë pyetje kritike që duhet të merren në konsideratë. Deri më sot, diskutime bilaterale janë preferuar ndaj atyre multilaterale si një mënyrë për t'i adresuar ato.

Diskutimet midis Uashingtonit dhe Moskës janë një mjet kryesor diplomatik për të mbikaluar kundërshtimin rus. Në tranzicionin nga Presidenti Vladimir Putin te pasardhësi i tij Dimitri Medvedev, ka pasur shqetësime të vazhdueshme për sa i përket pozicionit të mbajtur. Që nga maji 2008, presidenti i ri rus ka ngritur një mbrojtje diplomatike kundër mbrojtjes raketore në Europë. Në fund të pranverës 2008, këto përpjekje u plotësuan nga Putin në rolin e tij si Kryeministër kur vizitoi Francën. Përveç kësaj, bisedimet e 2007-ës dhe samiti informal i Sochi-t siguroi mundësinë e një kompromisi. Në qershor 2008, në vizitën e tij të parë në një shtet perëndimor (Gjermani), Medvedev theksoi dy lajtmotivet e politikës së jashtme ruse. E para, që zgjerimi i NATO-s do të dëmtonte seriozisht marrëdhëniet me Rusinë; e dyta, që përjasja transatlantike nuk është më e përshtatshme që të adresojë sfidat e sigurisë në Europë. Ai propozoi krijimin e një “pakti sigurie europian” që do të lidhte të gjitha palët. Ai përmblodhi idenë kryesore për të rinovuar arkitekturën ekzistuese të mbrojtjes dhe përmendi nevojën për një “hapësirë frymëmarrjeje” për të diskutuar për Kosovën dhe sistemin e mbrojtjes raketore (Medvedev, 2008). Në mënyrë jo direkte, Presidenti Medvedev ka inkurajuar riformimin e dialogut ekzistues, por pa zgjeruar NATO-n dhe me Rusinë që ka marrë një rol të ri. Kjo është hera e parë që një propozim i ri është afruar dhe mbrojtur, në një ton më të përpunuar dhe të sjellshëm (edhe pse ne mund të marrim me mend që implikon një refuzim të rolit që SHBA-ja ka luajtur në Europë).

Putini dhe Medvedevi kanë përsëritur njëri-tjetrin në vizitat e tyre, meqenëse ata përbëjnë një lidhshmëri tandem. Disa ditë para vizitës së Medvedevit në Gjermani, Putin shprehu ide të tilla në Paris. Ai shpjegoi që Irani nuk është një kërcënim bërthamor; për më tepër, ai përsëriti që NATO afekton logjikën e bllokut dhe ju referua disa bazave ushtarake në Rumani dhe Bullgari si kontradiktore me qëllimet kolektive të deklaruara për limitim armësh. Zgjerimi i sistemit të SHBA-

së shihet si një thellues i kësaj tendencës së fundit (De Hoop Scheffer, 2009). Kundërshtimi i tij me zgjerimin e NATO-s në parim është konfirmues me argumentin e prezantuar nga Medvedev: Rusia sfidon aleatët aktual dhe rolin e saj në Europë.

Mbrojtja raketore pastaj nuk është një çështje e izoluar dhe kontroversiale dhe duhet të kuptohet nga një panoramë më e gjerë, ku aktorët (veçanërisht Rusia) lidhin çështje të ndryshme si një mënyrë për të arritur qëllimet. Në rastin e Ruisë, rekuperimi nga poshtërimi i viteve të Jelcinit është një faktor i rëndësishëm. Sidoqoftë, çështja e sigurisë dhe kufijve të saj është më thelbësore dhe shkon përtej simbolizmit politik post-imperial. Zgjedhjet e 2007-ës, të cilat kanë errësuar interpretimin e politikës së jashtme ruse, kanë mbaruar tani dhe është e qartë, kryesisht që nga lufta në Gjeorgji në Gusht, që Kremlinin kërkon të rivendosi rolin e tij në fqinjët dhe në nivel global.

Duke zgjidhur çështjet e sigurisë

Dy çështje kryesore janë paraqitur nga Rusia në lidhje me sistemin anti-raketor: Vendimi i Ruisë për të ndërprerë Traktatin e Forcave Konvencionale të Armatosura në Europë (CFE) dhe kundërshtimi i saj ndaj zgjerimit të mëtejshëm të NATO-s në lidhje me Ukrainën dhe Gjeorgjinë. Kjo e fundit është e lidhur me deklaratën e pavarësisë së Kosovës në shkurt 2008, me argumentin e Kremlinit që kjo ngjarje krijon një precedent për njësitë e tjera separatiste në Transnistri, Abkazi dhe Osetinë e Jugut. Përveç kësaj, Rusia i mbështeti këto krahina, gjë e cila çoi në rritjen e tensioneve midis Abkazisë dhe Tbilisit nga marsi 2008 e deri më sot. Pas Luftës Ruso-Gjeorgjiane, Moska njohu pavarësinë e të dy njësisve. Një zgjidhje për këto konflikte të ngrira, ose të paktën stabilizimi i tyre, është thelbësor për çdo aspiratë gjeorgjiane. Gjatë mandatit të tij, Presidenti Xhorxh W. Bush bëri përpjekje të ndryshme diplomatike për të mbështetur ambiciet ukrainase dhe gjeorgjiane në këtë aspekt. Megjithatë, një numër aleatësh

europianë ishin kundër këtij propozimi dhe si rrjedhojë NATO ndërmori perspektivën e hyrjes, por e vonoi atë duke e lënë pa një datë të caktuar.

Për Moskën, kjo zgjidhje nuk ishte e kënaqshme pasi anëtarësimi ishte shtyrë (ndërsa vazhdohej të inkurajohej) dhe sepse aleatët vendosën të plotësonin projektin anti-raketor me një sistem të zhvilluar nga aleanca për të mbuluar zonën gjeografike të lënë jashtë nga planet e SHBA-së. Është interesante të vëzhgojmë që ndarja midis aleatëve është e ngjashme me divergjencat midis shteteve anëtare të BE-së kundrejt Ruisë. Për shembull, Franca dhe Gjermania janë partnere kyç për Rusinë në Europë dhe janë të predispozuar të marrin një pozicion të kujdesshëm dhe pajtues, kryesisht kur interesat strategjike janë në rrezik. Në prill 2008, samiti përfaqësoi një arritje për të ndihmuar trashëgiminë e Bushit në çështjet e jashtme. Konfirmimi i përforcimeve të aleatëve në Afganistan balancoi pozitivisht samitin. Përsëri, kjo nuk e fsheh krizën e identitetit të organizatës, e cila është akoma duke luftuar për një pranim të gjerë kombëtar dhe ndërkombëtar për një *raison d'être*. Rritja e rëndësisë së Ruisë në agjendën e NATO-s ka provokuar një rezultat të papritur. Disa ditë para samitit, sekretari i përgjithshëm i NATO-s theksoi që ka ndihmuar për të mbajtur aleancën të bashkuar më shumë sesa pritej⁵.

Pse NATO perceptohet si kërcënim nga Rusia? Ambasadori rus në NATO Dimitri Rogozin ka shprehur ndoshta pikëpamjet më radikale mbi aleancën dhe mbi Kosovën. Argumentet e tij çuan madje në një konflikt me Agjencinë Franceze të Lajmeve (AFP), të cilën Rogozin e akuzoi për shtrembërim fjalimi. Ai mohoi citimin në të cilin ai kërkoi përdorimin e forcës për të imponuar respektimin e të drejtës ndërkombëtare në Kosovë⁶. Fakti që Putini e caktoi këtë politikan nationalist në postin e Ambasadorit Rus në NATO

⁵ "NATO closes ranks", Koment Editorial, *Financial Times*, 4 April 2008.

⁶ Letër nga Dimitri Rogozin kryeredaktorit të AFP-së në Paris më datë 25 shkurt 2008. Detaje nga fjalimi i Rogozinit janë raportuar nga agjencia e lajmeve RIA Novosti (marrë nga <http://www.rian.ru/pressclub/20080222/99667207.html>).

në janar 2008 tregon vendosmërinë e Ruisë për të shprehur kundërshtimin e vet ndaj vendimeve të aleancës dhe sistemit të ri raketor në Europë. Për Rogozin (pra edhe për Moskën), zgjerimi i NATO-s dhe mbrojtja raketore “janë një rrezik i qartë dhe i pranishëm për Ruisinë” (Osipovich, 2008). Ndërsa vetë Presidenti Putin mbështeti të njëjtën ide kur kërcënoi të vendoste nën shënjestrën e raketave Ukrainën, në qoftë se do të bashkohej me aleancën (Belton, 2008). Për Kremlinin këto dy çështje janë të lidhura ngushtë me ekuilibrin e forcave në Europë. Kujdesi i Francës dhe Gjermanisë në Bukuresht në vonimin e Planit të Veprimit për Anëtarësimin në NATO të Gjeorgjisë dhe Ukrainës reflektuan dëshirën për të ruajtur marrëdhëniet me Moskën.

Këto ngjarje tregojnë gjithashtu që ky zgjerim i tretë pas Luftës së Ftohtë ndryshon nga dy të parët e 1999 dhe 2004. Rusia tani është e aftë të kundërshtojë status quo-në që kishte pranuar më parë pasi pozicioni i saj në balancën e pushtetit ka ndryshuar. Të paktën në mënyrë parciale, ekziston një sinjal i fortë që Rusia ka rëndësi dhe që “fqinjësia e përbashkët” është edhe një çështje e Ruisë. Kryeministri Francez Fransua Fillon mbështeti një pikëpamje të shprehur nga disa anëtare të BE-së dhe NATO-s ku ai shpjegoi që Franca ishte kundër këtij anëtarësimi sepse nuk ishte “përgjigja e duhur për këtë ekuilibër, për marrëdhëniet e pushtetit në Europë dhe për marrëdhëniet e Europës dhe Ruisë” (Zecchini, 2008), edhe pse duke u shprehur kështu ai bëri një gafë mediatike. Përpara Samitit të Bukureshtit, Uashingtoni ndërmoi përpjekje diplomatike për të zbutur kundërshtimin e Ruisë ndaj agjendës së samitit. Samiti u mbajt në 3 prill, ditën mbasi Këshilli NATO-Rusi u takua, dhe në 6 prill u mbajt një samit bilateral në Sochi. Kjo sekuencë takimesh është interpretuar si një pikë kthimi që kishte për qëllim të vendoste trashëgiminë e Bushit në fund të mandatit të tij dhe fundin e mandatit të Putinit si president.

Tema tjetër e diskutimit ishte Traktati Strategjik për Reduktimin e Armeve i 1993-it (START II) i cili nuk ishte implementuar pasi Rusia u tërhoq nga ai menjëherë pasi Uashingtoni u tërhoq nga Traktati ABM. Kjo marrëveshje

është shumë relevante pasi ndaloj raketat ndërkontinentale me mjete të shumta hyrjeje (MIRVed ICBMs). Këto lloj raketash ndërrojnë aftësinë për të ndryshuar dhe shpërndarë një goditje të parë, meqenëse aftësia për shkatërrim është rritur nga raketat e ndryshme të mbajtura nga një raketë e madhe e vetme. Traktati i parë START përfundon në 2009. Dhe ka një rol thelbësor në shkatërrimin e armëve strategjike bërthamore në SHBA dhe Rusi. Pas tërheqjes së SHBA-së nga Traktati ABM në 2002, ideja e një START III u bë e paralizueshme. Në vend të tij, “Traktati i Moskës” (më saktë, Traktati Strategjik për Reduktimet Ofensive ose SORT) u nënshkrua në 2002 midis dy palëve. Ky traktat u krijua për të zvogëluar numrin e raketave operacionale deri në 2012. Palët nënshkruan gjithashtu dhe një deklaratë paralelisht me Traktatin SORT, e cila krijoi një Grup Konsultativ për Strategjinë e Sigurimit. Konsultimet duhet të mbulojnë masa konfidenciale dhe transparence, po ashtu dhe çështje të tjera strategjike të interesit reciprok⁷. Pala Ruse ankohet që Uashingtoni nuk i diskutoi më parë zhvillimet e mbrojtjes raketore europiane, në kornizën e tij konsultative (Pikayev, 2008). Janë pra dy traktate bërthamore që rregullojnë marrëdhëniet midis Uashingtonit dhe Ruisë, por ndërveprime pozitive nevojiten për zëvendësimin e tyre në një kohë afatshkurtër. Në 6 mars, Sekretarja e Shtetit të SHBA-së Hillari Klinton dhe kolegu i saj Rus Sergei Lavrov ranë dakord në një “plan pune” për të zëvendësuar Traktatin START, para takimit të parë midis Presidentit të SHBA-së Barak Obama dhe Medvedevit në prill në Londër (Londër, 2009).

Një traktat tjetër që lidhet me skemën bërthamore irrituese midis dy vendeve dhe vendeve europiane është Traktati CFE i vitit 1990. Kjo marrëveshje vendosi një përmbajtje kooperative

⁷ Shiko listën e “US-Russian bilateral treaties and agreements” në websitin e Iniciativës së Kërcënimit Bërthamor, Washington, D.C. (marrë nga http://www.nti.org/f_WMD411/f1b2_2.html). Shiko gjithashtu “Text of the Joint Declaration” në websitin e Shtëpisë së Bardhë, Washington D.C. (marrë nga <http://www.whitehouse.gov/news/releases/2002/05/20020524-2.html>).

në Europë në fushën e armatimeve konvencionale nga Atlantiku dhe maleve Urale. Një version i përshtatur u nënshkrua në vitin 1999 në Samitin e Stambollit për Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSCE)⁸. Një përbërës i Traktatit të CFE-së është edhe vendosja e tavaneve kombëtare në krahinat “fqinjje”, si është Kaukazi Verior Rus. Kjo kornizë ligjore dobësohet nga kushte specifike nga ana ruse për t’u përshtatur me masat e fqinjëve të CFE-së dhe me impenjimet e ndërmarra në Samitin e Stambollit në lidhje me tërheqjen e forcave ruse nga Gjeorgjia dhe Moldavia. Gjithashtu, në dhjetor 2007 Moska vendosi të ndërpresë implementimin e tij për arsye të ndryshme (Socor, 2007). Rusia është e shqetësuar nga fakti që shtete baltike janë tani anëtare të NATO-s dhe nuk kanë ratifikuar akoma versionin e përshtatur të Traktatit të CFE-së të vitit 1999 (ata nuk janë pjesë e versionit të 1990-ës pasi në atë kohë ata ishin pjesë e Bashkimit Sovjetik). Midis arsyeve të prezantuara, më e rëndësishmja është që Rusia e sfidon traktatin vetë dhe kërkon një rinegoci total për të përparuar termat e saj të preferuara. Kërkesat e Ruisë kanë kaluar në kundërshtim me sistemin raketor mbrojtës së SHBA-së. Ndërhyrja e forcave Ruse në Abkazi dhe Oseti të Jugut vështirëson më shumë çdo vëzhgim të Traktatit të CFE-së.

Efektet e Ringjalljes së Ruisë

Që prej 2007, Moska ka filluar një proces ringjalljeje në skenën ndërkombëtare. Arsyeja kryesore është performanca e saj ekonomike dhe të ardhurat nga burimet energjetike. Kjo zhvendosje nxjerr në pah një Rusi më të fortë dhe është shumë

⁸ 30 anëtarët e Traktatit të CFE-së janë Armenia, Azerbajxhani, Bjellorusia, Belgjika, Bullgaria, Danimarka, Franca, Greqia, Gjeorgjia, Gjermania, Holanda, Hungaria, Islanda, Italia, Kanadaja, Kazakistani, Luksemburgu, Mbretëria e Bashkuar, Moldavia, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Republika Çeke, Rumania, Rusia, Sllovakia, SHBA, Spanja, Turqia dhe Ukraina.

e rëndësishme për imazhin dhe perceptimin e Ruisë si një fuqi botërore, veçanërisht pas frustrimit të periudhës së Yeltsinit. Mund të merret si i mirëqenë fakti që Rusia është një partner i pashmangshëm për marrëveshje mbi çështjet e sigurisë në Europë dhe që ka një ndërvarësi të fuqishme mes BE-së dhe Ruisë. Prapëseprapë kjo marrëdhënie është asimetrike edhe nëse Rusia është gjeografikisht e rëndësishme për BE dhe SHBA, sepse Rusia është në vetvete shumë e varur nga BE-ja të paktën ekonomikisht. Përdorimi i sistemit tërheqës të energjisë si një instrument qendror i politikës së jashtme reflekton strategjinë e orientimit rus, kundër asaj që është perceptuar si një mangësi e koherencës dhe konsekuencës në politikën e jashtme të zgjedhjeve të Kremlinit. Qasja që u përdor për të avancuar kërkesa ndaj shteteve tranzit si Ukraina ose Bjellorusia janë kritikuar shpesh nga BE. Moska i përdor burimet energjetike si një mjet, por marrëdhëniet e ndërvarësisë me Europën ngelen, sepse Rusia ka nevojë për tregjet Europiane. Kriza e janarit 2009 e ekspozoi këtë lojë të shtetit.

Menaxhimi i kësaj ndërvarësie është megjithatë politik. Deri më tani, shtete anëtare të BE-së kanë përzgjedhur të bëjnë marrëveshje të privileguara bilaterale, duke minuar konsistencën e BE-së. Energjia është theksuar që në vitin 2006 sepse Rusia është rimëkëmbur falë të ardhurave dhe investimeve të reja të energjisë (për shembull, në fushat e gazit dhe naftës të Sakhalin II dhe Shtockman). Kjo zhvendosje e shpejtë tregon një tendencë nacionaliste larg imponimeve të mëparshme të vështirësive ekonomike. Edhe nëse procesi është i kritikuar, pasi është përdorur si instrument nga shteti oligark, është akoma një aspirim i përbashkët midis aktorëve të brendshëm Rus dhe midis lojtarëve të brendshëm në shtetet e tjera në përgjithësi. Një zgjidhje politike pragmatike në këto rrethana duket më e lehtë sot sepse energjia është një nga elementët më të rëndësishëm në agjendën për bashkëpunim, kjo dhe për faktin se që nga viti 2007, BE-ja ka bërë shumë progres në zhvillimet e një politike të përbashkët energjetike. Nëse multilaterizmi nuk funksionon për momentin në fushën e energjisë, është e vështirë të diskutohet për qasje bilaterale

të ndërmarra nga Rusia dhe anëtarët e shteteve të BE-së. Vullneti politik është thelbësor për të përcaktuar interesa të përbashkëta në një fushë që bën pjesë në sovranitetin territorial të shteteve anëtare, edhe nëse bashkëpunimi është i duhur për stabilitetin afatgjatë në sigurimin e energjisë. Prandaj, dëshira e NATO-s për të diskutuar për sigurimin e problemeve energjetike - është politikisht e ndjeshme për anëtarët e shteteve dhe në marrëdhëniet mes BE-së dhe Rosisë (Monghan, 2009).

Ka pak dyshim që mbrojtja me anë të raketave në Europë do të ndryshojë ekuilibrin e tanishëm dhe kapacitetin mbrojtës. Sipas Webb (2008), do të minonte diplomacinë dhe kontrollin multilateral të armëve në favor të përdorimit të njëanshëm të forcës, si në Irak. Agjenda Amerikane e mbrojtjes me raketa “nuk përshtatet me modelin bashkëpunues të sigurisë që europeanët mbështesin”. Përhapja e armëve është po ashtu një rrezik i spikatur nga oponentët e sistemit. Por për SHBA-në, do të përmirësonte kapacitetin frenues ndaj një sulmi eventual nga Irani ose Koreja e Veriut. Përsëri, dy pikëpamje të ndryshme u shfaqën. Nga njëra anë, dikush mund të diskutojë që mbrojtja me anë të sistemit të raketave mund të shërbejë si frenuese, duke anashkaluar rrezikun e një sulmi ose të zhvillimit të armëve nukleare⁹. Nga ana tjetër, dikush mund të diskutojë që një rreth vicioz do të shfaqet (i ngjashëm me një garë luftime të ftohtë) dhe armët alternative do të zhvilluara për të kundërshtuar përmbajtjen e efekteve të raketave të shqyrtuara. Fakti që Rusia është e angazhuar në ndërtimin e ushtrisë është parë tanimë si një shenjë në këtë sens (Muller, 2007). Gjithashtu, mbështetja e Rosisë mbi armatimin nuklear dhe investimi i dobët për forca

⁹ Thränert (2007) zhvillon një argument shumë të përpunuar mbi efektin parandalues të mbrojtjes me raketa, e njohur si një menaxhim krizash. Gjithashtu është interesante të dihet një nga argumentet e Rosisë mbi parandalimin duke qenë se asistencën e Moskës ndaj Iranit përsa i përket zhvillimit të teknologjisë nukleare civile ndihmon mospërhapjen, sepse kontrolli rus në procesin prodhues dhe rimëkëmbës të karburantit parandalon përdorimin e tij për qëllime ushtarake.

konvencionale, u përdor nga SHBA-ja për të justifikuar nevojën e një mburoje moderne ndaj nuklearit¹⁰. Ky ka qenë një nga argumentet shitesë të SHBA-së përveç motiveve për sa i përket Iranit. Kjo pikëpamje mund të shihet si një mungesë koherence në debate, derisa Uashingtoni vazhdimisht ka deklaruar që raketat e planifikuara nuk janë të drejtuara kundër Federatës Ruse.

Ky diskutim i vazhdueshëm në mënyrë kolektive mbi pasojat dhe implikimet për të ardhmen e Politikës Europiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes (PESM) dhe marrëdhëniet me Rusinë, është i njëanshëm. Edhe pse shtetet anëtare gëzojnë sovranitetin mbi këtë çështje dhe ata janë të autorizuar të angazhohen në marrëdhënie bilaterale me Uashingtonin, që atëherë ka pasur shqetësime në rritje nga Brukseli. Veçantia e procesit të integritimit kërkon të paktën konsultime, duke mos përmendur thirrjen në rritje të solidaritetit të brendshëm europian, në veçanti në lidhje me Rusinë. Edhe pse PESM nuk mbulon mbrojtjen me raketa, Javier Solana deklaroi që “marrëveshjet në forcë caktuan sovranitetin mbi këtë çështje të shtetet anëtare, por kjo duhet të jetë e pajtueshme me interesat e përgjithshme të BE-së për sigurinë”¹¹. PESM ka një rol të madh në përcaktimin e rolit të BE-së si një aktor global në terma afatshkurtër dhe afatgjatë. Në hapësirën e përbashkët të bashkëpunimit mes BE-së dhe Ruisë në fushën e sigurisë së jashtme, dy aspektet kryesore janë menaxhimi i krizave dhe mospërhapja e armatimit nuklear. Sergei Ryabkov identifikoi një sërë pikëpamjesh vetëm në disa çështje, për sa i përket entiteteve separatiste (Ryabkov, 2008)¹². Mosproliferimi është kështu një pjesë esenciale e agjendës bashkëpunuese. Rusia rreshtohet e para midis shteteve jo anëtare të BE-së që ka numrin më të madh të takimeve me BE-në, në të gjitha

¹⁰ Shiko artikullin, “Pentagon Says Russia is Upping Nuclear Ante”, *Moscow Times*, 11 qershor 2008.

¹¹ “Solana: ‘CFSP must be compatible with EU strategy’”, *EurActiv.com*, 8 qershor 2007.

¹² Ryabkov ka qenë Drejtor i Drejtorisë së Bashkëpunimit Europian në Ministrinë e Jashtme të Federatës Ruse. Ai është sot zëvendësministër i Jashtëm.

nivelet. Ajo është po ashtu një partner special i NATO-s. Megjithatë ekziston një boshllëk në strukturën e arkitekturës europiane, e cila dështon të lidhë disa forume multilaterale dhe bilaterale për mbrojtjen e raketave dhe çështjeve të ngjashme.

Mënyra se si mbaroi samiti i Kennebunkport (July 2007) dhe samiti i BE-Rusisë në Samara (May 2007) janë akoma të rëndësishme në karakteristikën e lojës së shtetit prezent: ndërvarësia e sigurisë dhe politikës është e njohur, por “mundja mendore” vazhdon akoma. Arritjet janë të reduktuara edhe nëse kanalet e komunikimit ngelin të hapura. Është akoma e nevojshme të fshihen tensionet që të mund të menaxhohen marrëdhëniet që janë me konstruktive me shtetet anëtare të BE-së dhe NATO-s. Kjo ide ishte e prezantuar nga Klintoni te Lavrov, në një përpjekje të pasuksesshme në një lojçak diplomacie. Gjatë takimit të tyre në Gjenevë në mars të 2009, ajo e prezantoi atë me një buton të kuq plastik të ambalazhuar me fjalën “vë në vend” (por versioni rus lexonte “mbingarkesë”, si një gabim përkthimi) (Lander, 2009). Fakti që dy shtetet anëtare të BE-së janë të përfshira në konfliktin rus me Uashingtonin për të instaluar sistemin e mbrojtjeve të raketave i komplikon gjërat më shumë. Kjo është në veçanti një çështje shumë sensitive, meqë Rusia ka kërkuar bashkëpunim të ngushtë me mbrojtjen e BE-së që nga viti 1999. Moska mendon që BE-ja nuk është alternuar dhe do të konsideronte përfshirje të madhe të BE-së në sigurinë europiane që është një mënyrë për të provokuar një shqetësim të rolit të SHBA-së në NATO dhe Europë.

Europianët dhe propozimi i Medvedevit

Çështja se si të interpretohet Rusia dhe po ashtu se si të merresh me të është një temë e ditës në shqetësimet perëndimore. Kjo pyetje ka ridimensionuar në rëndësinë e saj që nga viti 2006, për arsye të fuqisë në rritje të Rusisë, që mund të shihet në konfliktet e fundit mbi energjinë, por po ashtu

edhe në mundësinë e Kremlinit për të kundërshtuar zhvillimet të padëshiruara si është zgjerimi i NATO-s dhe po ashtu lufta e fuqishme në Gjeorgji në gusht të 2008-së. Në qarqet perëndimore ka gjithashtu mosmarrëveshje mbi atë se si të interpretohet fuqia e Ruisë. Deri më tani, aleanca e NATO-s dhe shtetet anëtare të BE-së kanë treguar një qëndrim prit-dhe-shih drejt propozimit të Medvedevit për ristrukturimin e arkitekturës së sigurisë drejt një pakti të ri europian të sigurisë.

Duke analizuar debatin që vazhdon të provokuar nga diskurset mbi sigurinë të Ruisë, duhet të peshohen dy elemente: e këtu duhen analizuar diskutimet brenda e Ruisë kundër kapaciteteve të Kremlinit për t'i realizuar ato. Propozimi i Medvedevit është ende i turbullt dhe shpeshherë jo konsistent. Nga ana e BE-së, askush nuk shikon një plan rus të qëndrueshëm. Megjithatë, diskurset duhet të interpretohen nisur nga një shqyrtim i hollësishëm mbi kapacitetet e Ruisë për të arritur rezultatet e dëshiruara. Këtu ne vlerësojmë kapacitetin në fushën e sigurisë.

Moska ka arritur një përmirësim të ndjeshëm të në aftësinë e saj për të kundërshtuar disa vendime të rëndësishme gjatë tre viteve e fundit. Propozimi i Medvedevit duhet të shikohet në perspektivën e politikës së re ruse, e përgjithësuar në një mënyrë më të plotë nga Putini në Mynih më 2007, dhe pastaj e zyrtarizuar në doktrinën e korrik 2008. Doktrina e hartuar më 2000 u zëvendësua në mënyrë informale nga Putini dhe më pas nga Medvedev. Presidenti aktual ka adoptuar një linjë vazhdimësie duke e nxitur forcimin e rolit të Ruisë dhe duke kundërshtuar rolin kyç të NATO-s në Europë. Megjithatë, qëndrimi i tij ka qenë më i balancuar dhe i drejtuar drejt modernizimit të vendit. Në maj 2008, fjalimi i tij në Berlin i bëri thirrje për krijimin e një pakti të ri europian për sigurinë, por pa e specifikuar modus operandi-n. Qysh atëherë, ai ka përsëritur në mënyrë të vazhdueshme ankesat e tij kundër të ashtuquajturit unilateralizmit amerikan dhe përgjegjshmërisë së SHB për krizat financiare globale. Ai po ashtu ka nënvizuar *përcaktuesin* e Ruisë për sa i përket hartimit të kuadrit ligjor të ri për një botë multipolare. Kështu, në Evian më 8 tetor 2008, ai theksoi se “vizioni euroatlantik i sotshëm kërkon një agjendë

pozitive. Ngjarjet në Kaukaz kanë konfirmuar në mënyrë të veçantë sesa absolutisht i drejtë është sot koncepti i një traktati europian për sigurinë. Kjo do të na jepte çdo mundësi për të ndërtuar një sistem të qartë sigurie të integruar dhe solid”.

Më 31 korrik të po atij viti, një dekret presidencial i nënshkruar, sqaronte ndryshimet e theksuara më sipër. Koncepti i ri i politikës të jashtme thekson këto objektiva të federatës:

Zhvillimet ndërkombëtare në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare në fillimin e shekullit XXI dhe *fuqizimi* i Rusisë kërkojnë *rivlerësimin* e situatës së përgjithshme rreth Rusisë, rivlerësimi i prioriteteve të politikës së jashtme të Rusisë për duke marrë në konsideratë *rritjen e rolit të vendit në çështjet ndërkombëtare*, përgjegjësisë së tij më e madhe për zhvillimet globale dhe mundësitë respektive për të marrë pjesë në zbatimin e agjendës ndërkombëtare, ashtu si dhe të zhvillimit të saj.

Në terma më konkret, tre çështje të ndërthurura të sigurisë janë adresuar dhe kundërshtuar nga Rusia me sukses: 1) mbrojtja raketore, 2) zgjerimi i NATO-s me Ukrainën dhe Gjeorgjinë, 3) dhe Traktati e CFE-së. Të tre këto çështje janë trajtuar në forume të ndryshme, në takime në nivele bilaterale dhe multilaterale. Arkitektura ekzistuese e sigurisë e bën të vështirë për të diskutuar për mbrojtjen raketore jashtë dialogut bilateral SHBA-Rusi. Aktualisht, ka disa linja të dialogut mbi sigurinë, të cilat nuk mbivendosen domosdoshmërisht. Për shembull, BE nuk ka kompetenca sipas Artikullit V të Traktatit të BE-së për të diskutuar çështje të sigurisë të infrastrukturave. Kështu që, vendet anëtare, janë të afta për të ndjekur objektivat e tyre kombëtare përmes bisedime bilaterale me vendet jo anëtare të BE-së. Zgjerimi i NATO-s është më shumë një temë ndarëse mes shteteve anëtare krahasuar me planin e SHB për të zgjeruar mbrojtjen raketore në Europë. Kështu që mosmarrëveshjet për zgjerim çuan në një vonesë ndaj ofertës për Planin Veprimi për Anëtarësim ndaj vendeve kandidateve. Për sa i përket armatimit konvencional, ka një shqetësim të përbashkët të vendeve anëtare rreth vendimit rus të dhjetorit 2007 për të shtyrë zbatimin e Traktatit të CFE-së. Për të përfunduar, shtetet anëtare të BE-së e kanë

mbështetur mbrojtjen raketore në NATO, por janë treguar të kujdesshëm për zgjerimin dhe të shqetësuar për çështjen e Traktatit së CFE-së. Këto tendenca brenda vendeve anëtare mund të përkthehen si mesazhe kontradiktore ndaj Moskës, që përfaqësojnë qëndrime negative ose pozitive në lidhje me pozitën e Kremlinit mbi këto tre mosmarrëveshje.

Përgjigjet europiane deri më tani kanë nënvizuar se ndryshe nga çka ndodhi në vitet 1990, këto mosmarrëveshje afatgjata dhe periodike duhet tani të trajtohen duke marrë parasysh si një kapacitet real të Rusisë për të ndikuar. Menjëherë pas zgjedhjes së tij, Obama mori një shenjë të qartë nga Rusia në lidhje me planet e SHBA-së për sistemin anti-raketë: “Unë mendoj është më mirë për të të dijë çka duhet të presë nga Rusia në rast se merret ky vendim”. Me këto fjalë të hidhura mikpritjeje, Ambasadori në BE, Vladimir Chizhov i dërgoi një mesazh se Moska ka mjete në dispozicionin e saj, konkretisht mundësinë për të instaluar raketat në Kaliningrad. Për sa i përket vendimit të zgjerimit të NATO-s, në praktikë është ruajtur, por duke zëvendësuar Plan Veprimin për Anëtarësim me ofertën e programeve vjetore për bashkëpunim.

Njëherësh dhe jozyrtarisht, Këshilli NATO-Rusi rifilloi mbledhjet e tij, të cilat ishin pezulluar pas luftës së gushtit. Rifillimi zyrtar ndodhi në mars 2009. Këto takime ilustrojnë më tej mungesën e sinjaleve të qarta duke përzier reagimet e forta dhe ato pohuese. Kjo dualitet qëndrimesh është dukshëm kontradiktor. Mund të kuptohet lehtë duke llogaritur disa elementë. Për shembull, edhe nëse Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s pranon se nuk ka asnjë alternativë përveçse angazhimit me Rusinë, nga ana tjetër aleanca ka ritheksuar në të njëjtën kohë mbështetjen e saj për mbrojtjen raketore të Uashingtonit. Zvarritja nga ana e Rusisë ndaj Traktatit të CFE-së shton vështirësi të tjera në kapitullin e kontrollit të armatimeve. Megjithatë, SHB duhet të mbështeten në përkrahjen e Moskës në teatrin afgan, në veçanti për transportimin të logjistikës.

BE nuk i është përgjigjur thirrjeve të Rusisë që prej vitit 1990 për rikonsiderimin fundamental mbi marrëdhëniet transatlantike dhe sigurinë europiane. Përkundrazi, Brukseli ka investuar më shumë në bashkëpunimet ekonomike me Rusinë,

ndërsa marrëdhëniet Rusi-SHB janë fokusuar mbi sigurinë. Në të vërtetë, në 1990, politikat e jashtme ruse kanë qenë gjithmonë pro-europiane, duke u bazuar në ekzistencën e një ideali europian. Ky trend zgjati deri në fillimin e mandatit të parë të ish-Presidentit Putin. Moska konsideroi se kishte një marrëveshje të fshehtë midis BE-së dhe NATO-s, të paktën nga perspektiva afatgjatë. Lindley French (2003) nënvizoi se pas Luftës së Ftohtë, NATO u mundua të bëhej më shumë politike, ndërsa BE u mundua të bëhej më shumë ushtarake. Sidoqoftë, roli dhe evolucioni i BE-së është perceptuar si një mundësi alternative të NATO (dhe SHBA) në Europë, një pozicion i rrënjosur në idenë e Gorbachovit për një “shtëpi të përbashkët europiane”. Putini bëri një apel të ngjashëm në shtator 2001, në fjalën e tij në Bundestag. NATO akoma përfaqëson një sfidë për interesat e Rusisë, pavarësisht eksperiencave të modus vivendi (për shembull, në Këshillin Rusi-NATO). Por megjithatë, Moskës i është dashur të shmangë një situatë ku ajo nuk do të kishte mundësi hyrjeje në një institucion roli i të cilit është i rëndësishëm për sigurinë europiane.

Në këtë sens, siguria po hyn në marrëdhënien BE-Rusi si një çështje e re për debat. Është akoma shumë herët të parashikohet se si diskutimet mbi arkitekturës së sigurisë europiane dhe nevoja për ripërcaktimin e saj do të influencojnë marrëdhëniet Moskë-Bruksel. Është një çështje komplekse meqenëse implikon diskutime për rolet e NATO-s, SHBA-së, Këshillit të Europës dhe OSBE-së. Bashkimi nuk është përgjigjur akoma, të paktën në një mënyrë të qëndrueshme, e cila mund të shpjgohet nga mosmarrëveshjet e brendshme: një qëndrim pasiv prit-dhe shih (me specifikisht të pritët radha e Obamës) kundër një qëndrimi shumë aktiv (për shembull prezantimi i një oferte të BE-së). BE tashmë duhet të merret më seriozisht nga Rusia në çështjet e sigurisë dhe hija e SHBA-së e ndikon këtë fakt.

Me sa duket ekziston një mundësi që BE të ketë një rol më të madh dhe më të përcaktuar në debatin që pritët mbi sigurinë, rol të cilin Rusia mundësisht do ta mirëpresë. Përzgjedhja përdoret akoma më shumë në këtë marrëdhënie, që për shembull çon në përparësimin e tregtisë dhe energjisë. Një Rusi e ringjallur, sidoqoftë, kërkon nevojën që BE të hartojë një model të ri dhe të

qëndrueshëm të bashkëpunimit me Moskën, ndërkohë që BE do të vazhdojë të menaxhojë ndërvarësitë reale.

Konkluzioni: Drejt së ardhmes

Mosmarrëveshjet për mbrojtjen raketore nxjerrin në pah anët negative të dialogëve të ndryshme mbi sigurinë që janë duke u zhvilluar dhe nevojën për të zhvilluar një dialog më eficient multilateral BE-Rusi dhe NATO-Rusi dhe raportet bilaterale me Uashingtonin janë forume të rëndësishme për stabilitetin europian. Ngacmimet aktuale ndodhin në një kontekst të gjerë, politikisht të acaruar, i cili krijon distancë në vend të konvergjencës politike. BE dhe Rusia akoma nuk i kanë saktësuar rolet e tyre në arkitekturën e sigurisë europiane. Modeli i bashkëpunimit është akoma i hapur për ndërtim. Kundër këtij sfondi, elementët më të nevojitshëm sot janë aftësia për t'u përshtatur dhe dëshira për ta bërë këtë.

Në mënyrë paradoksale, me gjithë afërsinë e përjetuar qysh nga fundi i Luftës së Ftohtë, Federata Ruse është më e vështirë dhe një partner më pak bashkëpunues sesa Rusia e vitit 1990. Sot për me tepër, ka një përgjegjësi të përbashkët për të arritur në alternativa që janë të pranueshme për të gjithë partnerët dhe për të bashkëvepruar në mënyrë pozitive dhe jo konfrontuese.

Përcaktimi i interesave ruse po ndikohet nga ndjenjat ruse ndaj NATO-s dhe nga vlerësimi për rritjen e rolit në kontekstin e zgjidhjeve europiane. Ideali pan-europian për një Europë më pak të lidhur me SHBA dhe Aleancën është ende e gjallë. Megjithatë, mënyrë se si Rusia e ndjek këtë qëllim varet nga pranimi i statukuosë, i cili bazohet mbi perceptimin rus për vulnerabilitetin e vet në balancimin e fuqive. Kjo situatë i është nënshtruar një rivlerësimi që nga mandati i dytë i presidentit rus Putin. Një burim diplomatik anonim nga Moska thekson se diskursi aktual rus shfaq aspirata të mëdha, por ato janë të shkëputura nga gjendja e paqëndrueshme në Rusi. Fuqia relative ruse nuk është në të njëjtën linjë dhe nuk mbështet pritshmërinë e lartë ruse. Por pasi kemi thënë këtë, duhet përmendur se Rusia ka pësuar shumë ndryshime gjatë viteve

të Putinit dhe është një fuqi ende në rritje. Parashikueshmëria nuk është ende një anë e fortë e politikës ruse dhe kjo gjë nuk inkurajon bashkëpunimin ndërkombëtar. Për më tepër, Rusia nuk pranon në arenën ndërkombëtare asnjë ndërhyrje në afërsinë e saj. Kjo gjë ishte theksuar nga Medvedev, para luftës së verës së kaluar, në Forumin Ekonomik të Shën Petersburgut në 2008, kur ai deklaroi se Rusia e Gjeorgjia mund t'i zgjidhin vetë problemet e tyre (Kishjovski, 2000).

BE dhe aleatët e NATO-s nuk duhet të injorojnë thirrjen e Ruisë për të pan-europianizuar dialogun aktual, e njëkohësisht duke reformuar institucionet ekzistuese të sigurisë. Ka nevojë për t'iu referuar së kaluarës për të ecur përpara. Karta e Parisit të 1990-ës dhe Deklarata e Lisbonës në 1996 e OSBE-së janë gurët e themelit për të kuadruar idenë e mëposhtme: një Europë e bashkuar nga vlera të përbashkëta dhe nga pandashmëria e sigurisë së saj. Thirrja e Presidentit Medvedev në 2008 për të nisur një traktat të ri sigurie në Europë është një inkurajim për t'u përballur me mosarritjet në riformatimin e institucioneve, por gjithashtu kjo thirrje ngre shumë shqetësime për aq kohë sa ajo mund të reflektojë një dëshirë jo realiste për të ndryshuar strukturat ekzistuese në mënyrë thelbësore¹³ dhe të dobësojë rolin e SHB në Europë në vend që të reformojë marrëdhëniet dhe institucionet si për shembull NATO dhe OSBE.

Çështja kryesore në mosmarrëveshjet mbi çështjet e sigurisë qëndron në një mospërputhshmëri të plotë të pikëpamjeve, përveçse, edhe në kthetrat e konceptit rus të arkitekturës së sigurisë. Nga njëra anë, Kremli nuk e njeh legjitimitetin e ekzistencës së NATO-s në periudhën e pas Luftës së Ftohtë. Nga ana tjetër, aleatët as që e vënë në dyshim ekzistencën e NATO-s. Disa komente të fundit të Sekretarit të Përgjithshëm reflektojnë këtë situatë kur ai pranoi se dëshiron të angazhohet në një dialog mbi propozimet e Medvedevit, por ai e konsideron arkitekturën ekzistuese të sigurisë “të kënaqshme” dhe “të balancuar” (De Hoop Scheffer, 2009).

¹³ Sergey Lavrov, Ministër i Punëve të Jashtme, komentoj në këtë mënyrë shqetësuese në Forumin Ndërkombëtar Ekonomik të 12-të në Shën Petersburg në qershor 2008.

Si mundet që BE dhe NATO të përmirësojnë dialogun e sigurisë me Rusinë? Megjithëse BE është në disavantazh sepse nuk ka mandat për të diskutuar çështje si mbrojtja raketore apo Traktati CFE (për shkak të Artikullit V të Traktatit të BE-së) ajo megjithatë ka autoritetin dhe virtytet me të cilat mund të ruajë një dialog konstruktiv me Rusinë.

Kuadri bashkëpunues ka qenë i çmuar megjithëse ka nevojë për përmirësime për të arritur një bashkëpunim konkret në nivelin e politikës europiane të sigurisë dhe mbrojtjes (ESDP). Një marrëveshje për shkëmbimin e informacionit të klasifikuar është i nevojshëm për të ecur përpara në këtë drejtim. Megjithatë, Traktati i Lisbonës është një mjet i rëndësishëm për të thelluar politikën e përbashkët europiane në fushën e sigurisë (CFSP/ESDP), për aq kohë sa vendet anëtare dëshirojnë ta bëjnë këtë. Çështje të sigurisë infrastrukturore (hard) dhe mosmarrëveshjet midis europianëve rreth politikës së fqinjësisë (nivelin e angazhimit dhe zgjerimin e mëtejshëm) krijojnë dyshime mbi palën ruse mbi avantazheve të lidhjeve më të ngushta mbi një bashkim europian jo koheziv. Vetëm një BE më i fortë si një aktor global mund t'i ofrojë diçka Ruisë në këto fusha. Me gjithë pikëpamjet skeptike të Ruisë mbi projektin e një Europe të Bashkuar, për Rusinë, Europa është një pjesë e rëndësishme e arkitekturës së sigurisë për aq kohë sa kanalet e tjera janë përkeqësuar (SHBA dhe NATO).

Besimi politik është një element i rëndësishëm që duhet të thellohet më tepër, për shembull, do të ishte një parakusht për të bashkëpunuar në mbrojtjen raketore nëse do të pranohej më shumë transparencë dhe masa të rëndësishme të rritjes së besimit. Çdo aktor duhet të zërë një rol të kënaqshëm për veten për të marrë përgjegjësinë e tij në Europë. Ku dhe si Rusia do të përshatej në një strukturë rajonale të bashkëpunimit, është një çështje që diskutohet shpesh. Kjo mund të arrihet në qoftë se merren parasysh mungesa e përsosmërisë për sa i përket arritjeve në marrëdhëniet e sigurisë dhe e dialogut të institucionalizuar. Për këtë qëllim duhen të dy anët e medaljes. Nga njëra anë, vetë vendet perëndimore kanë pikëpamje të ndryshme mbi pozicionin në rritje të Ruisë, “Rusia do të ndikojë në të ardhmen e afërt dhe prandaj është e

nevojshme për të lexuar atë drejt” (Trenim, 2007). Nga ana tjetër Rusia duhet të gjejë një rol dhe vend konstruktiv pavarësisht faktit të pashmangshëm që NATO është ende një lojtar kyç në Europë dhe që vete BE është i mëshiruar në një dimension transatlantik. Kjo është në mënyrë të veçantë e rëndësishme në një kohë që BE është duke zgjeruar heqjen e kufizimeve të saj në rajonin e Detit të Zi dhe duke u përpjekur të forcojë një partneritet më të ngushtë me Europën Lindore, dhe që NATO është duke rikonceptuar misionin e saj në Samitin e Strasburg – Kehl. Këto aspirata dhe politika të reja janë duke u ngritur në një kontekst të ndryshuar në të cilin Rusia është duke komunikuar dhe vepruar ndryshe krahasuar me samitet e mëparshme të 1999 dhe 2004.

Lirshmëria e ngjarjeve më të fundit që lidhet dhe me politikën e re amerikane të Presidentit Obama është ndjellëse për interpretimin e erës së re në marrëdhëniet SHBA-NATO-Rusi. Konferenca vjetore e Mynihut mbi sigurinë në Shkurt dërgoi sinjalet e para të përbashkëta dhe zbuti acarimin mbizotërues të mbrojtjes raketore. Kancelarja gjermane Angela Merkel dhe presidenti francez Nicolas Sarkozy shfrytëzuan rastin e madh për të nxjerrë një deklaratë të përbashkët në të cilën u theksuan dy çështje të rëndësishme: Ndërlidhja midis BE-së dhe Aleancës së Atlantikut dhe nevojën për të rindërtuar një partneritet me Rusinë (Merkel-Sarkozy, 2009). Në këtë mënyrë Rusia është një qendër të shqetësimeve të sigurisë të kohës. Mbeten dy pyetje për t'i dhënë përgjigje: Çfarë roli mund të luajë BE për të ndërlidhur bashkëpunimin transatlantik me marrëdhëniet me Rusinë? Dhe çfarë impakti do të ketë samiti i Strasburg-Kehl-in mbi mosmarrëveshjet e sigurisë, për sa i përket zgjerimit dhe mbrojtjes raketore? A është e pritshme që mund të jemi në gjendje për të shtypur butonin me Moskën kur agjenda e NATO-s është për më tepër legjitimitet dhe agjenda e Ruisë është për rindërtimin e një rendi të kontestuar të sigurisë.

Sandra Dias Fernandez është pedagoge në Universitetin e Minho (Portugali), studiuese kërkimore në CEPS (Bruksel) dhe kandidatë doktore në Sciences Po (Paris).

BACKGROUND

(Dokumente Politikash - Seria II, 2009)

SIGURIA NJERËZORE NË SHQIPËRI

Përgatitur nga Rrjeti i Menaxhimit të Sektorit të Sigurisë

Mbështetur nga DCAF dhe Divizioni i Diplomacisë Publike të NATO-s

Hyrje

Tëksa marrim në analizë dokumentet strategjike dhe reflektojmë mbi situatën aktuale të aspekteve të sigurisë në vend, mund të dalim në përfundimin se mbi të gjitha aspekti i sigurisë njerëzore është shumë pak i trajtuar si në strategjitë e sektorit të sigurisë ashtu edhe në dialogun publik. Kjo rrezikon të krijojë një hendek midis qytetarëve dhe vetë institucioneve shtetërore, duke marrë në konsideratë se pikërisht perceptimi i kërcënimeve të sigurisë njerëzore të publiku i gjerë është i lidhur ngushtë me sigurinë njerëzore duke i prekur ata në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ky “backgrounder” është konceptuar në formën e një përmbledhjeje ku do të paraqiten shtatë komponentët më të rëndësishëm të “Sigurisë Njerëzore” të aplikuar në vendin tonë duke shpalosur fillimisht teorizimin e tyre dhe duke e vënë më pas theksin në specifikat e secilit komponent me fokus identifikimin e elementëve më të spikatur që karakterizojnë sigurinë njerëzore Shqipëri.

1. Kuadri teorik i sigurisë njerëzore

(Enri Hide - Pedagog, Universiteti European i Tiranës, Mariola Qesaraku, Kërkuese tek Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim)

Përgjatë pjesës më të madhe të shekullit të njëzetë siguria konceptohej ekskluzivisht si siguri kombëtare dhe fokusohet

në probleme që buronin prej kërcënimit, përdorimit dhe kontrollit të fuqisë ushtarake në kontekstin e konkurrencës ndërkombëtare shtetocentrike.¹ Por pas Luftës së Ftohtë koncepti i interesit kombëtar pësoi një transformim të dukshëm, duke u zhvendosur nga përsiatja e sigurisë shtetërore drejt përsiatjes së sigurisë² dhe mirëqenies së individit. Prioriteti i analizës së konceptit të sigurisë gjatë kësaj periudhe u zhvendos drejt asaj që u emërtua *Siguri Njerëzore*.³ Siguria njerëzore luan rolin e një instrumenti konceptual që përpiqet t'i japë një përgjigje më të plotë në epokën bashkëkohore pyetjeve: “Çfarë do të thotë të jesh i sigurt? Po i pasigurt? Siguri nga se? Sa siguri?”, e kështu me radhë.

Megjithatë ideja se njerëzit duhet të jenë të sigurt në jetën e tyre të përditshme nuk është as e re dhe as e papritur. Ajo është shfaqur që në mesin e viteve '60, kur një grup shtetesh të pazhvilluara e përdorën atë si argument në favor të përsiatjes së interesave të tyre ekonomiko-sociale. Në fillim të viteve '90 siguria njerëzore si objekt analize mori trajtën e saj më të plotë, e pasqyruar në punimet e një grupi të gjerë studiuesish, të cilët nuk vinin tashmë vetëm nga fusha e marrëdhënieve ndërkombëtare, por edhe nga fusha të tjera, si ekonomia, mjedisi, shkencat ekzakte etj. Përkufizimi i parë i plotë i sigurisë njerëzore shfaqet në vitin 1994, kur Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në një deklaratë politike nën siglën e Kombeve të Bashkuara e përshkruan Sigurinë Njerëzore si: “... gjendje në të cilën individët lehtësohen nga traumat që rrethojnë zhvillimin njerëzor, ose ku këto trauma u mungojnë tërësisht” (UNDP 1994).

Së pari, siguria njerëzore nënkupton siguri nga kërcënime kronike si uria, sëmundjet dhe represioni. Së dyti, ajo nënkupton mbrojtje prej prishjeve të papritura e të dëmshme të modeleve të jetës së përditshme - si në shtëpi, punë ose në

¹ Dan Henk, “Human Security: Relevance and Implications”, *Parameters*, Summer 2005, p. 91-106.

² Shih Arnold Wolfers, “National Security as an Ambiguous Symbol”, *Political Science Quarterly*, Vol. 67, No. 4 (Dec. 1952) f. 482.

³ Shih G. King, K. Murray, “Rethinking Human Security”, *Political Science Quarterly*, Vol. 116, No. 4 (Winter 2001-2002), pp. 585-610.

komunitete (UNDP 1994: 23). Së treti, ajo nënkupton garantimin e sigurisë fizike nga dhuna, qoftë kjo e fundit shtetërore apo e ushtruar nga aktorë joshetërorë (si dhuna politike, kriminaliteti, vdekjet nga aksidentet apo madje edhe dhuna në familje). Raporti vazhdon duke pohuar se garantimi i sigurisë njerëzore kërkon një qasje të përshkallëzuar dhe të integruar për t'iu adresuar sigurisë ekonomike, të ushqimit, shëndetësisë, mjedisit, personale, komunitare dhe politike. Ky kuptim i sigurisë njerëzore kategorizohet si një prej përkufizimeve të gjera dhe përbën bazën e ndarjes mbi kuptimin e sigurisë njerëzore. Ai do të analizohet në seksionin pasardhës.

Koncepti i sigurisë njerëzore nxjerr në pah faktin se realizmi shtetocentrik nuk përbën më një argument të mjaftueshëm sigurie, sepse ai nuk i adresohet në mënyrën e duhur sigurisë së njerëzve brenda shteteve nga dhuna politike. Siguria njerëzore, të cilës shpeshherë në analizat akademike i është referuar si “siguri antropocentrike” ose si “siguri me fytyrë njerëzore”, fokusohet në lirinë nga frika dhe në lirinë nga varfëria të qenieve njerëzore⁴, duke iu larguar analizës në nivel shtetëror e duke u përqendruar në nivelin individual të analizës në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kështu, siguria lidhet tanimë më shumë me individin sesa me shtetin, duke e konfirmuar veten si prioritet dhe duke e orientuar analizën akademike drejt qëmtimeve humanocentrike të sigurisë në epokën e sotme. Por një artikulum i tillë do të ishte i paplotë nëse nuk do të përmendim se analiza e sigurisë njerëzore nuk bëhet në kurriz të sigurisë shtetërore, por si një shtesë përplotësuese e saj.

Siguria njerëzore si fushë studimi brenda marrëdhënieve ndërkombëtare ka nxjerrë në pah zgjerimin e konceptit të sigurisë, për të përfshirë brenda tij jo vetëm dimensionet ndërshtetërore e ndërkombëtare të sigurisë njerëzore, por edhe ato brendashtetërore. Paralelisht, zhvillimi i konceptit të sigurisë njerëzore nxjerr në pah edhe qasjen që konstaton rritjen dhe ndryshimin e kërcënimeve si ndaj njerëzve ashtu

⁴ Shih Thakur, R dhe Newman, E. (ed.) (2004), “*Broadening Asia's Security and Discourse Agenda*”, Tokyo: United Nations University Press, f. 347.

dhe ndaj entiteteve shtetërore. Këto ndryshime kanë megjulluar debatin rreth domethënies së sigurisë dhe argumenteve për zgjerimin dhe thellimin e tyre. Përveç dhunës brenda shtetit, ekzistojnë edhe kërcënime jo-ushtarake, si degradimi i mjedisit, pasojat e ngrohjes globale, epidemitë (si HIV/AIDS, SARS, gripi i shpendëve) apo lëvizjet masive të njerëzve (qofshin këta refugjatë, emigrantë apo individë të shpërngulur brenda shtetit).⁵ Edhe këto çështje transnacionale, njësoj si dhuna e brendshme, kanë efekte serioze lokale, rajonale dhe globale.

Ky kontekst konceptual është mjaft i vlefshëm e i dobishëm për të na pajisur me lentet e nevojshme analitike për të zbërthyer gjendjen aktuale të sigurisë njerëzore, jo vetëm në përgjithësi në rrafshin e marrëdhënieve ndërkombëtare, por edhe duke e projektuar atë më konkretisht në vendet në zhvillim dhe/ose tranzicion, njëra prej të cilave është Shqipëria. Problemet që lidhen me sigurinë njerëzore në vendin tonë prekin fusha të ndryshme si sigurinë ekonomike të kuptuar si garantimi i një të ardhure minimale individuale; sigurinë ushqimore, të kuptuar si garantimin e aksesit fizik dhe ekonomik në elementet bazë ushqimore të një cilësie të caktuar; sigurinë shëndetësore, të kuptuar si garantimin bazë të mbrojtjes nga sëmundjet dhe mënyrat e pashëndetshme të jetesës; sigurinë mjedisore, të kuptuar si mbrojtja afatshkurtër dhe afatgjatë e individëve nga shkatërrimet natyrore, kërcënimet që njeriu i bën natyrës dhe nga dëmtimi i mjedisit natyror; sigurinë individuale, të kuptuar si mbrojtja e individëve prej dhunës fizike, qoftë ajo nga vetë shteti apo nga shtete të tjerë, nga individë të dhunshëm dhe/ose aktorë joshitetërorë, nga abuzimet e ndryshme të brendshme, nga sulmet politike, etj.; sigurinë komunitare, e kuptuar si mbrojtja e individëve prej humbjes së marrëdhënieve e vlerave tradicionale dhe/ose si mbrojtja e tyre prej dhunës etnike dhe fetare; dhe sigurinë politike, e kuptuar si siguri i garancive që njerëzit “të jetojnë në një shoqëri që respekton të drejtat e tyre bazë njerëzore”.

⁵ Pauline Kerr, “Human Security”, në Allan Collins (ed.), “Contemporary Security Studies”, Oxford University Press, 2007, f. 93.

Pjesa e mbetur e studimit që vijon do të përqendrohet pikërisht në hulumtimin e këtyre dimensioneve apo fushave të sigurisë njerëzore, duke sqaruar paraprakisht angazhimin tonë konceptual në drejtim të shkollës së konceptimit të gjerë të sigurisë njerëzore.

2. Siguria individuale*

(Edlira Peço - Pedagoge në Universitetin e Tiranës)

(Ira Papagjika - Koordinatore Ligjore në Ministrinë e Brendshme)

Koncepti teorik: Çfarë është Siguria Personale?

Në ditët e sotme siguria individuale shihet në këndvështrimin e kushteve dhe faktorëve, qofshin këta fizikë apo emocionale që duhet të ekzistojnë për personin që ai vetë të ndihet i sigurt. Reagimi që individit ka ndaj kushteve jetësore që ai apo shoqëria ndërton për të, varet në një masë të madhe edhe nga niveli e frikës apo sigurisë që ai do të ketë për të jetuar. Liria për ta analizuar diçka të tillë ekziston te çdo individ, por mënyra se si ajo matet është shumë personale. Në fakt në vetvete, të qenit i sigurt nis me një qëndrim personal të individit që e pohon, dhe përfundon me nivelin e pranueshmërisë së bashkëbiseduesit të tij, duke marrë të mirëqenë faktin se të dy kanë të njëjtin koncept, vlerësim dhe interes për sigurinë. Në këtë kontekst William Blatz, pionieri i “teorisë individuale të sigurisë” hodhi themelet e të trajtuarit të sigurisë nga pikëpamja personale që në vitet ’60. Sipas tij, ideja e të pasurit rreth vetes kërcënime të ndryshme rrit rëndësinë, por edhe perceptimin

* Në analizat tona siguria individuale do të përzgjidhet në mënyrë të vetëdijshme për t’u përdorur si një koncept më i kufizuar brenda kornizës më të gjerë konceptuale të sigurisë njerëzore, për të nënkuptuar, sikurse përmendet në tekst: mbrojtjen e individëve prej dhunës fizike, qoftë ajo nga vetë shteti apo nga shtete të tjerë, nga individë të dhunshëm dhe/ose aktorë joshitetorë, nga abuzimet e ndryshme të brendshme, nga sulmet politike etj.

mbi sigurinë individuale⁶. Trajtesa e tij nis në mënyrë interesante me të qenit i sigurt që në vegjëli dhe ndryshimi i këtij koncepti së bashku me shumë mendësi të tjera ndërkohë që vetë individi rritet dhe i përshtatet shoqërisë në të cilën jeton, ndodh shumë natyrshëm.⁷ Teoria e Blatz është jo vetëm një themel i fortë, por edhe i qëndrueshëm në kohë. Siguria individuale sot më shumë se kurrë trajtohet si “*liria nga frika*”⁸.

Siguria personale në Shqipëri

Nëse sigurinë individuale do ta përkufizonim si, mbrojtje të individëve prej dhunës fizike, qoftë ajo nga vetë shteti apo nga shtete të tjerë, nga individë të dhunshëm dhe/ose aktorë joshitetërorë, nga abuzimet e ndryshme të brendshme, nga sulmet politike, etj., dhe do e projektonim atë në mjedisin sociopolitik shqiptar, atëherë çështja do të na rezultonte shumë konkrete, delikate dhe, në rastin më të mirë, e studiuar fare pak. Një studim i kryer në Shqipëri nga PNUD në vitin 2004⁹, arriti në përfundimin se siguria individuale është një çështje delikate dhe shumë konkrete për vendin tonë, ndonëse pak studiohet dhe analizohet. Kështu sipas shifrave të të njëjtit kërkim të paktën 14% e shqiptarëve nuk ndihen të sigurt në shtëpitë e tyre, ndërkohë që jo më pak se 20% e shqiptarëve në nivel kombëtar ndihen të pasigurt personalisht në rrugë. Atribuim i rrezikut në këtë rast përmendet trafiku, po aq sa edhe krimi dhe fakti i ndryshueshmërisë së menjëhershme të sjelljes së njerëzve si rezultat i faktorëve sociale, ekonomike, kulturorë, fetarë e politike gjatë viteve të tranzicionit. Krimi

⁶ Weissberg M, ‘Conceptualizing Human Security’ *International Security*, 26 No.2 (2001), fq. 6.

⁷ Ainsworth M., ‘On Security’, Department of Psychology Stony Brook University, 2007.

⁸ United Nations Development Program (UNDP), (1994) “New Dimensions of Human Security” (New York: Oxford University Press).

⁹ United Nations Development Program (UNDP) & Albanian Institute for International Studies (AIIS) (2004) “Early Warning Report Human Security in Albania”.

në vetvete duke përfshirë këtu konfliktet për pronën, gjakmarrja, vjedhjet, fyerjet, dhunimet etj., i bëjnë shqiptarët shumë të ndjeshëm ndaj atij koncepti që në shumë vende perëndimore ekziston si objekt studimi - “rreziku për jetën nga faktorë njerëzorë të jashtëm”. Ndërkohë që tejkaluam periudhat e rrezikut nga luftërat dhe destabiliteti politik në Ballkan, aktualisht ndodhemi nën presionin e një shoqërie në transformim në të cilën individët apo grupet e ndryshme të interesit mund edhe të jenë rrezik për sigurinë individuale në forma të drejtpërdrejta ose indirekte.

Një shembull i mirë që tregon hendekun që ekziston midis kërcënimit dhe masave për të luftuar këtë rrezik për sigurinë individuale është siguria në rrugë. Gjatë 15 viteve të fundit aksidentet automobilistike paraqiten në shifra alarmante në Shqipëri, por ndërkohë mungon një plan afatgjatë apo masa emergjente për të luftuar këtë fenomen. Sipas Institutit Shqiptar të Statistikave (ISSH), nga vitin 1995 deri në vitin 2007, kanë ndodhur 7410 aksidente, të cilat kanë lënë pas plot 10559 viktima nga të cilët 3875 kanë rezultuar fatale për jetën.¹⁰ Duke analizuar statistikën vit pas viti, vihet re qartë një tendencë në rritje e numrit të aksidenteve në Shqipëri. Pavarësisht këtyre shifrave tragjike në rritje, siguria rrugore ende nuk është përfshirë në hartën e prioritetëve të kërcënimeve kombëtare të njohura nga institucionet Shqiptare.

E njëjta gjë mund të pretendohet edhe për kurbën e kriminalitetit dhe krimin kundër personit. Në një periudhë prej viti 1993 deri në vitin 2001 kanë ndodhur 55855 krime nga të cilat 4085 rezultuan fatale për jetën e njeriut në një numër total prej 10700 krime kundër personit. Megjithatë, këto shifra pretendohet që të jenë edhe më të larta duke marrë parasysh faktin se shumë krime nuk raportohen e denoncohen. Analiza e këtyre të dhënave na tregon se numri i krimeve është rritur në kategori të ndryshme, ndërkohë që perceptimet e njerëzve tregojnë se individit ndihet gjithmonë e më i pasigurt.

Në këto kushte, koncepti i dhunës përbën emëruesin e të gjithë faktorëve që mund të diskutohen në frikën që shoqëron

¹⁰ INSTAT. Road traffic accidents, www.instat.com.al.

individët e pasigurt në Shqipëri. Dhuna politike, ekonomike, sociale, psikologjike, fizike, seksuale etj, ndonëse në parametra të ndryshëm, është e pranishme dhe gjithmonë shoqëruese e ndjenjës së frikës, e pasojës së pasigurisë që pashmangshmërisht çon në sjellje antikonformiste për komunitetin, izolon individin, rrjedhimisht mbyll rrugët e mundshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me sigurinë, për aq kohë sa vetë individi refuzon të marrë pjesë në një proces të tillë. Pritshmëritë, pa dyshim si në çdo teori politike apo të një natyre sociale, i adresohen shtetit, i cili mbi të gjitha ka në dorë të ruajë qytetarin në vende publike, të përjashtojë rrezikun dhe kërcënimin nga dhuna ndaj tij duke siguruar në mënyrë dydimensionale sigurinë njerëzore/ personale dhe suksesin e drejtësisë që ofron ligji dhe rregulli që ai vendos.

Të qenit i pasigurt personalisht nuk nënkupton në mënyrë të domosdoshme prezencën apo pjesëmarrjen në një akt dhune, kërcënimi, persekutimi apo diskriminimi. Nuk ka të bëjë, pra, me të provuarin e një eksperience të tillë për të vlerësuar pasigurinë. Në fakt pjesa më e madhe e personave që nuk ndihen të sigurt personalisht në Shqipëri shumë rrallë ose asnjëherë nuk kanë qenë subjekt i kërcënimit, diskriminimit persekutimit apo më tej akoma ushtrimit të dhunës. Prandaj së pari siguria personale është një çështje e faktorëve kualitativë; ndjenja dhe perceptime, duke e bërë Shqipërinë një vend me probleme serioze në kuadër të sigurisë humane pavarësisht faktit se në dokumentet strategjike nuk i kushtohet vëmendje e madhe.¹¹ Por për aq kohë sa siguria personale është një ndjenjë vetjake, e ka të bëjë me një arsyetim personal, gjithsecili vlerëson shkallën e mirëqenies së tij nga pikëpamja e sigurisë duke konsideruar shtetin apo ndonjë forcë tjetër reale apo virtuale, në varësi të besimit apo qëndrimit që mban, si katalizator që lehtëson e më idealisht ende siguron qenien e këtij individi si “i sigurt”.

¹¹ “Human Security in Albania”, Early Warning Report, UNDP-AIIS, April 2004.

Si rrjedhojë, sot mbetet të diskutojmë më shumë sesa konceptin e të qenit i sigurt, atë të “efektivitetit të sigurisë personale” dhe të debatojmë në lidhje me aktorët kryesorë që ndikojnë në përmirësimin e tij. Shteti vazhdon të mbetet aktori kryesor që duhet të vendosë një rend të sigurt social e politik, ku qytetarët të ndiejnë se po ju respektohen të drejtat e tyre themelore, ku nuk kanë frikë të jetojnë, por edhe ku ju duhet të vlerësojnë se kjo siguri që shteti ofron/siguron është funksionale. Në mënyrë të padiskutueshme shoqëria civile mbetet aktori që monitoron, dhe ndërgjegjëson komunitetin, grupet, individin në lidhje me këtë siguri. Mirëpo informacioni që rrjedh në të mirë të palës siguruese (shtetit), asaj ndërmjetësuese (shoqërisë civile) dhe asaj përfituese (njeriut/shtetasit) në Shqipëri mbetet media, sidoqoftë palë e shoqërisë civile, por e identifikuar rishtas si pushtet vlerësues - jo gjithmonë katërcipërisht objektiv. Vlen për t’u theksuar se media mund të jetë burimi kryesor i informacionit për dhunën që na rrethon duke pasur ndikim të drejtpërdrejtë në perceptimin e njerëzve dhe duke i shkakuar atyre (pa)siguri. Por në rastin e Shqipërisë mund të vëmë re edhe një tendencë tolerance të institucioneve shtetërore përgjegjëse për të pranuar shifrat alarmante të kriminalitetit, dhunës, aksidenteve etj. madje duke i shmangur nga agjenda e kërcënimeve reale të sigurisë.

Ndoshta ka ardhur koha që vetë individi, ndërkohë që deklaron nëse ndihet/është i sigurt apo i pasigurt personalisht, duhet të vlerësojë mundësinë për gjetjen e një pike ekuilibri në balancën midis çlirimit nga frika (diçka emocionale) dhe faktorëve fizike dhe politikë që ndihmojnë në eliminimin e gjendjes së pasigurisë (diçka materiale) e më pas të gjenerojë informacionin në kohë (ndër breza) në hapësirë (brenda dhe jashtë kufijve) për sigurinë në Shqipëri dhe të qenit i sigurt si shqiptar.

3. Siguria Ekonomike

(Evis Gjebrea - Pedagoge në Universitetin European, Tiranë, Llukan Tako - Studiues)

Koncepti teorik: Çfarë është siguria ekonomike?

“Siguria ekonomike” është një shprehje gjithnjë e më e përdorur, por edhe një koncept i teorizuar relativisht pak në literaturën e ekonomisë politike. Në përgjithësi ekzistojnë dy ligjërata tepër të ndara për sigurinë ekonomike: analizat mikronivelo, të cilat përqendrohen në agjentët e “lokalizuar”, si individët, vatrën familjare dhe komunitetet lokale, të cilët interesohen kryesisht për garantimin e sigurisë së jetesës së tyre (shih Liew 2000; Zalewski 2005) (në studimet mbi vendet në zhvillim kjo përqendrohet shpeshherë në çështjet e sigurisë së ushqimit); si dhe siguria ekonomike makronivelo, e cila tenton të fokusohet në kombet-shtete (ose në entitete të tjerë të aftë të drejtojnë një politikë të jashtme ekonomike) dhe në angazhimet e tyre në sistemin ekonomik ndërkombëtar. Parë nën këtë qasje dynivelo është e mundur të artikulojnë dy përkufizime të sigurisë ekonomike, të cilat, ndonëse të veçanta për nga natyra e sigurisë që përsiatin, ndërliken pazgjidhshmërisht në epokën aktuale globale që po jetojmë.¹²

Në aspektin makroekonomik, sipas një përkufizimi mjaft të plotë shkencor, me siguri ekonomike kuptohet “*ruajtja e integritetit strukturor, e kapaciteteve prosperitet-prodhuese dhe e interesave të një entiteti politiko-ekonomik në kontekstin e rreziqeve*

¹² Për më tepër mbi sigurinë ekonomike në epokën globale shih: Kahler, M. (2004), “Economic Security in an Era of Globalisation: Definition and Provision”, *Pacific Review*, Vol. 17(4), 485-502. Ky artikull shqyrton në mënyrë kritike sigurinë ekonomike në ekonominë e sotme globalizuese. Ndërmjet të tjerave, ai vë në pikëpyetje identifikimin e çështjeve të sigurisë ekonomike si ekskluzivisht kombëtare në një epokë globalizmi dhe për më tepër paralajmëron kundër konceptimit se globalizmi sjell vetëm pasiguri më të madhe ekonomike për shtetet-kombe dhe rajonet e ndryshme.

*dhe kanosjeve të ndryshme të jashtme e të brendshme me të cilat ai përballet në sistemin ekonomik kombëtar e ndërkombëtar*¹³.

Në nivelin mikro, siguria ekonomike nënkupton garantimin e të ardhurave të qëndrueshme dhe të burimeve të tjera për të mbështetur një standard të kënaqshëm të jetesës në të tashmen dhe në të ardhmen. Në këtë nivel siguria ekonomike do të mund të përkufizohet qartazi si garantimi i vazhdimësisë së të ardhurave, qëndrueshmëria e tyre dhe garantimi i punësimit. Por në nivelin e sigurisë ekonomike që do të analizohet këtu, si një prej komponentëve kyçë bashkëkohorë të konceptit më të gjerë të sigurisë njerëzore, do të fokusohemi metodologjikisht në nivelin e dytë, natyrisht pa i harruar e mënjeluar aspak aspektet e sigurisë ekonomike “tradicionale”, sikurse përkufizohet më lart”. Ndërkaq më poshtë do të paraqesim të dhënat mbi tre aspektet e përkufizimit nivelit mikro të sipërpërmendur në një përpjekje me natyrë të dyfishtë, e cila nga njëra anë ka për qëllim të na sjellë analizën teorike të sigurisë ekonomike në një kontekst më të prekshëm real dhe, nga ana tjetër, të shpalosë një panoramë të përmbledhur të statusit të sigurisë ekonomike të Shqipërisë dhe popullsisë së saj.

Siguria ekonomike në Shqipëri

Parë nga një këndvështrim gjeografik Shqipëria, një ekonomi tregu relativisht e re që në shumë aspekte të saj vazhdon të mbetet në tranzicion duke mos përmbushur një prej kriterëve më kyçë të sigurisë ekonomike shtetërore e individuale të përkufizuar më lart, ndodhet pranë një superfuqie globale ekonomike, e tillë si Bashkimi Evropian. Kjo bën që vendi ynë të shfaqë tipare mjaft tërheqëse për shfrytëzimin e shumë faktorëve gjeoekonomikë dhe gjeoenergjetikë, ndër të cilët mund të radhiten: afërsia me tregjet evropiane të stabilizuara dhe të zhvilluara; vendndodhja e favorshme në

¹³ Shih Christopher M. Dent, “*Economic Security*”, në Allan Collins (ed.), “*Contemporary Security Studies*”, Oxford University Press, 2007, f. 256.

korridoret transite kryesore ekonomike dhe energjetike (ku mund të përmenden rrugëkalimet strategjike dhe projektet për naftësjellës apo gazsjellës që mund të kalojnë nëpër vendin tonë); si dhe aksesit i mundshëm në koleksionin e rëndësishëm të praktikave më të mira të ekonomive të zhvilluara. Në të vërtetë mund të themi që nga fillimi i viteve '90 se janë bërë hapa pozitivë kur largimi nga një sistem i mbyllur e i centralizuar solli një ekonomi tregu liberale.

Ndërkohë që në nivelin makro të sigurisë ekonomike duket se janë kaluar problemet më thelbësore strukturore të kapaciteteve prosperitet-prodhuese të vendit tonë dhe është arritur gjatë viteve të fundit, sidomos pas 1999, një rritje reale e ekonomisë me hapa të dukshëm, çka përbën një lloj tërheqjeje në një treg global mjaft konkurrues, mund të artikulohet pa mëdyshje qëndrimi se në aspektin mikro Shqipëria ka ende shumë për të bërë, sikurse do dalë në pah nga të dhënat empirike të poshtëpërmendura.

Kështu, gjatë 10 viteve të fundit papunësia në Shqipëri është ulur nga 18.4% në vitin 1999 në 12.7% në vitin 2008¹⁴. Kjo i atribuohet rritjes ekonomike, e cila ka qenë e qëndrueshme (në rreth 6-7% në vit). Papunësia është më e lartë në pjesën veriore të Shqipërisë 23.2%, e cila është edhe zona më e varfër e vendit. Njëkohësisht është ulur edhe niveli i varfërisë jo domosdoshmërisht si rezultat i uljes së papunësisë, por për shkak të dërgimit të remitançave nga emigrantët, të cilat përbëjnë një pjesë të mirë të ardhurash për plotësimin e nevojave të familjeve shqiptare. Megjithatë ecuria e papunësisë ka qenë pozitive, ajo mbetet e lartë krahasuar me normën e papunësisë së Evropës Qendrore dhe Juglindore, e cila është 8.8%¹⁵ dhe sot për sot ka një debat ndërmjet aktorëve të ndryshëm (si shoqëria civile, akademike, forcat politike etj.) se norma e papunësisë mund të jetë më e lartë pasi jo çdo i papunë deklarohet si punëkërkues. Kjo situatë mund të shkaktojë një

¹⁴ Ministria e Financës, indikatorët makroekonomikë, www.minfin.gov.al

¹⁵ International Labor Organization (ILO), Global Employment Trends, January 2009, http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/-dgreports/-dcomm/documents/publication/wcms_101461.pdf

fenomen tjetër negativ si është informaliteti në tregun e punës. Sipas të dhënave zyrtare, norma e papunësisë informale në tregun e punës është në nivelin 42%, ndërsa për të rinjtë e punësuar është po aq i lartë: 70%¹⁶.

Nëse Shqipëria aspiron për rritje të qëndrueshme ekonomike do t'i duhet të adoptojë politika që inkurajojnë tranzicionin nga rritja ekonomike të zhvillimi ekonomik, i cili është garancia për qëndrueshmërinë dhe rritjen e sigurisë ekonomike. Me fjalë të tjera, qeveria duhet të sigurohet që nuk e bën të pasurin më të pasur, apo të varfrin më të varfër, por të varfrin më të pasur. Që kjo të ndodhë qeveria duhet të inkurajojë prodhimin e brendshëm nëpërmjet modernizmit të sektorit bujqësor dhe industrive prodhuese, të cilat përfitojnë jo vetëm të papunin nëpërmjet vendeve të reja të krijuara, por ekonominë në tërësi.

Raporti i të papunëve kundrejt të punësuarve

Një tjetër aspekt i sigurisë ekonomike të një shteti është niveli i papunësisë dhe raporti midis të papunëve dhe të punësuarve. Ai prek integritetin strukturor të ekonomisë dhe shoqërisë së një kombi, kapacitetet prosperitet-prodhuese të tij, konkurrueshmërinë në tregjet rajonale e globale, si dhe sigurinë ushqimore, sociale e individuale të qytetarëve të një shteti. Për sa i përket popullsisë Shqipëria ka një avantazh konkurrues ndaj fqinjëve të saj pasi ka një moshë mjaft të re mesatare të popullsisë. Në vitin 2005 të rinjtë shqiptarë të moshës 15-24 vjeç përbënin 43.7% të forcës së punës. Norma e pjesëmarrjes (që ndryshon sipas moshës e gjinisë) së adoleshentëve (15 deri në 19 vjeç) ishte 32.8% kurse e të rinjve (të moshës 20-24 vjeç) ishte 59.7%¹⁷. Norma e punësimit ndryshon sipas sektorëve ku më e larta mbetet në sektorin bujqësor; kjo mund të shpjegohet me faktin se ky sektor absorbon shpejt format e punësimit informal, kërkon pak

¹⁷ Milva, Filipi, Gjergji, Sfidat e të rinjve shqiptarë drejt punësimit, Instituti Agenda, mars 2008.

kualifikim për ata të rinj me nivel të ulët arsimimi. Në të njëjtën kohë, norma e të punësuarve në sektorin publik është ulur nga 33% në vitin 1995 në 15% në vitin 2008¹⁸ për shkak të disa privatizimeve të ndërmarrjeve shtetërore. Nëse këtyre të dhënave do t'u shtohet edhe deficieti mjaft i lartë tregtar i vendit tonë mund të argumentohet se problemet kryesore të sigurisë ekonomike të Shqipërisë dhe qytetarëve të saj prekin *paradigmën socio-ekonomike të sigurisë dhe atë të garantimit të kapaciteteve teknoindustriale*.¹⁹

Por cilat do të ishin disa nga kërcënimet që vijnë nga papunësia për sigurinë ekonomike të individëve dhe, për rrjedhojë, për sigurinë ekonomike strukturore të shtetit? Ndër to mund të radhiten: një mundësi e humbur për zhvillimin ekonomik; mosshfrytëzimi i potencialit social e ekonomik të vendit; avantazh krahasues i papërdorur si rezultat i krahut të lirë të punës; rritja e numrit të individëve që i drejtohen punësimit informal; rritja e ritmit të emigracionit dhe humbja e krahut të punës; rritja e mundësive që të papunët të përfshihen në aktivitete kriminale, si vjedhjet, drogat, trafikimi ilegal etj.

Në përsiatje të rritjes së sigurisë ekonomike individuale si dhe të kapaciteteve prosperitet-prodhuese shteti shqiptar ka ndërmarrë gjatë viteve të fundit një sërë masash, të cilat janë shpalosur në Strategjinë e Punësimit 2007-2013 të qeverisë shqiptare, si:

- Riintegrimi i emigrantëve në tregun vendas të punës, të cilët mund të ndajnë eksperiencën e fituar jashtë vendit nëpërmjet uljes së përkohshme të taksave për bizneset e tyre.
- Fuqizimi i agjencive qeveritare të punësimit dhe zhvillimi i partneriteteve me agjencitë private të punësimit.
- Zhvillimi i partneriteteve me aktorët e tjerë në tregun e punës të tilla si bizneset, universitetet, institutet e kërkimit dhe donatore te ndryshëm.

¹⁸ Ministria e Punës, çështjeve sociale dhe shanseve të barabarta, Strategjia e Punësimit 2007-2013.

¹⁹ Shih, Christopher Dent, "Economic Security", në Allan Collins (ed.), "Contemporary Security Studies", Oxford University Press, 2007, ff. 204-220.

- Zhvillimi i arsimimit profesional që ka humbur rëndësinë gjatë viteve të fundit (ka një perceptim të përgjithshëm se disa profesione teknike kanë humbur).
- Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përkatëse për sa i përket tregut informal të punës.

Niveli i të ardhurave

Pavarësisht vështirësive të fillimit, inflacioni u zbut ndjeshëm, në një kohë që kreditimi i hapi rrugën lulëzimit të mijëra bizneseve private dhe ndërkohë varfëria është ulur me 50% në 5 vitet e fundit. Megjithatë, shumica e të dhënave tregojnë se Shqipëria ende ka një rrugë të gjatë për të bërë jo vetëm për të arritur vendet evropiane më të zhvilluara, por edhe me fqinjët e saj në rajon. Pavarësisht një rritjeje pozitive të GDP-së, Shqipëria mbetet ende vendi i dytë më i varfër në Evropë, ku një pjesë e madhe e popullsisë është detyruar të emigrojë dhe ata që kanë zgjedhur të qëndrojnë, mbeten shumë të varur në të ardhurat që dërgojnë emigrantët. Llogaritet që 27.5% e popullsisë jetojnë jashtë vendit duke siguruar më shumë se 15% të GDP-së së Shqipërisë në 10 vitet e fundit. Në raportin vjetor të Bankës Botërore të vitit 2006 deklarohet se pa këto të ardhura shqiptarët do të jetonin me më pak se 2\$ në ditë. Megjithatë gjatë viteve të fundit, si pasojë e krizës ekonomike globale, e cila nxjerr në pah ndërvarësinë strukturore të ekonomive të vendeve të zhvilluara dhe varësinë për nga pikëpamja e sigurisë ekonomike makro-niveloze të vendeve në zhvillim, dërgesat e parave nga emigracioni janë ulur duke shkaktuar probleme sidomos në zonat rurale ku këto të ardhura janë burimi kryesor me 40% të të ardhurave totale, çka mund të cenojë një sërë komponentësh të sigurisë ekonomike. Për më tepër pjesa më e madhe e këtyre të ardhurave (70%) për pjesën e parë të vitit 2008 u përdor për qëllime jo-produktive. Rreth 48% u përdor për konsumim, 16% për ndërtim dhe 10% për edukim.

Siguria e të ardhurave dhe standardi i jetesës

Në vitet e fundit mund të identifikojmë një reduktim të ndjeshëm të varfërisë kjo e pasqyruar edhe në rritjen e GDP-së vjetore me 7.1% dhe rritjen e pensioneve dhe rrogave. Si rrjedhojë ajo kategori e popullsisë që jeton nën minimumin jetik (4891 lekë) është ulur nga 25.4% në vitin 2005 në 12.4% në 2008. Megjithatë ende në Shqipëri llogariten të jenë rreth 370000 njerëz.

Sistemi i sigurisë sociale gjithashtu vuan ngërçet e tranzicionit dhe keqmenaxhimit dhe është në kërkim të reformave të thella, disa prej të cilave edhe pse janë ndërmarrë duke iu referuar Ministrit të Financave, pritet të japin frute 50 vjet më vonë²⁰. Pavarësisht arritjeve gjatë viteve të fundit si rritja e pensioneve dhe riorganizimit të marrjes së pensioneve kuptojmë se sistemi i pensioneve vuan nga kontributet e ulëta, papunësia substanciale e rritje të përfitimeve²¹ duke e bërë më pak të sigurt të ardhmen e qytetarëve në moshë madhore.

4. Siguria Ushqimore

(Nga Geron Kamberi - Studiues i Asociuar pranë IDN-së)

Koncepti teorik: çfarë është siguria ushqimore?

Përkufizimi i konceptit të sigurisë ushqimore lidhet me një “situatë në të cilën njerëzit në çdo periudhë, duhet të kenë mundësi dhe hapësirën e nevojshme fizike, sociale e ekonomike që të marrin ushqim të mjaftueshëm e të sigurt, në mënyrë

²⁰ “Surpriza fiskale e Bodes: Do u kthejmë taksat qytetarëve, si në sistemin amerikan”, Gazeta Panorama, May 30th 2009.

²¹ Albanian Pension System, Regional Seminar on Pension, Zagreb, 9-10 March 2009, www.coe.int/t/dg3/sscsr/Source/PensionSemZag/Pres_Alb.ppt -

që të plotësojnë nevojat e tyre dietike dhe parapëlqimet ushqimore për një jetë aktive dhe të shëndetshme”.²² Ky përkufizim nxjerr në pah dy dimensione thelbësore të sigurisë ushqimore: *disponueshmërinë e ushqimit*, cila nënkupton disponueshmërinë e sasive të mjaftueshme të një ushqimi me cilësinë e duhur, i garantuar e furnizuar përmes prodhimit të brendshëm ose importeve (përfshirë ndihmat e ndryshme ushqimore); si dhe *aksesin në ushqim*, që nënkupton aksesin nga individët në resurse të përshtatshme për të përfutur ushqimet e duhura për një dietë të shëndetshme. Sipas këtij përkufizimi që përbën një prej elementëve kyçë të sigurisë njerëzore, *siguria ushqimore familjare* nënkupton aplikimin e këtij koncepti në situata të nivelit familjar që përqendrohen në garantimin e ushqimit për anëtarët e një familjeje. Nga ana tjetër, *pasiguria ushqimore* mund të përshkruhet si gjendja ku njerëzit nuk kanë akses të mjaftueshëm fizik, ekonomik ose social në ushqim, sikurse u përkufizua më lart. Ndërkohë kjo e drejtë përfshin edhe garantimin e nevojave bazë ushqimore për çdo njeri, përqindjen që zë në buxhetin familjar konsumi për ushqim, cilësinë e tij të ushqyerit si edhe si edhe sigurinë e ushqimit gjatë katastrofave njerëzore dhe natyrore. Duke u nisur nga përkufizimet e përgjithshme, të cilat karakterizojnë konceptin e sigurisë ushqimore, në rrethanat e realitetit të sotëm shqiptar ajo reflektohet në një strukturë me tre shtylla kryesore që u përgjigjen njëkohësisht tre kategorive të caktuara të shoqërisë:

1) Për njerëzit nën nivelin e varfërisë, siguria ushqimore shndërrohet në një proces që kërcënon ekzistencën e tyre. Në këtë grup përfshihen edhe komunitetet e rrezikuara veçanërisht në zonat malore të vendit, të cilat gjatë periudhës së dimrit ndodhen shpesh para emergjencave ushqimore.

2) Për njerëzit me të ardhura të ulëta shtrohet problemi i garantimit të dietës bazë ushqimore (shporta), e cila është sidomos e rëndësishme te fëmijët.

3) Për njerëzit me të ardhura mbi mesataren problemi kryesor mbetet cilësia dhe siguria ushqimore që gjenden në treg.

²² Deklarata e World Food Summit, 1996.

Në varësi të këtyre kategorive edhe reagimet e njerëzve ndaj problemit të sigurisë ushqimore janë të ndërlidhura mes tyre. Opinioni i përgjithshëm mbizotërues në vend tashmë sigurinë ushqimore e sheh të lidhur ngushtë me cilësinë si dhe me larminë e strukturës ushqimore, e cila ndikon drejtpërdrejt në mbarëvajtjen e sigurisë njerëzore në raport me sëmundjet apo problemet që burojnë prej saj.

Siguria ushqimore në Shqipërinë e tranzicionit

Megjithëse pas viteve '90, GDP-ja në vend është rritur në mënyrë të qëndrueshme në Shqipëri, varfëria ende prek një pjesë të konsiderueshme të popullsisë, veçanërisht në zonat rurale dhe në ato që janë urbanizuar rishtas. Në këtë mënyrë ka probleme të sigurimit në sasi e cilësi të ushqimit të shëndetshëm.

Që prej fillimit të tranzicionit në vitet '90, Shqipëria doli me një krizë të sigurisë ushqimore, e cila u shkaktua nga ulja e produktivitetit bujqësor për shkak të mbikolektivizimit të tokave bujqësore dhe mungesës së ushqimeve bazë në tregun vendas. Si rrjedhojë e privatizimit të tregtisë dhe tokës bujqësore, siguria ushqimore filloi të përmirësohej nga viti në vit dhe furnizimi i rregullt me ushqime u përmirësua në mënyrë të ndjeshme, veçanërisht me nënprodukte të qumështit, vezë, fruta dhe perime. Në nivel kombëtar dieta ushqimore që siguronte plotësimin e nevojave bazë kalorike të popullsisë në përgjithësi u realizua dhe nivelet e kequshqyerjes dhe mosushqyerjes u ulën.

Megjithatë në këtë periudhë filloi një varësi e madhe e Shqipërisë nga produktet ushqimore të importuara, veçanërisht drithërat dhe ato të përpunuara, të cilat lidhen më pas me sigurinë dhe garancinë ushqimore që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë njerëzore. Në mënyrë të veçantë problem paraqet ende kequshqyerja e fëmijëve të vegjël brenda familjeve me të ardhura të pakta, e cila shpesh shoqërohet me rritjen e vdekshmërisë foshnjore në zona të caktuara të vendit. Kjo pasqyrohet edhe në gjendjen jo të mirë si dhe të cilësisë e

sasisë së ushqimit që ndeshet në institucionet publike e jopublike të arsimit parashkollor në vend, e cila në disa raste është përkeqësuar në raport me cilësinë dhe garancinë e ushqimit.

Në vitin 2000 rreth 1/3 e fëmijëve nën moshën 5 vjeç ishin të pazhvilluar për shkak të kequshqyerjes dhe 1 në 10 fëmijë ishte me probleme. Në të njëjtën kohë popullsia shqiptare pas viteve '90 po përjeton edhe një periudhë tranzicioni të ushqyerit, ku po vërehen shenja të mbipeshës dhe obezitetit veçanërisht në zonat e kryeqytetit e qytetet e mëdha. Kjo si rrjedhojë e cilësisë së dobët të produkteve ushqimore e sidomos të shtimit të atyre me prejardhje “gjenetiksht të modifikuar” (OMGJ) në tregun lokal.

Ndërkohë një fenomen tjetër që lidhet me sigurinë ushqimore në raport me të drejtën për një ushqim të sigurt e të shëndetshëm është edhe çrregullimi i mungesës së jodit te fëmijët veçanërisht në zonat malore që përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të vendit. Sipas të dhënave më pak 50% e familjeve fshatare konsumojnë kripë të jodizuar. Megjithëse nuk ka të dhëna plotësisht të sakta mbi mungesën e vitaminës A te këto kategori është më se e qartë se ajo është tejet e përhapur për shkak të një diete ushqimore në fshat që përqendrohet kryesisht te produktet blegtorale dhe vezët. Të dhënat e kufizuara mbi mungesën e hekurit te kategori të caktuara të popullsinë në këto zona, veçanërisht te fëmijët, për shkak të mangësive që vijnë prej ushqimit, tregojnë se ky mbetet një problem i madh shqetësues.

Siguria ushqimore në Shqipëri ka qenë shpesh e kërcënuar jo aq për shkak të pamundësive të burimeve natyrore për të përmbushur nevojat e vendit, por si rrjedhojë e keq-administrimit apo edhe krizave politike, të cilat kanë çuar shpesh deri në emergjencë ushqimore. Një ndër këta tregues është edhe rikthimi në vend që prej trazirave të vitit 1997 e deri më 17 shkurt 2006, të Programit Botëror të Ushqimit (WFP) i cili ofroi ndihmën e tij prej afro 68 milionë USD në asistencë ushqimore kryesisht në zonat e varfra të vendit dhe veçanërisht te familjet me të ardhura të pakta qoftë në zonat rurale apo urbane.

Një ndër aspektet e më të rëndësishme që lidhet me konceptin e një bujqësie të qëndrueshme, është perspektiva e sigurisë ushqimore, e cila nga ana e saj kërkon një

prodhueshmëri bujqësore aktive dhe në rritje.²³ Në këtë mënyrë është me rëndësi ristrukturimi i fermës bujqësore shqiptare, e cila duhet të riorganizohet për t'i vendosur fermerët në kushte më produktive duke siguruar në këtë mënyrë një nivel të caktuar të sigurisë ushqimore. Në këtë kuadër një politikë për bashkimin e tokave bujqësore në njësi më të mëdha prodhimi ("*land merging policy*") do të mbështeste një sistem më të qëndrueshëm bujqësor në Shqipëri ashtu si edhe më shumë garanci për sigurinë ushqimore që varet nga burimet e brendshme.²⁴

Detyrimet e Shqipërisë në fushën e sigurisë ushqimore kanë qenë të pranishme prej kohësh edhe falë qenies si vend anëtar i OKB-së, e cila nëpërmjet agjencive të saj të specializuara i ka kushtuar dhe vazhdon t'i kushtojë një vëmendje të veçantë këtij procesi. FAO (Organizata Botërore për Bujqësinë dhe Ushqimin), i është përkushtuar së fundmi "qasjes së zinxhirit të ushqimit" (*food chain approach*) lidhur me menaxhimin e sigurisë dhe cilësisë ushqimore në raport me përgjegjësitë e të gjithë aktorëve në këtë zinxhir. Shërbimi i FAO-s për Cilësinë dhe Standardet e Ushqimit ka përcaktuar rregulla të shumta për vendet anëtare ku bën pjesë edhe Shqipëria, ndaj forcimit të sigurisë dhe cilësisë së ushqimit përgjatë zinxhirit ushqimor në të gjitha nivelet. Kjo qasje synon parandalimin e sëmundjeve që lindin nga ushqimet, mbrojtjen e konsumatorit dhe nxitjen e praktikave të drejta në tregtinë e ushqimeve.

Përgjegjësia dhe detyrimet e Shqipërisë ndaj sigurisë ushqimore, përveç detyrimeve që burojnë nga qenia si vend anëtar i OKB-së, përforcohet në një shkallë edhe më të fortë në raport me BE-në, përmes hyrjes në fuqi që nga 1 prilli 2009 të

²³ Në vijim të përmbushjes së këtij detyrimi janë miratuar edhe Ligji Nr. 9817, datë 22.10.2007 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural" (Fletore Zyrtare Nr. 148, Viti 2007, fq. 4355) dhe VKM Nr. 774, datë 14.11.2007 "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Shqiptare për Zhvillimin Rural (2007-2013) (Fletore Zyrtare Nr. 163, Viti 2007, fq. 4815).

²⁴ Këtu mund të përmendim detyrimet që rrjedhin për sigurinë ushqimore nga VKM Nr. 924, datë 14.11.2007 "Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të Bujqësisë dhe Ushqimit 2007-2013" (Fletore Zyrtare Nr. 192, viti 2007, fq. 6149).

MSA-së.²⁵ Në këtë marrëveshje siguria ushqimore përcaktohet si një detyrim që duhet të përputhet me njësimin e standardeve dhe kriterëve teknike minimale me ato të BE-së. Në rrugën e saj drejt integritimit evropian, Shqipëria duhet të vendosë rregulla, po aq shtrënguese sa edhe BE-ja, në garantimin e sigurisë ushqimore. Kjo qasje e re synon mbikëqyrjen e kujdesshme të ushqimit për njerëz dhe kafshë sipas parimit nga “*stalla te tavolina*” në të gjithë fazat e prodhimit, përpunimit, ruajtjes, transportimit dhe tregtimit deri në konsumimin e tyre. Në këtë mënyrë autoritetet shqiptare duhet të përballen me sfidën e ngritjes së strukturave efektive që vlerësojnë rrezikun e ndotjes apo infektimit të produkteve ushqimore vendase dhe atyre të importit dhe për të kryer këtë detyrë ato duhet të kenë bashkëpunimin e plotë të fermerëve, tregtarëve, konsumatorit etj.²⁶

Siguria ushqimore në këtë rast nënkupton prodhimin e produkteve ushqimore të ndryshme të shumëllojshme, bazuar në cilësinë e kriteret teknike të sigurisë të përcaktuara në Ligjin Nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin”²⁷. Një nga ndryshimet kryesore që kanë ndodhur në konceptin e sigurisë ushqimore është mbrojtja e mjedisit dhe mbështetja e fermerëve në prodhimin e produkteve organike.

Përkundër faktit se Shqipëria është ende një vend në zhvillim, siguria ushqimore në vend tashmë përballlet me një

²⁵ Këto elementë përcaktohen qartë edhe në Ligjin Nr. 9590, datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizimi-Asocimit (MSA) mes RSH e Komunitetit Europian e shteteve të tij anëtare (Fletore Zyrtare Nr. 87, viti 2006, fq. 2955); Ligji Nr. 9591, datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Përkohshme mes RSH e Komunitetit Europian për tregtinë e bashkëpunimin tregtar (Fletore Zyrtare Nr. 89, viti 2006, fq. 3249), fq. 2955) ashtu si edhe në VKM Nr. 463, datë 05.07.2006 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit” (Fletore Zyrtare Nr. 80, viti 2006, fq. 2307).

²⁶ VKM Nr 797, datë 14.11.2007 “Për miratimin e Strategjisë ndërsektoriale për mbrojtjen e konsumatorit e mbikëqyrjen e tregut 2007-2013 “Fletore Zyrtare Nr. 171, Viti 2007, faqe 5205) dhe Ligji Nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” (Fletore Zyrtare Nr. 61, Viti 2008, Faqe 2703).

²⁷ Ligji Nr. 9863, datë 28.02.2008 “Për ushqimin” (Fletore Zyrtare Nr. 17, Viti 2008, faqe 581).

qasje të dyfishtë. Nga njëra anë garantimi i nevojave bazë ushqimore për shtresat në nevojë dhe të varfra si edhe nga ana tjetër përgatitja për të funksionuar si një treg i përbashkët me BE-në, ku merr përparësi jo vetëm sasia e llojshmëria e prodhimeve ushqimore, por edhe cilësia e garancia e tyre për shëndetin e njerëzve si pjesë e sigurisë njerëzore në tërësi.

5. Siguria Mjedisore

(Besar Likmeta - Gazetar/Reporter BIRN)

Koncepti teorik: çfarë është siguria mjedisore?

Në kuptimin më themeltar pasiguria është rreziku që diçkaje me vlerë t'i ndodhë një e keqe. Për shembull, njerëzit që vlerësojnë punën e tyre shqetësohen mbi rrezikun e papunësisë; familjet që i kushtojnë rëndësi ushqimit shqetësohen për furnizimin e rregullt me ushqime; qeveritë që i kushtojnë vëmendje fuqisë shqetësohen nga mundësia e humbjes së pushtetit; ndërsa vendet që vlerësojnë paqen si diçka të vyer shqetësohen për mundësisë e shkuarjes në luftë. Kështu, koncepti i sigurisë mund të aplikohet për shumë gjëra të ndryshme që kanë vlerë (pra, për objektet referuese si puna, shëndeti, organizatat/institucionet, vendet/kombi) dhe i referohet një shumëllojshmërie kanosjesh (si papunësia, mungesa e ushqimit, ndryshimi i qeverisë, lufta). *Duke pasur parasysh këtë kontekst, nuk përbën habi fakti që edhe mjedisi është parë si objekt referues i sigurisë dhe që ndryshimet mjedisore janë parë si rreziqe sigurie. Këto dhe lidhje të tjera midis mjedisit dhe sigurisë mund t'i përkasin fushës studimore të emërtuar "siguri mjedisore".*

Termi "siguri mjedisore" lindi gjatë fundit të viteve 1980, kur raporti mes mjedisit dhe siguria e njeriut u bë subjekt kërkimi studimor dhe një shqetësim në rritje në komunitetin e akademikëve. Siguria ambientale është një prej një sërë çështjeve "të reja" jo-tradicionale të sigurisë. Ajo ka shërbyer për të zgjeruar dhe thelluar konceptin e sigurisë. Ky koncept na ndihmon të

thellojmë sigurinë pasi presupozon jo vetëm sigurinë e shteteve, por dhe atë të mjedisit “global”, si dhe të shumë nënsistemeve dhe sistemeve të ndryshme sociale. Siguria ambientale e zgjeron konceptin e sigurisë duke shqyrtuar kanosje të tjera, përtej luftës, - kryesisht rreziqet që vijnë nga ndryshimet ambientale - drejt gjërave që kanë vlerë për njerëzit.

E konsideruar si një çështje e rëndësisë së veçantë për sigurinë kombëtare, është përcaktuar se siguria mjedisore në përgjithësi prek në mënyrë të drejtpërdrejtë qenien njerëzore si dhe institucionet dhe organizatat kudo e në çdo kohë.²⁸ Një vëmendje e veçantë për sigurinë mjedisore i është kushtuar në vitet e fundit nga politikanët dhe vendimmarrësit në mbarë globin, në një kohë që në përgjithësi është njohur vlera e saj për sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare. “Zhvillimi i qëndrueshëm, është një çështje detyruese morale dhe humanitare, por në të njëjtën kohë, një sfidë për sigurinë” do të shkruante ish-Sekretari Amerikan i Mbrojtjes Colin Power në vitin 2000, në një edicion special të revistës së publikuar nga Kombet e Bashkuara mbi këtë çështje.²⁹

“Varfëria, degradimi mjedisor dhe dëshpërimi, janë shkatërrimtarë për popuj, shoqëri e kombe. Ky trinom mëkatar, mund të destabilizojë vende deri rajone të tëra. Hapësira e pakujdesisë së qeverive për të siguruar në territorin e saj ekosisteme të shëndetshme e të qëndrueshme në mbështetje të jetës së gjallë, si gjenerimi i ujit, ushqimit, ilaçeve dhe ajrit të pastër, mund të sjellë si pasojë që gjeneratat e sotme dhe ardhshme të përballen me raste serioze të ndryshimeve mjedisore, të cilat eventualisht mund të sjellin konflikte të dhunshme, në nivelin global, rajonal, kombëtar, lokal apo njerëzor”.³⁰

²⁸ Institute for Environmental Security, “What is Environmental Security?”, www.envirosecurity.org

²⁹ Powell Calls, “Sustainable Development a Security Imperative”. Online. Url: <http://www.america.gov/st/washfile-english/2002/August/20020807152247jfuller@pd.state.gov0.2198755.html>

³⁰ UNEP, “In Defence of the Environment, Putting Poverty to the Sword”, Online URL: <http://www.unep.org/Documents.Multilingual/Default.asp?ArticleID=3810&DocumentID=288>

Pavarësisht gjithë këtyre kërkimeve dhe influencës së tyre në politikë, mbetet i hapur debati rreth dobishmërisë së konceptit të sigurisë ambientale. Parë nga një këndvështrim mjedisor, janë shfaqur disa shqetësime mos ndoshta ky koncept ka çuar drejt një militarizimi të çështjeve ambientale. Parë në perspektivën e paradigmës dominuese të sigurisë, ekzistojnë shqetësime mos ndoshta koncepti ka nënvlerësuar çështjen e “fortë” të analizës dhe planifikimit të sigurisë kombëtare. Me këtë debat lidhen çështjet rreth veçantisë të sigurisë ambientale, duke pasur parasysh vështirësitë e dallimit midis problemeve mjedisore dhe atyre të *sigurisë* mjedisore, si dhe midis problematikës së sigurisë dhe problematikës së mjedisore. Sidoqoftë, për shumicën e studiuesve të sigurisë ambientale, dobishmëria e saj qëndron në urën që ndërton për të mbyllur hendekun midis studiuesve të sigurisë dhe politikëbërësve nga njëra anë dhe atyre që punojnë në fushën e mjedisit nga ana tjetër, duke krijuar kështu shkrirje të reja të teorisë dhe mundësi të reja për debat e dialog. Megjithatë, kërkimet studimore të kohëve të fundit kanë treguar se ekzistojnë lidhje të drejtpërdrejta mes degradimit të ambientit e ndotjes nga njëra anë, me çështjet e sigurisë kombëtare në anën tjetër. Kjo ka bërë që mjedisi tashmë të përcaktohet ose në kornizat e “sigurisë shtetërore” ose të “sigurisë njerëzore”. Në rastin e Shqipërisë dhe për sa i përket përballjes me sfidat që rrjedhin nga siguria mjedisore elementi më i logjikshëm për t’u fokusuar do të ishte roli i politikës, duke pasur parasysh edhe procesin e integritimit të vendit në Bashkimin Europian.

Siguria mjedisore në Shqipëri

Strategjia Kombëtare e Republikë së Shqipërisë, e aprovuar në vitin 2004, nuk i kushton ndonjë vëmendje të veçantë sigurisë njerëzore, pavarësisht se shumë aspekte të saj lidhen ngushtësisht me fusha të ndryshme të sigurisë, si siguria shëndetësore dhe ajo ekonomike. Gjatë regjimit komunist, nga viti 1944 deri në vitin 1991, qeveria Shqiptare dedikoi shumë pak investime në mbrojtje të ambientit, në një kohë që ky sektor

nuk u konsiderua kurrë një çështje e sigurisë kombëtare, ashtu si nuk shfaqet edhe sot e kësaj dite.

Teksa gjatë dekadave nën regjimin komunist, zhvillimi i industrisë së rëndë në mënyrë të vazhdueshme e në rritje ndikoi në degradimin e ambientit, gjatë viteve të tranzicionit që ndoqi rënien e regjimit totalitar, implementimi i dobët i ligjeve rezultoi në shkatërrimin e zonave të tëra pyjore dhe ndotjeve të niveleve të larta në rajonet urbane. Kjo edhe si rrjedhojë e mungesës së ndërgjegjësimit.

Në Shqipëri mbrojtja e ambientit në ditët e sotme, është njohur si prioritet kombëtar dhe një obligim për të gjithë aktorët, qofshin këta institucione shtetërore, organizata joqeveritare, kompani private apo qytetarë të thjeshtë. Ligji kryesor që aktualisht rregullon marrëdhënien mes agjentëve human dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë u aprovua nga parlamenti në vitin 2002, duke pasur si qëllim të përmbushë normativat kushtetuese për një mjedis të pastër.³¹ Korniza ligjore synon të racionalizojë shfrytëzimin e ambientit për qëllime ekonomike, duke e mbrojtur atë nga ndotja e degradimi. Ky ligj në të njëjtën kohë vendos piketa konkrete për të përmirësuar standardet mjedisore të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me shëndetin e popullsisë dhe mbrojtjen e rigjallërimit e burimeve natyrore. Ligji rregullon platformën institucionale për mbrojtjen mjedisore dhe mbështet një përfshirje më të gjerë të publikut në procesin vendimmarrës.

Rrjeti i institucioneve që mbrojnë mjedisin drejtohet nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Burimeve Ujore, agjencitë rajonale mjedisore si dhe Inspektorati Mjedisor. Ministria e Mjedisit e bazon aktivitetin e saj në një seri dokumentesh politikë ku përfshihet Programi Qeveritar, Plan-Veprimi Kombëtar për Mjedisin, Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social, Plani Strategjik i Qeverisë Shqiptare për Integrimin European, si dhe raportet vjetore të progresit të hartuara nga Këshilli i Evropës.

Gjatë dekadës së fundit, përafrimi i legjislacionit shqiptar në *acquis communitaire* të Bashkimit European, ka sjellë progres

³¹ Ligji Nr. 8934, 05.02.2002.

të ngadaltë, por të qëndrueshëm në përmirësimin e cilësisë së ligjit për mjedisin, megjithatë implementimi dhe zbatimi i tij lënë ende shumë për të dëshiruar. Duke iu referuar raportit të vitit 2008 të KE-së, Shqipëria ka bërë deri diku progres në fushën e legjislacionit horizontal, por megjithatë progres i limituar vihet re në përmirësimin e kualitetit të ajrit në zonat urbane dhe menaxhimin e mbeturinave në tërësi. Në këtë raport vlerësohet se një progres i pjesshëm është bërë edhe në fushën e mbrojtjes së natyrës dhe përmirësimin e cilësisë së ujit.³²

Emetimet nga automjetet e vjetra që qarkullojnë në rrugët e Shqipërisë si dhe aktiviteti i industrisë së rëndë, janë një ndër shkaqet kryesore të ndotjes mjedisore në Shqipëri. Qeveria aktualisht nuk ka të përcaktuar një politikë të qartë afatgjatë se si të mund të reduktojë ndotjen e ajrit dhe të minimizojë emetimet e gazit të dëmshëm nga 2 burimet e lartpërmendura. Bazuar në Raportin e KE-së, zbatimi i ligjit ekzistues mbi emetimin e gazrave të automjeteve në ajër dhe mbi cilësinë e karburanteve, është mjaft i dobët. Ndërkohë rezultatet e monitorimeve për sa i përket emetimeve të gazrave të rrezikshëm në atmosferë janë ende shumë larg në standardet e kërkuara nga OBSH-ja dhe BE-ja. Si rrjedhojë studimet kanë treguar se çdo vit vetëm në kryeqytetin shqiptar gjenerohen 56000 ton pluhur ose, e thënë ndryshe, 70 kg pluhur në vit për çdo qytetar. Shumica e këtij pluhuri prodhohet nga grimca të holla (PM10), të cilat është vërtetuar se janë përgjegjëse për pjesën më të madhe të sëmundjeve kanceroze të shkaktuara. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë më shumë se 1400 raste të ndryshme kanceri janë të lidhura me shkallën e lartë të ndotjes mjedisore në Shqipëri, shumica e të cilave në kryeqytet. Një studim i publikuar në tetor 2007 nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, zbuloi se ndotja e ajrit është përgjegjëse direkte për 200 vdekje të shkaktuara çdo vit.

Menaxhimi i mbeturinave urbane, gjithashtu vazhdon të jetë një kërcënim kryesor për ambientin. Depozitimi i

³² Commission of European Communities, *Albania 2008 Progress Report*, Brussels. 05.11.2008.

pakontrolluar dhe djegia e mbeturinave urbane paraqitet në nivele alarmante duke përbërë një rrezik imediat për shëndetin e banorëve. Raporti veçon se Shqipërisë i mungon një sistem modern i mbledhjes, përpunimit e riciklimit të mbeturinave dhe nuk ka përcaktuar asnjë strategji të qartë për përpunimin e sigurt të mbetjeve të rrezikshme. Pavarësisht dy dekadave që nga rënia regjimit komunist disa “zona të nxehta” mjedisore vazhdojnë të mbeten një problem konstant mjedisor.

Ndotja industriale dhe mbetjet urbane të sipërfaqeve ujore mbeten gjithashtu shqetësuese për indeksin e sigurisë njerëzore në vendin tonë. Aktualisht sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe sistemi sanitar janë të amortizuar, në një kohë që ndotja e ujit të detit në disa nga plazhet më të populluara, si pasojë e shkarkimit të ujërave të zeza ose nga aktiviteti industrial, është identifikuar si një faktor me rrezik të lartë për shëndetin e popullsisë. Ky fenomen gjithashtu pengon e kërcënon drejtpërdrejt zhvillimin e industrisë turistike në vend.

Shqipëria ka nevojë për të forcuar përpjekjet në ndërtimin e kapaciteteve administrative e të gjithë institucioneve përgjegjëse në vendimmarrjet politike në çështjet mjedisore si dhe në të njëjtën kohë të përmirësojë bashkëpunimin dhe koordinimin ndër-institucional. Të tjera përpjekje nevojiten në ratifikimin dhe implementimin e konventave ndërkombëtare, mes të cilave një implementim më i mirë i Konventës së Aarhusit. E ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar në vitin 2001, konventa identifikon rëndësinë që ka aksesin e publikut në informacion si dhe pjesëmarrje më e gjerë e tij në vendimmarrje. Ajo siguron bazat për një qeveri të përgjegjshme, transparente dhe reaguese ndaj impaktit negativ në ambient që vjen nga projektet industriale dhe ato në infrastrukturë.

Duke iu referuar grupeve mjedisore, një tjetër çështje mjaft problematike mbetet aprovimi nga qeveria i një sërë projekteve të mëdha në fushën energjetike dhe atë të ndërtimit, të gjitha këto të zbatuara nga kompani të huaja, të cilat synojnë të kënaqin tregjet e jashtme, duke i faturuar një kosto të lartë mjedisore vendit tonë në një kohë që përfitimet e Shqipërisë

mbeten të paqarta. Si pasojë këto projekte pritet të rrisin ndjeshëm emetimin e karbonit në atmosferë.³³

Ndonëse fuqizimi i kornizës ligjore sipas kërkesave të BE-së pritet të përmirësohet ende në vitet në vazhdim, implementimi i këtyre strategjive si dhe rritja e monitorimit dhe autoritetit të strukturave shtetërore, kërkon një fond më të madh nga buxheti i shtetit drejtuar mbrojtjes mjedisore. Të dhënat që vijnë nga Instituti Kombëtar i Statistikës (INSTAT) na tregojnë se investimet publike në dobi të një mjedisi të qëndrueshëm në vendin tonë, janë të papërfillshme nëse e krahasojmë me shtetet më të reja anëtare të BE-së që është klubi politik ku ne aspirojmë të hyjmë sa më shpejt.

Shpenzimet drejtuar mjedisit në buxhetin e shtetit 2009 përbëjnë vetëm 0.2% të GDP-së, krahasimisht shumë më e ulët se mesatarja e investimeve publike në fushën e mjedisit në vendet e BE-së. Sipas Zyrës së Statistikave të Komunitetit Europian (Eurostat), mesatarja e investimeve publike për mjedisin e 10 shteteve të reja që hynë në BE në vitin 2004 ishte rreth 0.61% e GDP-së së vendit.

Një vëmendje më e madhe në çështjet e buxhetimit mund të rezultojë në një investim të goditur dhe efikas që do të shpërblejë gjeneratat e ardhshme duke ulur koston shëndetësore të shoqërisë, përmirësimin e sigurisë shëndetësore të një vendi dhe përcaktimin e standardeve për një rritje ekonomike më të qëndrueshme.

³³ Mato. Xhemal, "The Hidden Truth About Albania's Deadly Environment", Balkan Insight, 15 January 2009.

6. Siguria Shëndetësore

(Besnik Baka - Studiues pranë IDN)

Koncepti teorik: çfarë është siguria shëndetësore

Siguria Shëndetësore, një komponent i rëndësishëm i Sigurisë Njerëzore, duhet parë realisht në një perspektivë holistike ose ndryshe të integruar për vet ndërlidhjen dhe varësinë e ngushtë e të pandashme që ka me komponentët e tjerë si: siguria mjedisore, siguria ushqimore e siguria ekonomike. Sipas një përkufizimi funksional të sigurisë shëndetësore, çështje të tilla do të konsiderohen “ato çështje shëndetësore me pasoja të mundshme sigurie” - pra në përgjithësi emergjencat e një natyre akute dhe kronike që kanë pasoja serioze publike shëndetësore dhe implikime të mundshme ndërkuftare.

Kombinimi i rritjes së pabarazive sociale (një e vërtetë kjo tepër e hidhur sidomos për vendin tonë), përkeqësimi dhe kolapsi relativ i sistemeve shëndetësore në pjesë të caktuara të rajonit evropian (sidomos të një pjese të shteteve që dolën nga sistemi i dikurshëm i socializmit të aplikuar), rritja e aftësisë ndërlidhëse (për shkak të rritjes së lëvizshmërisë dhe teknologjisë së transportit) të sëmundjeve të transmetueshme, rishfaqja e disa sëmundjeve që mendohej se ishin zhdukur më parë, shpeshimi i situatave ekstreme të fatkeqësive natyrore për shkak të kushteve atmosferike, fatkeqësitë e tjera natyrore dhe të kryera nga njeriu si dhe shkalla e paprecedentë e dhunës sociale (në kuptimin më të gjerë të termit) në disa vende të rajonit evropian e bëjnë sot këtë rajon më vulnerabël duke rritur potencialin kërcënues të sigurisë shëndetësore.

Kështu, për shembull, sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), 25% e sëmundjeve të parandalueshme shkaktohen nga cilësia e keqe e ambientit në të cilin jetojmë. Por edhe njerëzit që vuajnë nga uria dhe të kequshqyerit, nëse nuk trajtohen kanë tendencë më të lartë për t'u prekur nga sëmundjet që mund të jenë lehtësisht të transmetueshme, duke

u kthyer kështu në kërcënim real edhe për sigurinë kombëtare. Duke iu referuar OBSH-së përmirësimi i shëndetit njerëzor është në thelb të çështjes së zhvillimit të një vendi. Për këtë arsye shëndeti është subjekti specifik i tre prej tetë qëllimeve kryesore të parashikuara në Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit.³⁴

Për rrjedhojë siguria shëndetësore synon të garantojë një minimum të domosdoshëm mbrojtjeje nga sëmundjet, veçanërisht prej atyre infektive e epidemike, apo dhe nga ato që shkaktohen nga kushtet e këqija të jetesës. Shkaqet mund të jenë natyrore, mjedisore, aksidentale ose të qëllimshme, por më së shumti ato janë të lidhura me sjelljen e njeriut. Pra, qeveritë dhe institucionet shtetërore kanë përgjegjësi për të garantuar trajtim mjekësor të çdokujt që ka nevojë. Injorimi ose refuzimi i këtij shërbimi qoftë edhe ndaj një qytetari të vetëm mund të jetë me pasoja fatale nëse ai/ajo rezulton infektues, duke i kushtuar vendit miliona për të kontrolluar një epidemi të mundshme.

Siguria shëndetësore në Shqipëri Sfidat për një shoqëri të shëndetshme

Teksa shërbimi i ofruar mjekësor spitalor gjen një përhapje të gjerë në të gjitha rajonet e Shqipërisë, cilësia e tij lë ende shumë për të dëshiruar ku nga ngërçet më të mëdha të 15 viteve të fundit mbetet korrupsioni. Në veçanti gjatë viteve të fundit janë vërejtur mungesa të theksuara të medikamenteve dhe pajisjeve bazë, në një kohë që gjendja e spitaleve është në kushte të rënda dhe kualifikimi e specializimi i stafit të spitaleve dhe poliklinikave nuk është ende i rregulluar. Si pasojë e këtyre kushteve, principi i të drejtave të barabarta në shërbimin mjekësor, i parashikuar në Kushtetutën Shqiptare³⁵ nuk mund të aplikohet. Kjo bëhet edhe më e prekshme kur në zonat rurale apo periferitë e qyteteve kemi të bëjmë edhe me kequshqimin e fëmijëve, aksesin e tyre tepër të dobët apo të munguar te

³⁴ United Nations Millenium Development Goals, www.un.org/millenniumgoals/

³⁵ Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 55, Paragrafi 1.

shërbimi shëndetësor, përdorimin e ujit të pashëndetshëm për pirje etj. Me një ndikim mjaft negativ është dhe ndotja mjedisore në qytetet e mëdha, sidomos në Tiranë, apo vendosja e të shpërngulurve nga zonat e pastra malore në zona mjaft të ndotura apo të quajtura të nxehta (“hotspots”) në planin mjedisor.

Në këtë perspektivë Shqipëria është një vend që po përjeton një tranzicion të thellë demografik, ku ritmet e larta të lindjeve po bien ndjeshëm, por vdekshmëria e lartë amtare dhe foshnjore e bën situatën problematike. Tranzicioni epidemiologjik kombinon një prevalencë të lartë të sëmundjeve infektive. Por shifra ekstreme njohin edhe sëmundjet kronike dhe kardiovaskulare që janë shkaku kryesor i vdekjeve në Shqipëri me më shumë se gjysmën e vdekjeve të përgjithshme.³⁶

Cilësia dhe disponueshmëria e shërbimeve shëndetësore në Shqipëri mbetet shumë e ulët dhe ky sektor vuan infrastrukturën e varfër, mungesën e instrumenteve dhe aparaturave të nevojshme, në një kohë që mungon motivimi i stafit të kualifikuar. Sipas statistikave³⁷ kostoja mesatare e shërbimeve shëndetësore për person në vendin tonë është 50 USD/vit, ndërkohë që në Evropë është 1900 USD/vit. Kjo tregon qartë nivelin e shëndetësisë shqiptare dhe nevojën e saj për reformim.

Vlen për t’u theksuar se sistemi shëndetësor në vendin tonë vazhdon të jetë i përqendruar rreth kujdesit spitalor, me një vëmendje të pamjaftueshme në kujdesin parësor/sekondar preventiv dhe promovimit të kujdesit ndaj shëndetit. Për më tepër, shpenzimet publike në kujdesin shëndetësor nuk janë shpërndarë sipas rajoneve me varfërinë më të madhe ku edhe niveli i sëmundjeve është më i lartë. Në veçanti duhet të kultivohet dhe zhvillohet si prioritar modeli i shëndetit publik që synon parandalimin e sëmundjeve nëpërmjet gjetjes dhe

³⁶ INSTAT .

³⁷ Xhillari. Lindita, Çabiri. Ylli, “Country Report 2005”, Human Development Promotion Centre (HDPC), <http://www.socialwatch.org/en/informesNacionales/423.html>

analizimit të shkaqeve, sesa një model që përqendrohet në diagnostifikimin dhe trajtimin e sëmundjeve.³⁸

Një vlerësim realist i sigurisë kombëtare, pas sulmeve terroriste që kanë dominuar agjendën e sigurisë kombëtare e ndërkombëtare gjatë viteve të fundit, kërkon që liderët të kuptojnë rëndësinë e sigurisë shëndetësore, jo vetëm në lidhje me terrorizmin, por nga një perspektivë e sëmundjeve që mbizotërojnë dhe kërcënojnë popullsinë si kanceri, HIV/AIDS etj. Rëndësia e vullnetit politik për financim të mjaftueshëm në shëndetin publik është esencial, në një kohë që politikanët e kanë të vështirë të kuptojnë nevojën për të zhvilluar këtë sektor. Në morinë e dokumenteve strategjike të përgatitura nga Ministria e Shëndetësisë ku parashtrihen prioritetet në përmirësimin e sigurisë shëndetësore në vend, vihet re se situata nuk ka pasur ndonjë ndryshim thelbësor. Si rrjedhojë dokumente strategjike,³⁹ me një përmbajtje të deri diku adekuate, kanë vështirësi të theksuara në implementim, duke e lënë sektorin e shëndetësisë ndër më problematikët në vend.

Në një tjetër aspekt për sa i përket fushës së shëndetit mendor, implementimi i “Rregullave të Shëndetit Mendor” i aprovuar në vitin 2007, ka qenë i ngadaltë dhe aspak efektiv. Por megjithatë ende nuk ekziston një ligj që t’u sigurojë asistencë legale falas njerëzve me aftësi të kufizuara.

Në kontekstin e shëndetit dhe sigurisë në punë, janë bërë disa hapa para në kornizën ligjore ku në mars 2008, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin për përcaktimin dhe ruajtjen ndaj substancave të rrezikshme dhe një grup i posaçëm pune po mbikëqyr zbatimin e këtij ligji. Por megjithatë Drejtoria e

³⁸ Dodde, Felix (Ed). *Human and Environmental Security: An Agenda for Change*. London, Earthscan Publications, Limited, 2005. p. 132.

³⁹ Strategjia Kombëtare për një Transfuzion Gjaku të Sigurt; Strategjia Kombëtare e Sigurimit të Kontraceptivëve; Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Kontrollin e Përhapjes së HIV/AIDS në Shqipëri; Strategjia Afatgjatë e Zhvillimit të Sistemit Shëndetësor Shqiptar; Politika Kombëtare për Menaxhimin e Pajisjeve Mjekësore në Shqipëri; Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Sëmundjeve të Lindura të Gjakut: Dokumentet strategjike të sektorit të shëndetësisë mund t’i gjeni në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Shëndetësisë.

Shëndetit dhe Sigurisë në punë nuk ka kapacitetet e nevojshme për të vlerësuar të drejtat dhe kujdesin shëndetësor në vendin e punës.⁴⁰

7. Siguria Komunitare*

(Elona Dhëmba - Lektore në Universitetin e Tiranës)

(Besnik Baka - Studiues pranë IDN-së)

Koncept teorik: çfarë është siguria komunitare (sociale)

Termi “siguri sociale” u përdor për herë të parë nga Buzan në librin e tij “*Njerëzit, Shtetet dhe Frika*” (ang. “People, States and Fear”) (1991a). Në tekst, siguria sociale ishte vetëm njëri prej sektorëve të qasjes së tij pesëdimensionale, krahas atij ushtarak, politik, ekonomik dhe mjedisor. Siguria sociale në këtë kontekst iu referua zhvillimit të qëndrueshëm të modeleve tradicionale të gjuhës, kulturës, fesë dhe identiteteve kombëtare, si dhe traditave të shteteve (1991a: 122-3). Secili prej pesë sektorëve të Buzanit u formulua brenda kufijve të

⁴⁰ European Commission, Albania Progress Report, 2008: <http://www.abhaber.com/arnavutluk.pdf>.

* Më së shumti në literaturë “siguria komunitare” haset si “siguri sociale” [ang. “societal security”]. Për më tepër rreth sigurisë shoqërore shih: **Roe, P.** (2005), “Ethnic Violence and the Societal Security Dilemma”, Londër: Routledge. Një prej pak teksteve që kombinon me sukses çështje të identitetit me studimet tradicionale të sigurisë. Katzenstein, P. J. (ed.) (1996), “The Culture of National Security: Norms and Identity in World Politics”, Nju-Jork: Columbia University Press. Ndoshta koleksioni më i rëndësishëm i edituar në lidhje me impaktin e normave dhe identitetit mbi sjelljen në politikën e jashtme dhe të sigurisë. Weldes, J. (et. al.) (1999), “Cultures of Insecurity: States, Communities and the Production of Dangers”, Minneapolis: University of Minnesota Press. Teksti paraqet disa qasje sociologjike dhe antropologjike në hulumtimin e prodhimit kulturor të pasigurisë në kontekste lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare; nga Lufta e Koresë, në krizën e Raketave në Kubë, deri në konfliktet e Lindjes së Mesme.

një kuadri në thelb neorealist: të gjitha dimensionet mbetën si sektorë të sigurisë kombëtare – pra shtetërore. “Shoqëria” ishte vetëm një seksion nëpërmjet të cilit mund të kërcënohej shteti. Për më tepër, ato që shiheshin si primare ishin kërcënimet në sektorin ushtarak: ndërsa prioritetet që iu dhanë secilit dimension u varën nga urgjenca e tyre relative. Buzan argumentoi se siguria ushtarake përbënte ende aspektin më të shtrenjtë, më të fuqishëm politikisht dhe më të dukshëm të sjelljes së shtetit (1991a: 35). Për rrjedhojë: “Një shtet dhe një shoqëri mund të jenë edhe ata të sigurt në dimensionet politike, ekonomike, sociale dhe mjedisore – megjithatë të gjithë këto arritje mund të zhbëhen nga dështimi ushtarak” (1991b: 17).

Siguria komunitare (sociale) ndryshe nga komponentët e tjerë të sigurisë humane, të cilat janë më të prekshme deri diku edhe materialiste, ka të bëjë në mënyrë të drejtpërdrejtë me lirinë dhe të drejtat e njeriut (ose të një grupi njerëzish) për të mbrojtur e zhvilluar identitetin që ata besojnë. Koncepti i sigurisë komunitare (sociale)⁴¹ fillon të shfaqet vrullshëm në debatet akademike dhe në qarqet politikëbërëse sidomos pas Luftës së Ftohtë, kur u largua vëmendja prej kërcënimeve tradicionale shtetërore duke u interesuar më shumë për kërcënimet e natyrave të reja, si ato etnonacionaliste për shembull. Prandaj *vlera e shtuar e konceptit të sigurisë komunitare në studimet e sigurisë konsiston në përcaktimin e vetë shoqërisë si objekt*

⁴¹ Mjafton të përmendim këtu disa çfarë pohojnë disa nga autorët më të shquar të fushës: “Në Perëndim dhe në Lindje, në qendër dhe në periferi, identiteti kulturor dhe siguria sociale janë bërë çështja qendrore e tendencave dhe konflikteve politike”, Pierre Hassner, “Beyond Nationalism and Internationalism: Ethnicity and World Order”, 1993, f. 58). Në një tjetër pasazh Aggestan dhe Hyde-Price pohojnë se: “Me rritjen e gërshetimit midis sigurisë dhe identitetit, ka lindur një axhendë e re, si për politikëbërësit që përballen me dilemat dhe pasiguritë e Evropës së Pasluftës së Ftohtë, ashtu edhe për akademikët që përpiqen t’i japin një kuptim analitik dhe konceptual këtij kontinenti të ndryshuar... Hulumtimi i ndërveprimit midis sigurisë dhe identitetit mund të hedhë një dritë të konsiderueshme mbi dinamikat strukturore dhe prirjet në themel të politikave bashkëkohore evropiane”, Lisbeth Aggestan and Adrian Hyde-Price, “Security and Identity in Europe, 2000, f. 1.

referues i sigurisë. Emanuel Adler dhe Michael Barnett⁴² argumentojnë se komuniteti mund të përcaktohet në tre karakteristika kryesore: *E para* është që anëtarët e një komuniteti kanë identitet, vlera dhe kuptime të përbashkëta. *E dyta* është fakti se anëtarët e një komuniteti kanë marrëdhënie të ndërsjella direkte e të shumanshme. *E treta* komunitetet tregojnë reciprocitet që shprehet përmes disa formave interesi afatgjatë madje edhe altruizmi ndaj pjesëtarëve të tjerë të këtij komuniteti. Ndërkohë në anën tjetër nocioni i “sigurisë” përfshin: identifikimin e vetes; përcaktimin e rrezikut; identifikimin e agjentit që do të përballlet me rrezikun si dhe përcaktimin e masave që do të ndërmerren ndaj situatës. Duke bashkuar “sigurinë” me “komunitetin” shumë shtete po e rishikojnë konceptin e autoritetit/pushtetit që ato gëzojnë, për të përfshirë dhe zgjeruar aftësinë e komunitetit për të zhvilluar vlerat e tij si dhe përballimin e ndonjë kërcënimi të mundshëm në veçanti kur kemi të bëjmë me grupe/komunitete vulnerabil. Bashkëveprimi mes këtyre elementëve përbën edhe kornizën e zhvillimit të sigurisë komunitare në një vend specifik si është Shqipëria.

Tëksa flasim për identitetin dhe lirinë për t’u bërë pjesë e një komuniteti, vlen të përmendet se ashtu si komuniteti është i ndryshueshëm në kohë edhe prioritetet në sigurinë komunitare mund të ndryshojnë madje edhe të pushojnë së ekzistuari. Disa nga kërcënimet më të hasura në kontekstin e sigurisë komunitare, mund të konsiderohen shpërbërja e familjes, zhdukja e gjuhës dhe e kulturës tradicionale së një grupi të popullsisë, diskriminimi etnik, racial, fetar, seksual; konfliktet me bazë nacionaliste, si dhe në raste ekstreme gjenocidi e pastrimi etnik.

Komunitetet kombëtare dhe etnokulturore në Shqipëri

Pavarësisht një trashëgimie deri diku pozitive me të cilën Shqipëria doli nga e shkuara e saj komuniste (të paktën në

⁴² Adle. Emanuel, Barnett. Michael, *Security Communities*, Cambridge University Press. 1998.

raport me një pjesë të vendeve të tjera të Evropës Qendrore e Lindore) siguria komunitare e minoriteteve kombëtare dhe atyre etnokulturore përjeton ende standarde të dyfishta në raport me komunitetin më të madh vendas. Madje në këtë rast, situata komplikohet edhe më tej me standarde shumëfishe edhe në raport me trajtimet e ndryshme që marrin minoritetet etnike e kulturore në Shqipëri.

Para vitit 2003, statusin e minoritetit e kishin vetëm 3 minoritete kombëtare, mes të cilëve ai grek, maqedonas dhe serbo-malazez. Por në vitin 2003 edhe Romët morën zyrtarisht statusin e minoritetit. Ndërkohë, minoriteti Arumun mori statusin e “minoritetit gjuhësor”. Përveç tyre, disa grupe të tjera si janë Egjiptianët, njihen si komunitete, ndërkohë që ky komunitet kërkon nga autoritetet zyrtare që t’i jepet statusi i minoritetit kombëtar. Një ndër arsyet që e ka shtyrë shtetin shqiptar që të mos u japë atyre statusin e minoritetit lidhet me faktin se ata nuk kanë një gjuhë të tyre, si dhe nuk dëshmojnë veçori të karakterit etnik kulturor dhe fetar.⁴³

Sidoqoftë, evidentimi i situatës së minoriteteve në vend mbetet problematik. Regjistrimi i fundit zyrtar i popullsisë i kryer në vitin 1989, në të cilin jepet edhe numri i minoriteve në Shqipëri, ka mbetur deri më tani e vetmja e dhënë zyrtare, e cila përbën burimin më të gjithëpranuar për përqindjen dhe raportet e minoriteteve në vend. Megjithatë, ajo çka mund të konsiderohet pozitive lidhet me kuadrin ligjor në vend. Progres-Raporti i fundit i Bashkimit Europian për Shqipërinë vlerëson faktin se për sa u përket të drejtave kulturore, kushtetuta parashikon mbrojtjen e të drejtave civile, ekonomike, sociale e politike të grupeve të minoriteteve dhe ligji ndalon trajtimin diskriminues.⁴⁴ Neni 20 i Kushtetutës

⁴³ VKM Nr. 127, datë 11.03.2004 - Për krijimin e Komitetit Shtetëror të Minoriteteve (Fletore Zyrtare Nr. 13, Viti 2004, fq. 547). Shih edhe Minoritetet: E tashmja dhe e ardhmja. Raport i Grupit Shqiptar për të Drejtat e Njeriut mbi gjendjen e minoriteteve në Shqipëri. Botimet “Kanun”, Tiranë, 2003. fq. 91, 156.

⁴⁴ Commission of the European Communities) Brussels, 05.11.2008 SEC(2008) 2692 final COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT: Albania 2008 Progress Report {/COM(2008) 674}, pg. 16-17.

përcakton se personat që u përkasin minoriteteve kombëtare mund të ushtrojnë liritë e të drejtat e tyre njerëzore në barazi të plotë para ligjit. Ata kanë të drejtë që të ruajnë dhe të zhvillojnë kulturën dhe gjuhën e tyre, ashtu sikurse të ndjekin nivele të caktuara të arsimit të detyrueshëm në gjuhën e tyre.⁴⁵ Por pavarësisht këtyre garancive kushtetuese, praktikimi i këtyre të drejtave nga minoritetet lë ende për të dëshiruar dhe për më tepër varion ndjeshëm nga minoriteti në minoritet ku ekstremin më pozitiv e zë ai grek dhe atë me pozicion më pak të kënaqshëm ai rom dhe egjiptian.

Ndërmjet tre minoriteteve etnike të njohura në vend, numrin më të madh e përbën minoriteti grek, i cili është vendosur në jug të Shqipërisë në rajonin e Gjirokastrës si dhe në rrethet e Sarandës e të Delvinës. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë më 1989, minoriteti grek numëronte rreth 60000 banorë.⁴⁶ Për shkak të mungesës së një regjistri të saktë të numrit të popullsisë për sa u përket minoriteteve, ai është bërë shkak për të ashtuquajturën “*luftë shifrash*” që zhvillohet mes përfaqësuesve të minoriteteve apo ndonjëherë edhe shteteve të tyre të origjinës me institucionet shtetërore shqiptare dhe opinionin publik në vend.

Sipas raportit⁴⁷ të GSHDNJ (2003), ndonëse ky minoritet është i pozicionuar ndjeshëm më mirë se minoritetet e tjera, kërkohen ende statistika të sakta dhe të freskëta, përfaqësim i cunguar në arenën politike dhe vendimmarrëse të vendit, ndarje më e mirë administrative e zonave ku gjendet ky minoritet, më tepër mundësi edukimi në gjuhën greke dhe

⁴⁵ Ligji Nr. 7491, datë 29.04.1991 “Për Dispozitat kryesore kushtetuese (Fletore Zyrtare Nr. 4, viti 1991, fq. 145) Neni 4 te Dispozitat e përgjithshme flet për garantimin e të drejtave të pakicave kombëtare. Ligji Nr. 8417, datë 21.10.1998 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (Fletore Zyrtare Nr. 28, viti 1998, Faqe 1073) Pjesa II - Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut (Neni 18 mosdiskriminim) Neni 20 pika 1 dhe 2 (arsimimi) - Neni për pakicat kombëtare e të drejtat që ata gëzojnë. Neni 22, 23, 24 - liria e shprehjes, informimit, liria e ndërgjegjes.

⁴⁶ Shih te <http://www.southeasteurope.org/documents/0009albminorities.pdf>

⁴⁷ GSHDNJ, Minoritetet: E tashmja dhe e ardhmja, Botimet “Kanun”, Tiranë, 2003.

më shumë hapësira për programe social-kulturore në radion dhe televizionin publik shtetëror.

Minoriteti maqedonas i përqendruar në zonën e Prespës, afër Korçës, në Juglindje të Shqipërisë rezulton se ka marrë më pak vëmendje dhe përkujdesje. Anëtarët e këtij minoriteti që numërojnë afërsisht 5000 banorë që jetojnë në afro 9 fshatrat e Liqenas⁴⁸, ngrenë një sërë pretendimesh ndër të cilat: mungesa e mundësive për arsimim, mungesa e regjistrimit të popullsisë, mosruajtja e vlerave kulturore, mospërfaqësimi i këtij komuniteti në politikë dhe vendimmarrje; e mbi të gjitha, mungesa e investimeve dhe politikave zhvilluese për këtë zonë.

Për sa u përket pjesëtarëve të minoritetit serbo-malazez, ata jetojnë kryesisht në rajonin e Shkodrës. Numri i tyre, sipas INSTAT, është relativisht i vogël, më pak se 2000 banorë. Megjithatë, ata ende vazhdojnë të ruajnë mirë identitetin e tyre kulturor dhe etnik. Ata pretendojnë që shteti shqiptar të ofrojë arsim për fëmijët e tyre në gjuhën serbo-malazeze, por përmasa tepër e vogël në numër e këtij komuniteti nuk plotëson një ndër kriteret kryesore për hapjen e një shkolle minoritare.

Ndërkohë, komuniteti rom dhe ai arumun/vllah përbëjnë dy minoritete etnokulturore. Minoriteti rom është i përhapur në të gjithë Shqipërinë në fise të shumta, të cilat janë vendosur këtu disa shekuj më parë. Jeta e minoritetit Rom në Shqipëri mbetet e karakterizuar nga stili nomad dhe aktivitetet kryesore janë tregtia, artizanati etj. Ky komunitet karakterizohet nga një nivel i ulët arsimor dhe ekonomik dhe përballet me vështirësi të shumta, të cilat kanë qasjen e një përjashtimi apo shpeshherë edhe të një vetë-përjashtimi social nga pjesa tjetër e popullsisë.⁴⁹ Përveç regjistrimit (që është një problematikë karakteristike për këtë komunitet) problemet kryesor dhe më shqetësues të tyre janë edukimi, punësimi dhe strehimi.

⁴⁸ GSHDNJ, Minoritetet: E tashmja dhe e ardhmja, Botimet “Kanun”, Tiranë, 2003, fq. 24-25.

⁴⁹ *Hermine De Sotto & Sabine Beddies & Ilir Gedeshi* Roma and Egyptians in Albania: From Social Exclusion to Social inclusion, Published by World Bank Office-Albania, Tiranë, 2005, pg. 370.

Ndërsa minoriteti vllah/arumun gëzon statusin e në minoriteti gjuhësor e kulturor në Shqipëri. Të vendosur në Shqipëri rreth shek. XVII, që atëherë janë integruar në mënyrë aq të plotë në shoqërinë shqiptare, saqë numri i tyre që flasin gjuhën vllahe është pakësuar ndjeshëm. Megjithatë, përveç gjuhës, vllahët kanë ruajtur edhe shumë nga zakonet e traditat e tyre. Ajo që kërkohet prej tyre është konservimi i identitetit gjuhësor, kulturor dhe religjioz përmes objekteve të kultit, botimeve dhe mediave në gjuhën amtare⁵⁰.

Minoriteti Egjiptian është në kahun më negativ të spektrit të statusit të minoriteteve në vend. Përveç gjithë vështirësive dhe problematikave kryesisht me karakter ekonomik dhe të edukimit që ndajnë me komunitetin rom, atyre u shtohet edhe problematika e mosnjohjes si minoritet kombëtar.

Komuniteti homoseksual në Shqipëri

Komuniteti homoseksual në Shqipëri, mund të quhet edhe kategoria që vuan më shumë implikimet që vijnë nga dobësitë e sigurisë komunitare në vendin tonë. Ndryshimet në ligjin e vjetër (që daton vitin 1995) krijuan disa lehtësira për sa i përket sigurisë komunitare. Marrëdhëniet homoseksuale u hoqën nga kodi penal ku në ligjin e vjetër “pederastia” dënohej deri në 10 vjet. Kështu edhe pse mund të vërehet një përmirësim në ligjin konservator mbi homoseksualitetin ai vazhdon të ketë probleme në zbatim, çka ka bërë që personat homoseksualë të kenë humbur besimin tek institucionet shtetërore. Ndërkohë në kodin civil⁵¹ asgjë nuk ka ndryshuar dhe krijimi i familjeve mes homoseksualëve është i jashtëligjshëm ku parashikohet në mënyrë të qartë se *martesa* dhe *bashkëjetesa* mund të realizohet vetëm nga burri dhe gruaja⁵² ndërkohë që bashkimi i njerëzve me të njëjtin seks qëndron

⁵⁰ GSHDNJ, Minoritetet: E tashmja dhe e ardhmja, Botimet “Kanun”, Tiranë, 2003, fq. 88.

⁵¹ Kodi i Familjes, www.mpcs.gov.al/dshb/images/stories/legjislacioni/kodi_familjes.pdf

⁵² Neni 163 & Neni 7, Kodi i Familjes, eëë.mpcs.gov.al/dshb/images/stories/legjislacioni/kodi_familjes.pdf

jashtë kornizës ligjore duke i lënë këta të fundit në ilegalitet dhe lenë hapësira për abuzim. Kjo në mënyrë të veçantë i kufizon edhe më shumë të drejtat dhe liritë e këtij komuniteti duke i diskriminuar këta të fundit nga vetë strukturat shtetërore.

Sipas Genci Terpos, avokat pranë “Grupit Shqiptar për të Drejtat e Njeriut” (GSHDNJ), vetëm në kryeqytet mendohet të jenë rreth 3500 homoseksualë, të cilët realisht janë të padukshëm pasi si pasojë e frikës dhe diskriminimit fshihen dhe ruhen për mos t’u njohur në publik.

Megjithatë problemi më i madh qëndron te mentaliteti që mbizotëron në pjesën dërrmuese të publiku. Në një sondazh të zhvilluar nga GSHDNJ me personat heteroseksualë, kuptojmë se gati e gjithë shoqëria shqiptare ka paragjykime të thella ndaj komunitetit *gay*, por në të njëjtën kohë edhe mungesë të theksuar informacioni. Si rrjedhojë për 90% të të pyeturve, homoseksualizmi është sëmundje dhe për 80% amoralitet. Po kaq do të braktisnin një të afërm ose mik me prirje homoseksuale. Por paragjykimet nuk ndalen as nga instancat shtetërore, në veçanti gjykatat⁵³ dhe policia⁵⁴, që janë edhe përgjegjësit kryesorë për sigurinë e këtij komuniteti. Në përgjithësi kundrejt homoseksualëve shqiptarë shprehet: diskriminim, përçmim, intolerancë, dhunë psikologjike (fyerje, tallje, ngacmime, kërcënime) e dhunë fizike.

Bazuar në të dhënat e Grupit Shqiptar për të Drejtat e Njeriut problemet më të mëdha vihen re në trajtimin që policia i bën këtij komuniteti ku rastet e dhunës fizike e psikologjike janë të shumta.⁵⁵ Në këtë kuadër dokumentohen mjaft ankesa nga homoseksualë të ndaluar padrejtësisht nga policia si dhe

⁵³ Në vitin 1999 Gjykata e Tiranës refuzoi kërkesën e regjistrimit të fondacionit Gay Albania edhe pse kërkesa ishte e bazuar ligjërisht dhe plotësonte të gjitha kushtet.

⁵⁴ GSHDNJ, ka regjistruar shumë ankesa që kanë të bëjnë me dhunë verbale dhe fizike nga oficerët e policisë, ndalim pa shkak i homoseksualëve, kontrolle të paparalajmëruara dhe pa mandat në banesat e homoseksualëve (A.A gjatë 6 muajve u bastis 3 herë nga policia pa asnjë shkak), por edhe shfrytëzimi i policisë kundër homoseksualëve nga personat privatë.

⁵⁵ GShDNj, *Homoseksualët në Shqipëri*, Tiranë, 2003.

të keqtrajtuar gjatë shoqërimit në polici. Këtë e pasqyron edhe sondazhi i GSHDNJ, këtë radhë me personat homoseksualë, ku 60% e të pyeturve kanë pasur probleme me policinë, 30% e të cilëve janë dhunuar fizikisht. Raste të tjera rutinë të diskriminimit janë ato kur homoseksualëve u mohohet e drejta e punësimit në departamentet shtetërore apo refuzimi i shërbimeve të ndryshme.

Komisioni European në raportin e vitit 2008 mbi progresin e Shqipërisë në fusha të ndryshme, veçon se shteti shqiptar ka bërë shumë pak progres në politikat anti-diskriminuese si në aspektin ligjor edhe në atë institucional. Komisioni European thekson se ka një tendencë të përgjithshme armiqësore të shoqërisë ndaj komunitetit homoseksual ndërkohë që shteti nuk bën asgjë për të mbrojtur këtë komunitet. Duke parë se siguria dhe liritë e tyre në komunitet janë të kufizuara shumë prej tyre kanë gjetur e gjejnë si të vetmin shpëtim kërkimin e azilit në shtete të ndryshme evropiane me politika më miqësore dhe liberale ndaj këtij komuniteti si Suedi, Angli, Norvegji etj.

8. Siguria Politike

(Arian Dyrmishi - Studiues pranë IDM)

(Jonida Hoxha - Specialiste Juriste, DSIK, Këshilli i Ministrave, Tiranë)

Koncepti teorik: çfarë është siguria politike?

Koncepti i sigurisë politike bazohet në qeverisjen demokratike dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kjo çështje është pika më e fortë e doktrinës së teorisë së sigurisë njerëzore dhe ndan prerazi paradigmen nga modeli tradicional. Cenimet e të drejtave të njeriut në më të shumtën e rasteve bëhen nga shteti me synim mbrojtjen e “sigurisë kombëtare”. Megjithatë një politikë e tillë shpesh mund të sjellë humbjen e legjitimitetit të qeverisë dhe eventualisht shembjen e të tërë shtetit.

Dy parimet bazë të demokracisë janë që të gjithë qytetarët kanë akses të barabartë në pushtet dhe e dyta që ata gëzojnë të drejta dhe liri të njohura botërisht. Megjithatë, nëse një demokraci nuk legjitimohet në mënyrë të tillë që të shmangë ndarjen e pabarabartë të pushtetit politik në balanca, si është ndarja e pushtetit, atëherë një degë e sistemit rrezikon të akumulojë aq pushtet sa të bëhet e rrezikshme për vetë demokracinë.

“Demokracia liberale” (që gjykohet të jetë edhe lloji i demokracisë në Shqipëri) ndër të tjera përfshin: pluralizëm politik, barazi përpara ligjit, të drejta civile dhe njerëzore, proces të drejtë si edhe elementët e shoqërisë civile. Zgjedhje konkurruese që të jenë të drejta si në thelb ashtu edhe nga ana procedurale, kërkon garantimin e lirisë së shprehjes politike, lirinë e fjalës dhe lirinë e mediave. Të gjitha këto janë esenciale në një proces paraelektoral, pasi mundësojnë informimin e qytetarëve në lidhje me votën dhe interesat e tyre personale. Pra, demokracia mund të shihet si një set praktikash dhe parimesh që institucionalizojnë dhe rrjedhimisht mbrojnë lirinë.

Siguria politike në Shqipëri

Analiza e sigurisë politike për Shqipërinë përfshin 5 elementë bazë që do të analizohen në mënyrë të përmbledhur si vijon:

a. Niveli i demokratizimit

Parlamenti ka konsoliduar më tej rolin e tij si fokus për debatin politik në një kohë që forcat kryesore politike kanë filluar bashkëpunimin në çështje madhore. Ky konsensus mes shumicës ligjore dhe partisë më të madhe opozitare ka rezultuar në arritjen e progresit në reformat e gjyqësorit dhe atë zgjedhore. Kjo e fundit synon një Kod Zgjedhor gjithëpërfshirës dhe transparent, i cili do të garantojë votën e lirë e secilit nënshtetas. Parapërgatitjet për regjistrin civil elektronik dhe sistemin e adresave përfunduan në shtator 2008 duke siguruar

bazën për kartat e identitetit, listën e votuesve dhe pasaportave biometrike. Një sistem i shëndoshë i regjistrimit civil dhe sistemit të adresave (që ende nuk ka përfunduar) është guri i themelit për lista të votuesve dhe dokumente të besueshëm. Pak javë përpara datës 28 qershor, e cila përkon me datën e zgjedhjeve parlamentare, procesi i pajisjes me karta identiteti nuk ka përfunduar ende, duke vënë në rrezik edhe vetë votën e shumë nënshtetasve.

b. Mbrojtje prej represionit shtetëror (liria e shtypit, fjalës etj.)

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e miratuar në vitin 1998 në nenin 22 garanton shprehimisht lirinë e medias dhe të fjalës. Në këtë moment në Shqipëri numërohen me shumë se 250 lloje mediash, që përfshin mediat e shkruara, televizive apo radiofonike. Por një nga çështjet që përfshin mediat tona sot është transparenca dhe pikëpyetjet mbi pronësinë dhe financimi i tyre. Në përgjithësi, kanalet televizive si dhe shtypi i shkruar shihen nga publiku si të pozicionuara më njërën nga dy partitë e mëdha dhe ekstremisht të politizuara. Probleme të lirisë së mediave janë hasur rëndom vitin e fundit në Shqipëri. Dy nga gazetat kritike ndaj qeverisë janë penalizuar. Njëra prej tyre rezultoi në mbylljen e saj dhe tjetra në blerjen e të tërë tirazhit përpara se kjo e fundit të hidhej në treg. Në rastin e Shqipërisë ekuacioni i mediave përfshin një sërë problemesh që lidhen me tregun, marrëdhëniet midis pronarëve të mediave dhe qeverisë, transparencës së medias dhe pronësisë, marrëdhënieve të gazetarëve me pronarët e mediave, mungesën e gazetarisë investigative dhe pavarësinë editoriale. Në përgjithësi Shqipëria vazhdon të bëjë progres në lidhje me lirinë e shprehjes, një prioritet kyç i partneritetit europian. Ajo që nevojitet tani është implementimi i legjislacionit dhe përparimi në çështje të rëndësishme si dekriminalizimi i krimit të shpifjes për gazetarët dhe adoptimin e një legjislacioni për transparencën e pronësisë në media.

c. Respekt për liritë dhe të drejtat bazë të njeriut

Duke pasur parasysh “moshën” e re të kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila është hartuar në përputhshmëri

të plotë me normat ndërkombëtare, duhet theksuar se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të garantuara në më shumë se dy nene të saj. Shqipëria bën pjesë në organizata të ndryshme, të cilat këto liri dhe të drejta i kanë siguruar me konventa apo traktate, të gjitha këto të ratifikuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Megjithëse legjislacioni i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri është i plotë, problemi kryesor vazhdon të jetë mungesa e implementimit efikas dhe efektiv të këtij legjislacioni. Themelimi i institucionit të Avokatit të Popullit në 1999 përbën një hap të rëndësishëm në garantimin e këtyre të drejtave. Ndonëse teorikisht të gjitha të drejtat bazë dhe liritë themelore të qytetarëve tanë janë të garantuara, praktikisht çështja mund të ndryshojë. Në Shqipëri nuk mungojnë strategjitë kombëtare për barazinë gjinore, personat me aftësi të kufizuara, mbrojtjen e të miturve dhe zhvillimin e shëndetit mendor, por disa nga këto strategji nuk shoqërohen me implementimin e planeve dhe burimeve buxhetore. Ligji i lustracionit, i miratuar në kuvend vetëm me votat e maxhorancës dhe që synon të përjashtojë nga pjesëmarrja në administratën shtetërore apo dhe parlamenti të gjithë ata që kanë punuar në strukturat e sigurisë që prej 1944 deri me 1990, nuk përputhet me të drejtën e një dëgjimi të drejtë si garanton neni 14 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

Një tregues i mirë i Sigurisë Politike në vend është numri total i çështjeve kundër shtetit shqiptar të paraqitura në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, që është 146. Zhvillimi i një plani konkret qeveritar në fushën e të drejtave të njeriut, duke inkorporuar planet ekzistuese specifike dhe partneritetet me aktorët e shoqërisë civile do të përbënte një zgjidhje në implementimin e këtyre të drejtave.

d. Pritshmëritë demokratike

Pritshmëritë demokratike janë të lidhura ngushtë me angazhimet që Shqipëria ka ndërmarrë përballë institucioneve ndërkombëtare si NATO apo Bashkimi Europian. Rëndësia e zgjedhjeve të ardhshme është faktor kyç, në veçanti në

kontekstin e aspiratave të Shqipërisë në lidhje me Bashkimin European. Pritshmëritë politike të Shqipërisë janë reformat e ndërmarra për arritjen e kriterëve politike të Kopenhagenit, të cilat kërkojnë stabilitet të institucioneve duke garantuar demokraci, shtet ligjor, të drejtat e njeriut dhe respekt e mbrojtje të minoriteteve. Gjithashtu bashkëpunimin rajonal, marrëdhënie të mira me fqinjët dhe anëtarët e tjerë të BE-së, si dhe respekt për detyrimet ndërkombëtare. Në këtë kontekst janë kryer edhe reformat dhe ndryshimet kushtetuese të Kodit Zgjedhor dhe reforma në drejtësi. Megjithatë procedurat ligjore kanë mbetur të ngadalta dhe kanë mungesë të theksuar transparence.

e. Ndalimi i torturës, zhdukjes së personave dhe heqjen e prangosjes dhe burgimit për motive politike etj.

Republika e Shqipërisë ka nënshkruar konventat që ndalojnë burgosjen për arsye politike, torturën apo zhdukjen e personave. Ka pasur akuza, të cilat lidheshin me keqtrajtimin e të akuzuarve menjëherë mbas arrestimit apo gjatë marrjes në pyetje. Ministri i Brendshëm ka deklaruar se gjatë tre viteve të fundit janë bërë 128 raportime të oficerëve të policisë prej Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në lidhje me veprime arbitrare që lidhen me ushtrimin e dhunës. Pak nga këto çështje përfundojnë në gjykatë, shumica e të cilave vetëm mbasi viktimat i janë drejtuar për ndihmë Avokatit të Popullit. Që prej janarit, funksionet e mekanizmave kombëtare (në protokollin shtesë të konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës) i janë besuar Avokatit të Popullit, i cili në zbatim të detyrave të tij u vu në dijeni dhe bëri publike disa raste të keqtrajtimit të qytetarëve nga organet e rendit.

Sipas studimit të gazetës prestigjioze “The Economist”, Shqipëria radhitet e 81-ta nga 167 shtete, për sa i përket nivelit të demokracisë duke çelur e para radhën e shteteve me “demokraci hibride”. Indeksi i Njësisë së Inteligjencës së gazetës “The Economist” bazohet në pesë kategori: *procesi elektorale dhe pluralizmi, të drejtat civile, funksionimi i qeverisë, pjesëmarrja politike dhe kultura politike*. Këto pesë kategori janë të

ndërlidhura dhe formojnë një formë koherente të konceptimit të të gjithë panoramës së demokracisë në vend. Kushti i të pasurit zgjedhje të lira, të drejta si dhe respektimi i aspekteve të të drejtave politike është pa dyshim “*sine qua non*” i të gjitha përkufizimeve.

Rrjeti i Menaxhimit të Sektorit të Sigurisë është një sipërmarrje e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDN) me qëllim forcimin e kapaciteteve të shoqërisë civile, studiuesve nga institucionet publike e akademike, por edhe medias, për të përmirësuar qeverisjen në sektorin e sigurisë.

Besnik Baka

POLICIMI NË KOMUNITET FILOZOFIA DHE SFIDA E ZBATIMIT PRAKTIK

Filozofia e policimit në komunitet është vendosur vitet e fundit në qendër të vëmendjes së institucioneve, dhe kjo si një model që do të mund të eliminojë hendekun e thellë që ka ekzistuar tradicionalisht midis policisë dhe komunitetit, por nga ana tjetër gjithashtu si një instrument, i cili do të përmirësojë performancën e policisë në parandalimin e krimit dhe zbatimin e ligjit në përgjithësi. Nëse pranojmë se krimi mund të quhet produkt i kushteve sociale atëherë duhet të kuptojmë se ai mund të pengohet vetëm nëpërmjet kontrollit dhe manipulimit të kushteve sociale¹ çka e bën policimin në komunitet një prioritet të rëndësishëm për t'u adresuar. Policimi në komunitet ka të bëjë me një filozofi, ideologji të përcaktuar ku synohet që policia të vendoset në shërbim dhe në mbrojtje të interesave të komunitetit, ndryshe nga e kaluara ku policia i shërbente dhe mbronte interesat e shtetit. Ideja e gjithë kësaj sipërmarrje është të shndërrojë “policimin e komunitetit” në “policim për komunitetin”.²

Në këtë dokument do të trajtohen në mënyrë të përmbledhur çështjet kryesore që kanë të bëjnë pikërisht me ndryshimin e modelit të policimit nga ai tradicional-konservator në teorinë dhe praktikën e policimit komunitar duke i kushtuar një vëmendje të veçantë pengesave dhe veçorive në aplikimin e këtij modeli.

¹ Trojanowicz et al, “Community Policing”, Anderson publishing 2002

² Waddington, P. A. J. Policing Citizens: Authority and Rights. London, UK: Routledge, 1998. p 30. <http://site.ebrary.com/lib/universitetsbiblioteket/Doc?id=10054941&ppg=39>

Policimi në komunitet: Konteksti shqiptar

Në Shqipëri filozofia e policimit në komunitet bazohet në dy **DOKUMENTE** të rëndësishëm: Ligji nr. 9479, datë 4.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”³ dhe në “Strategjinë e Policisë së Shtetit 2007-2013”⁴. Strategjia e Policisë së Shtetit, në mënyrë të veçantë prezanton policimin në komunitet si një risi dhe prioritet kryesor të aktivitetit të policisë. Në këtë strategji aplikimi i policimit në komunitet shtron si domosdoshmëri ndërtimin e partneritetit me qytetarët, duke e konsideruar këtë të fundit si elementin më të rëndësishëm të këtij modeli ende në zhvillim. Nga ana tjetër, eksperiencia e viteve të fundit evidenton një sërë problemesh që shfaqen si rreziqe të mundshme ndaj realizimit të prioritetëve të këtij dokumenti strategjik:

- Ndikimi politik në Policinë e Shtetit dhe problematika e menaxhimit të burimeve njerëzore (qëndrueshmëria e personelit në të gjitha nivelet)
- Mungesa e vullnetit të duhur brenda policisë për të orientuar veprimtarinë drejt realizimit të këtyre prioritetëve
- Praktika e dobët e vendosjes së partneriteteve institucionale veçanërisht në nivel vendor, por jo vetëm
- Mungesa e vizionit dhe vullnetit për të orientuar vlerësimin e policisë nga ana e komunitetit

Ndonëse tashmë në vitin e tretë të zbatimit, zbatimi i Strategjisë duket se ende nuk po krijon një praktikë të konsoliduar të policimit në komunitet. Mbetet ende shumë për të bërë në lidhje me hartimin dhe zbatimin e treguesve matës të performancës strukturore dhe individuale, si dhe vlerësimin e vazhdueshëm të veprimtarisë së Policisë së Shtetit bazuar edhe në opinionin dhe ndikimin e perceptuar nga komuniteti. Neni 122 i ligjit për “Policinë e Shtetit” parashikon që në zbatim të strategjisë së policimit në komunitet, çdo drejtor i Drejtorive të Policisë në qarqe harton një strategji

³ Ligji 9479, datë 4.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”

⁴ Strategjia e Policisë së Shtetit 2007-2013

vjetore të policimit në qark për sigurinë në komunitet, pas këshillimeve me prefektin, kryetarin e bashkisë, përfaqësues nga drejtoritë e institucioneve të qarkut, përfaqësues nga grupet e interesit etj. Mungesa e një raporti vlerësues mbi implementimin e modelit të policimit në komunitet e bën edhe më të vështirë vlerësimin e situatës dhe rrjedhimisht reflektimin, për sa i përket aplikimit të një modeli të ri perëndimor të policimit si është ai i policimit në komunitet. Pavarësisht vizionit dhe detyrave të prezantuara në Strategjinë 7-vjeçare të Policisë, por edhe në parashikimet ligjore të përcaktuara në Ligjin “Për Policinë e Shtetit” ajo çka konstatohet është mungesa e **REZULTATEVE** që shprehet në një mungesë të theksuar mbledhjeje informacioni, analizë profesionale e ekspertizë dhe pamundësi për të dalë në rekomandime e iniciativa konkrete për përhapjen e ideologjisë së policimit në komunitet jo si një alternativë, por si një domosdoshmëri.

Nëse strategjia 7-vjeçare e Policisë së Shtetit është parë thjesht në këndvështrimin institucional të Policisë së Shtetit, atëherë del nevoja e ligjshme për krijimin e strukturave koordinuese në nivel vendor apo kombëtar për politika dhe plane veprimi që do t'i hapin rrugë **BASHKËPUNIMEVE NDËRINSTITUCIONALE** për parandalimin e kriminalitetit.⁵ Kompleksiteti i problematikës komunitare dhe ndërvarësia e zgjidhjes së tyre sjell natyrshëm ekzistencën e shumë pikave të përbashkëta mes aktivitetit të Policisë së Shtetit dhe e Pushtetit Vendor. Përmbushja e këtij misioni mund të arrihet nëpërmjet një bashkëpunimi reciprok të të gjithë aktorëve të tjerë në fushat e interesit të përbashkët. Strategjia Kombëtare e Policisë, parashikon se policia nuk është institucioni i vetëm përgjegjës për parandalimin e krimit dhe ruajtjen e rendit. Por megjithatë risia që ofron ky dokument mbetet e kufizuar në filozofinë dhe metodologjinë e policimit në komunitet pa trajtuar mundësitë reale dhe një plan të detajuar për ta vënë në jetë këtë filozofi. Si pasojë mund të

⁵ Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, “Drejt një Qasje të re në parandalimin e krimit” (publikuar në “Çështje të Sigurisë” Nr. 7, 2008).

pranojmë se ky dokument nuk çon në mënyrë të drejtpërdrejtë në bashkëpunimin ndërinstitucional për hartimin e politikave si në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor për parandalimin e krimit.⁶

E ndërsa strategjia 7-vjeçare e policisë, ndonëse ndalet në mundësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional në dobi të implementimit të policimit në komunitet, Ligji për Policinë e Shtetit, në nenin 122 “Për policimin në Komunitet” (trajton marrëdhëniet e oficerëve vendorë të policisë në nivel qarku) nuk parashtron nevojën e partneriteteve jashtë institucionale. Për më tepër ky nen nuk përcakton detyrimet ligjore të tilla që do të për afronin apo hapnin rrugë praktikave të orientimit drejt ngritjes së partneriteteve dhe zgjidhjes së problemit në komunitet.⁷

Duke parë mangësitë e aplikimit të strategjisë 7-vjeçare të policisë, Plan Veprimi për Implementimin e Policimit në Komunitet 2008-2010⁸, bën një hap para duke parashikuar një sërë nismash me qëllim nxitjen e implementimit të filozofisë së policimit në komunitet në vitet e ardhshme. Bazuar në këtë dokument, i cili ka si qëllim të nxjerrë në pah problemet e identifikuar në aplikimin e strategjisë së policimit në komunitet, shkurtimisht parashikohet:

- Analizimi dhe studimi i terrenit për të futur filozofinë e policimit në komunitet si një metodë pune e konsoliduar dhe efektive e bazuar kjo në analiza të veçanta të drejtorive përkatëse të qarqeve.

- Ndërgjegjësimi i publikut mbi benefitet që sjell aplikimi i metodave të policimit në komunitet.

- Aktiviteti i policisë të reflektojë nevojat, kërkesat dhe ankesat e komunitetit.

- Përfshirja e aktorëve dhe grupeve të interesit në rolin e partnerëve të policisë gjatë implementimit të filozofisë së policimit në komunitet.

⁶ Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, “Drejt një Qasje të re në parandalimin e krimit” (publikuar në “Çështje të Sigurisë” Nr. 7, 2008).

⁷ “Për një bashkëpunim real Polici e shtetit – Pushtet Vendor”, Policy Brief No.2, Instituti për Ndërmjetësim dhe Demokraci, maj 2008, Tiranë.

⁸ “Plan Veprimi për Implementimin e Policimit në Komunitet 2008-2010”, Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së shtetit.

- Krijimi i hapësirave të nevojshme në bashkëpunimin mes institucionit të policisë dhe institucioneve të tjera.
- Bashkëpunimin me përfaqësuesit e komunitetit, si janë anëtarët e forumeve të qeverisjes vendore, kryepleqtë e fshatrave, përgjegjësit e pallateve etj.
- Përgatitjen e akteve normative që synojnë saktësimin dhe zgjerimin e mandatit të patrullës së përgjithshme, ndarjen e kompetencave dhe përgjegjësive.
- Edukimi dhe trajnimi i stafit të policisë me tematika të ndryshme sipas nevojave të identifikuara ku përfshihet edhe një manual i kodit etik.

Pavarësisht vullnetit të mirë të strukturave drejtuese të policisë në bashkëpunim me institucionet këshilluese kombëtare e ndërkombëtare si ICITAP, PAMECA, shoqëria civile etj. në përpilimin e këtij Plan Veprimi, ky dokument ende lë shumë për t'u realizuar. Kjo në veçanti për disa arsye. Së pari, ky dokument strategjik nuk ka baza ligjore ndonëse në parim mbështetet në Ligjin Nr. 9749 datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, dhe në Strategjinë e Policisë së Shtetit (2007-2013), miratuar me Vendimin të Këshillit të Ministrave Nr. 14 datë 09.01.2008. Kjo mund të ndikojë negativisht në aspektin e aplikimit imediat nga drejtuesit e policisë në rrethe. Ndërkohë në aspektin organizativ ky Plan Veprim, ndonëse identifikon qartë prioritetet për të nxitur policimin në komunitet, kërkon decentralizimin e mëtejshëm të strukturave sidomos të buxhetimit. Për të vazhduar më tej, mund të thuhet se në të mungon një vizion real i ristrukturimit dhe organizimit të mekanizmave institucional për të rritur efikasitetin dhe reformuar strukturat e policisë në aspektin e policimit në komunitet.

Sfida të zbatimit gjithëpërfshirës

Policimi në komunitet është një mënyrë të menduari dhe një strategji organizative që i lejon policisë dhe njëkohësisht komunitetit, të punojnë së bashku duke përdorur mënyra të

reja për zgjidhjen e problemeve të krimit, rendit publik dhe çështjeve të sigurisë në përmirësim të jetës në komunitet.⁹ Në Shqipëri ndonëse mund të veçojmë një dëshirë konstante (të paktën formalisht), përpjekjet për të themeluar një praktikë të besueshme të policimit në komunitet duket se vështirësohen nga praktikat e **POLICIMIT AUTORITAR** të përdorura në regjimin e kaluar nga ky institucion. Kjo edhe për shkak se në perceptimin e qytetarëve¹⁰ ekziston një tendencë e përhapur mungese besimi te policia që kryesisht shikohet si një strukturë e ngurtë që i imponohet komunitetit me rregullat e saj rigorozë për respektimin e ligjit nëpërmjet procedurave autoritare e detyruese. Përfaqësja mbizotëruese shumëvjeçare që ka ekzistuar në vendin tonë, e që mbron idenë e zbatimit rigoroz të ligjit nëpërmjet teknikave autoritare ka ushqyer një ndarje aspak të shëndetshme midis policisë dhe komunitetit.¹¹

Policimi në komunitet nuk mund të jetë kaq i thjeshtë e i shpejtë, nënvizojnë studiues të shumtë duke pasur parasysh shndërrimin e plotë të praktikave të punës nga një model tradicional i bazuar në teknikat autoritare ndaj komunitetit, në një model liberal ku komuniteti është pjesë e policimit dhe jo i nënshtruar nga rregullat e strukturave të policisë. Teoria e “policimit në komunitet” sado që prezanton një risi në parandalimin dhe kapjen e shkeljeve ligjore vuan nga mangësi të theksuara si në aspektin praktik ashtu edhe në atë konceptual. Rrjedhimisht edhe aplikimi i modelit të policimit në komunitet në Shqipëri ngre mjaft pikëpyetje mbi funksionimin e përshtatshëm të kësaj metode si dhe procesin e edukimit jo vetëm të uniformave blu, por edhe të qytetarëve, të cilët duhet të njihen me detyrat dhe praktikat e reja të policisë

⁹ Strategjia Kombëtare e Policisë 2007-2013.

¹⁰ Besimi Publik Sfidë për Policinë, Konferenca IV Kombëtare, botim i IDN-së, 2005, Pyetësor i IDN-së, studentëve të Akademisë së Policisë dhe të Fakultetit të Shkencave Sociale UT me punonjës policie, punonjës të pushtetit vendor dhe qytetarë të territorit të Komisariateve 1, 2, 3 dhe 6 në Tiranë e atyre në Durrës, Shkodër, Lushnjë, Krujë dhe Kavajë.

¹¹ Mark Morrison Moore, Problem Solving and community policing. Heinonline – Journal of Crime and Justice 99. 1992 – The University of Chicago.

jo më si strukturë e ngurtë në ndëshkimin e autorëve që shkelin ligjin, por si një strukturë që bashkëpunon me qytetarët në ruajtjen e rendit.

Si i tillë jo rrallëherë policimi në komunitet përfshin oficerë të policisë, të cilët pavarësisht dëshirës dhe synimeve të mira për të rritur bashkëpunimin me komunitetin, realisht nuk kanë kapacitetin dhe aftësinë e nevojshme për të braktisur modelin tradicional të policimit, që ata kanë perfeksionuar aq mirë gjatë punës së tyre shumëvjeçare.¹² Nga ana tjetër, vetë qytetarët janë skeptikë dhe të pamotivuar për t'u kthyer në partnerë të policisë duke marrë në konsideratë faktin se në të kaluarën një urë mirëkuptimi “polici – qytetar” ka munguar dhe qytetarët vetëm përgjigjeshin para institucioneve përkatëse dhe aspak e anasjellta. I njëjti paralelizëm mund të theksohet edhe në lidhje me bashkëpunimet e Policisë me organet e pushtetit vendor në kuadër të të cilave janë këto të fundit ato që nuk e kanë kuptuar plotësisht rolin e tyre në ofrimin e shërbimeve të sigurisë publike në nivel vendor

Aplikimi i modelit të **POLICIMIT NË KOMUNITET**, sidomos në hapat e parë të vënies në jetë, mund të sjellë paqartësi në mënyrën e ushtrimit të kompetencave ligjore e detyrave funksionale të policisë. E thënë ndryshe mbetet ende një detyrë e vështirë aftësia e oficerëve të policisë për të absorbuar zbatimin praktik të normave e rregullave të policimit në komunitet gjatë aktivitetit të tyre të përditshëm në terren dhe në komunikimin e drejtpërdrejtë me banorët dhe grupet e interesit. Kjo pasi policimi në komunitet shfaqet më i sofistikuar, fleksibël dhe si i tillë nuk ka një agjendë dhe praktikë të përcaktuar qartë. Interpretimi i praktikave të saj në pjesën më të madhe i është lënë në dorë oficerëve të policisë, pjesa dërrmuese e të cilëve kufizohen kryesisht nga eksperiencia e gjatë e modelit të policimit autoritar.

Duke iu referuar situatës në vendin tonë vlen për t'u theksuar se ka një nevojë reale dhe imediate për të arritur një ekuilibër të munguar midis policimit reagues, kryesisht

¹² Hunter & Barker in Community Policing: The Middle Manager's Perspective, Gennaro F. Vito, William F. Walsh and Julie Kunselman.

ndëshkues ndaj shkelësve të ligjit (që tradicionalisht ka mbizotëruar në vendin tonë) në policim proaktiv (parandalues) në interes të komunitetit lokal e shoqërisë në përgjithësi, në një perspektivë afatgjatë. Në një kohë që rezultatet e policimit reagues janë më të prekshme, më të dukshme në sytë e publikut, por edhe në media, rezultatet e policimit proaktiv janë më pak evidente në sytë e publikut e të medias. Si pasojë duke marrë në konsideratë influencat politike dhe luftën për pushtet, rezultatet e policimit reagues janë më të mirëpritura për t'ia bërë të dukshme publikut, në një kohë që rezultatet graduale e afatgjata të policimit proaktiv janë jo shumë frytdhënëse për qëllime politike.

Duke iu referuar studimeve të hollësishme mbi policimin në komunitet kuptojmë se organizatat e policisë e kanë më të thjeshtë përforcimin e principeve dhe strukturave tradicionale të policimit ndërkohë që janë më pak të prirur për të përqafuar ndryshimet që sfidojnë strukturën ekzistuese.¹³ Nga kjo pikëpamje, policimi në komunitet pa dyshim që sfidon në mënyrë të hapur sistemin burokratik të organizimit dhe menaxhimit të veprimtarisë së policisë. Kjo gjithashtu reflektohet edhe në tendencën e oficerëve të policisë për ta vlerësuar policimin autoritar dhe luftën kundër krimin me metoda të ashpra. Në këto kushte oficerët e policisë, të cilët besojnë se autoriteti i tyre duhet të jetë i mjaftueshëm për të siguruar respektin dhe për të prodhuar qytetarë të bindur, mund të kenë vështirësi të mëdha për të hequr dorë nga pushteti që gëzojnë e për ta ndarë atë me qytetarët, çka është veçanërisht e theksuar në zonat e njohura për mungesën e rendit publik dhe aktivitet të lartë kriminal.

Në vend të rekomandimeve

Policimi në komunitet si filozofi që duhet të udhëheqë punën e strukturave të policisë së shtetit mbetet në nivelet fillestare të zbatimit, pavarësisht kuadrit të përmirësuar ligjor

¹³ Weisburd et al në Allison & Chappell, The Philosophical Versus Actual Adoption of Community Policing: A Case Study.

dhe atij të politikave. Në këtë kontekst, ajo çka i mungon përpjekjes për të konsoliduar zbatimin e këtij modeli në Shqipëri është elementi i përfshirjes, para së gjithash i qytetarëve, por gjithashtu edhe i institucioneve në nivel vendor nëpërmjet partneriteteve të bashkëveprimit praktik me strukturat e policisë së shtetit dhe më gjerë. Ndonëse jo të vetmet, këto elemente janë thelbësore për mundësimin e policimit në komunitet si një model i cili vendos në fokus komunitetin e qytetarëve (shërbimet e ofruara ndaj tyre) dhe kërkon angazhimin jo vetëm të institucioneve të zbatimit të ligjit, por edhe të strukturave që menaxhojnë dhe kontribuojnë në jetën sociale të komunitetit – pushteti vendor, institucione të tjera në nivel lokal, grupet e interesit dhe ato komunitare etj.

Një qasje e unifikuar në nivel kombëtar do të duhej rrjedhimisht të fokusohet jo vetëm në kapacitetet e strukturave të policisë, por gjithashtu edhe në mbështetjen që duhet ofruar nëpërmjet partneriteteve dhe jo thjesht si pasojë e perceptimit mbi detyrimin para një institucioni të zbatimit të ligjit dhe autoritetin e këtij të fundit. Absorbimi i kësaj filozofie sigurisht që vendos edhe forcat e rendit para nevojës (por edhe sfidës) për të ndryshuar në të gjitha nivelet mendësinë, qasjen dhe praktikat e policimit tradicional dhe për t'i përafëruar ato me metodat e policimit në komunitet. E ndërsa në kuadër të zbatimit praktik kjo mbetet një sfidë e cila do të adresohet në vazhdimësi deri në krijimin e një eksperience të konsoliduar të policimit në komunitet, ky i fundit mund të asistohet si në planin e politikave ashtu edhe në atë ligjor. Në mënyrë më specifike, inkurajimi i tendencës për ta lidhur më ngushtësisht veprimtarinë e policisë me kontekstin vendor e njëkohësisht për ta larguar nga ndikimet dhe interferencat politike mund të vijë nëpërmjet plotësimit të kuadrit ligjor ekzistues në lidhje me kornizën e bashkëpunimit dhe partneriteteve me aktorët vendorë – para së gjithash me pushtetin vendor. Nga pikëpamja e politikave kjo do të kërkonte më tej krijimin e hapësirave për fuqizimin e rolit (ndikimit, përfshirjes dhe mbështetjes) të aktorëve që “konsumojnë” shërbimet e policisë në nivel lokal dhe forcimin e një qasje të orientuar drejt

komunitetit të qytetarëve. Sidoqoftë, duhet theksuar fakti se asnjë prej këtyre masave nuk nënkupton domosdoshmërisht tendenca të decentralizimit të policisë së shtetit, por thjesht orientimin e saj drejt kontekstit lokal dhe aktorëve vendor – kuadër në të cilin edhe operon ky institucion.

ENGLISH SUMMERY

Rethinking us-europe relations: Is the eu better for obama than nato?**Paul Hockenos**

This article elaborates on the new American administration and how it would be well served to rethink the United States' relationship to Europe: It should move toward a strategic partnership of equals with the European Union and entertain the possibility of new fora to address global security threats. In the long-term, a close, respectful working relationship with the European Union would enhance America's own security and enable it to engage much more effectively in a multipolar world.

The article argues that NATO is just one of the post-World War II institutions that no longer meets the needs of today's world. The last decade has witnessed a striking displacement of power, away from the United States but also away from the West as a whole. The current implosion of the western-led financial system has only expedited this shift. When the new global powers begin to assert themselves, as indeed they are increasingly doing now, the United States and the Europeans will realize how much they still have in common. They will thus have to think innovatively about questions like security in a way that they failed to do in the immediate aftermath of the Cold War. If the Euro-Atlantic relationship is going to continue to be a special one, then it has to be on the basis of a partnership of equals, with the United States making important concessions to the Europeans and the Europeans finally stepping up to take care of their own security requirements. One thing is certain: Given the daunting challenges of the 21st century, the United States and Europe are going to need one another more than ever.

Transatlantic relations 2009: European expectations for the post-bush era

Jan Techau & Alexander Skiba (Editors)

The new US administration most likely will reach out to its European partners on many global and bilateral issues. President-elect Barack Obama will most likely demand more substantive and increased contributions from the European allies to a multitude of key projects: from stabilising Afghanistan and waging the war on terror to devising global solutions to the financial crisis and managing the rise of China and engaging India, and from countering Iran to making NATO more flexible for global action. Based on surveys conducted in 15 member states and of the European Union as a whole, this paper explores

what the EU and its individual member states expect from the United States in the post-Bush era. Individual case studies outline the concrete issues and fields of action that Europeans seek to address in the transatlantic format.

Time to reassess the european security architecture? The nato–eu–russia security triangle

Sandra Dias Fernandes

NATO will celebrate its 60th anniversary in April during a highly symbolic summit hosted jointly by France and Germany. In contrast to previous key summits in 1999 and 2004, today the allies have to deal with a transformed and oppositional Russia, besides a fast-evolving security environment. A few months ago, Russian President Dimitry Medvedev issued a proposal for a new security treaty. The proposal has added a further element to the catalogue of security disputes causing relations with Washington to deteriorate, among which missile defence continues to be one of the most divisive

This paper analyses Russian pressures on security issues and the way the EU and NATO have been addressing them.

It is argued that tensions over missile defence are closely related to NATO's enlargement to Ukraine and Georgia and to arms control (the Strategic Arms Reductions Treaty and the Treaty on Conventional Armed Forces in Europe), and that these issues are poorly tackled at the multilateral level. Aside from the positive moves already undertaken by the Obama administration towards Russia, it is difficult to foresee any rapprochement in the existing incompatibility of views on the legitimacy of NATO. In this context, the role of the EU in improving the security dialogue with Moscow is substantial.

Experts of the security management network (idm) Backgrounder in human security in albania Centre for security and european affairs

Analyzing the main strategic documents and reflecting on the current situation regarding security issues in Albania, we can come into the conclusion that overwhelmingly the aspects of human security are poorly handled either in the strategic documents or in the public discourse. This risk to create a gap between citizens and state's institutions themselves, considering that threat perceptions in the large public are tightly connected with human security given that these aspects affect them directly. This backgrounder is conceptualized in the frame of a summary where will be presented the seven components of human security in relation to Albania, aiming to identify the salient elements that feature the framework of human security in Albania.

- Economic Security

A simple definition of economic security would cite *continued solvency, reliability of income and employment security* as its main components.

Over the 10 last ten years the unemployment rate in Albania has decreased from 18.4 % in 1999 to 12.7 % in 2008 and this can be attributed to economic growth which has been stable at around 6%-7 %.

Remittances represent the most important component of rural families' monthly income, accounting for about 40%. About 70% of workers' remittances for the first quarter of 2008 was used for non-productive purposes; everyday consumption, construction and reconstruction and education and medical purposes. Albania has recorded high growth rates and in order to sustain high rates in the future the Government must adopt policies that encourage domestic production through development of industries etc that will benefit the unemployed through new jobs created.

- Food Security

The definition of food security is related with the situation in which the people in every stage of their life should have the opportunity and physical, social, economic space to receive sufficient and safe food, endeavoring to fulfill their basic diet needs and food preferences for an active and healthy life. One of the main changes that have happened in the concept of food security in Albania is done on the efforts to protect the environment as well as farmers' support producing organic products.

In Albania, the period following the fall of communism regime resulted in a total dependence of imported food products. This raised the concern on food security and guarantee which have a direct impact on human security. In addition the issue of malnutrition in the young children is a constant concern especially in the low-income families. This phenomenon is mostly accompanied with high infant mortality in some particular areas of the country.

The food security in Albania has been often threatened not because of the lack of natural resources to fulfill the country's needs, but because of mismanagement and political crisis that have lead sometimes to food emergencies.

- Environmental Security

Considered as a central issue in the national security, environmental security comprises the dynamic and interconnections among the natural resource base, the social fabric of the state, and the economic engine for local and regional stability. Albania's National Security Strategy,

approved by the National Assembly in 2004, does not allocate a lot of importance to environmental security, despite many aspects of the field, are intertwined to various security fields, like health and economic security. Emissions from the aging vehicle fleet that circulates on Albania's streets and from heavy industries are one of the main causes of environmental pollution in Albania. The government currently does not have in place a clear long-term policy on how to abate the air pollution and reduce emissions from these two sources. Municipal waste management also continues to be major threat to the countries environment. Uncontrolled dumping and burning of urban waste is rampant presenting an immediate health hazard. The report notes that Albania lacks a modern system of waste collection, disposal and recycling, and has not set up a clear strategy for the safe disposal of hazardous waste

- Personal security

In nowadays personal security more than individual security, is seen in the perspective of the conditions and factors (let them be either physical or emotional) that exist in order that a person feel safe.

Firstly the personal security is an issue of qualitative factors; feelings and perceptions; making Albania a country with serious problems in the framework of human security regardless the fact that such approach doesn't find much space in the strategic documents prepared to set the milestones of security sector reform and development.

As such a UNDP study conducted in Albania in 2004, revealed that personal security is a sensitive and very relevant issue for Albania, although little studied or analyzed. Therefore, referring to the data of the same source, at least 14% of the Albanian population feels unsafe in their homes whiles not less than 20% of the Albanians feel personally unsafe in the streets. Indeed such figures are reflected in the statistics of various crimes and road accidents which are presented in alarming rates. This might show the gap that exists between realistic personal security threats and lack of measures to face the situation such as establishing a long-term strategy to tackle

such crisis.

- Health Security

Health Security aims to guarantee a minimal necessary protection from diseases, especially those infective and epidemic, or those caused by poor living conditions.

The health service in Albania is widespread all over the country nevertheless the quality remains a serious problem. Problematic continue to be the corruption which has been the main obstacle for health services in the last 15 years. The quality and access to health service is rather low and this sector suffers poor infrastructure and lack of essential equipments and instruments, while there is a lack of motivation of qualified staff. According to the statistics, the annual cost of health service per person in Albania is 50 usd/year, while in Europe it is 1900 usd/year. This clearly indicates the misbalance and low standards of Albanian health system.

- Community security

Community security is directly related to the freedoms and human rights to protect and develop their own identity in which they believe.

The homosexual community in Albania is considered to be the category of people who severely suffer the implications that come from the weakness of community security in our country. The most serious problem is related to the overwhelming mentality that exists in the public and in the public institutions. Almost all the Albanian society has negative prejudices against gay community and in the same time lack of adequate information. According to various national human rights organizations, the most serious violations happen from the police, where physical and psychological violence prevail.

In relation to the ethnic minorities, although the Greek minority is better positioned, there is an immediate need to for accurate and recent statistics, greater political decision-making representation, and better administrative division of the areas where these minorities live and better education opportunities in their native language.

The Macedonian Minority concentrated in Prespa area, near Korça, raise various concerns and claims related to: lack of

education opportunities, lack of population registration, difficulties in preserving their own culture and national identity, lack of political representation and furthermore lack of investments and developing policies in this region.

Roma community is defined as a vulnerable group with very low education and economic conditions. Roma community is faced with numerous difficulties, that constitute the exclusion and social self exclusion from the rest of the society.

- Political security

The concept of political security is based in the democratic governance and protection and respect of human rights in Albania. The analysis of political security in Albania comprises 5 basic elements which are analyzed as follows.

- *Level of democratization*

The Albanian Parliament has further consolidated its role as a focus for the political debate while the main political forces have started to cooperate in major issues.

This consensus between the ruling party and the opposition party have resulted in a progress achieved in regards to court's and elections reforms. Nevertheless few weeks before June 28th which coincides with the start of parliamentary elections, the process of delivering identity documents has not yet been finished jeopardizing the whole election process and the right to vote for each citizen.

- *Protection against state repression (freedom of speech/press)*

The Constitution of the Republic of Albania, literally guarantees the freedom of speech and freedom of press (media). What is needed is the adequate implementation of the legislation and resolving sensitive issues such as decriminalization of defamation in the penal code and the adoption of a new legislation regarding the transparency of media ownership.

- *Respect for human rights*

Regardless the fact that the legislative framework seems complete enriched with additional national strategies, the biggest challenge is the efficient implementation of the existing legislation.

- *Democratic Expectations.*

Referring to the prestigious newspaper “The Economist”, Albania is ranked 81-st out of 167 countries, regarding the level of democracy development, leading the list of “hybrid democracy” countries. In this context various reforms and changes in Electoral Code and justice have taken place. Nevertheless the legal procedures have remained slow and substantially lack transparency.

- *Prevention of torture, abolishment of political sentences*

The Republic of Albania has signed the conventions that prevent the imprisonment for political motives, torture, or people extinction. In the past there has been cases related to maltreatment of inductees during the arrest and interrogation process.

Community policing: Philosophy and the challenge of implementation

Besnik Baka

The community policing philosophy in the last few years has attracted institutions’ central attention, as a model that can eradicate the traditional gap that has existed between the police and the community, but also as an instrument that will improve the police performance in crime prevention and law enforcement in general. If based on the assumption that “crime is a product of social conditions” then it becomes clear that crime prevention may follow only through control and manipulation of social conditions,² thus making community policing a major priority that needs to be addressed. Community policing is about a philosophy and an ideology which aims to put police under the citizens’ service and in defence of community interests, different from the past legacy when police was serving to and defending state interests. Its major intention is therefore to transform the “policing of the community” into a “policing for the community”.³

This policy brief focuses on the main issues arising precisely from the transformation of the policing model – from the traditional conservator one towards the community policing

theory and practice – through paying particular attention to impediments and other characteristics of this model. Based on the analysis of the institutional, legal and policy framework, this document emphasizes that the implementation of the community policing model is still in the initial stage.

In this sense, one of the missing components is the inclusion – particularly citizens' involvement and also that of institutions at the local level through partnerships for practical interactions with state police structures but not only. A unified approach at the national level must focus on the capacities of the state police but also on the needed support that must come through partnerships and not as a consequence of the perceived the "duty" or "obligation" vis a vis the authority of a law enforcement institution.

Encouraging the tendency to link the police activity with the local context and hence to avoid influence and political interfering represents a need that may be addressed through improving the legal framework regulating the cooperation and partnering with local actors – above all, with the local government authorities. From the policy perspective, this would additionally require space for empowering and enhancing the role (influence, involvement and support) of "consumers" of the state police's services at the local level and for strengthening a citizens-oriented approach.

INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM
ÇËSHITJE TË SIGURISË - 12

Formati: 15.5x24 cm
Shtypur në Shtypshkronjën TOENA
Tel: + 355 4 240116
Tiranë, 2009